

MARRËDHËNIET TREGTARE MES KOSOVËS DHE BE-SË

Shikim përtej Marrëveshjes
për Stabilizim dhe Asocim



Autorë: Petrit Gashi¹ dhe Geoffrey Pugh²

© 2015 Fondacioni i Kosovës për Shoqëri të Hapur

Pikëpamjet e shprehura në këtë botim nuk pasqyrojnë domosdoshmërisht pikëpamjet e Fondacionit Kosovar për Shoqëri të Hapur (KFOS). Pjesa dërmuese e studimit është realizuar gjatë vitit 2013 e 2014.

Publikuar nga:

Fondacioni i Kosovës për Shoqëri të Hapur

Imzot Nikë Prelaj, Nr. 13, 10 000 Pristina

Kosovë

Për më shumë informata:

info@kfos.org

www.kfos.org

¹ Petrit Gashi, Fakulteti Ekonomik, Universiteti i Prishtinës,
rr. Ramiz Sadiku, 10000, Prishtina, Kosovë
e-mail: petrit.gashi@uni-pr.edu

Geoff Pugh, Staffordshire University Business School,
Leek Road, Stoke-on-Trent, ST4 2DF, UK,
e-mail: g.t.pugh@staffs.ac.uk

² Autorët dëshirojnë të falënderojnë Gent Beqirin për asistencë të shkëlqyeshme në hulumtim



Marrëdhëniet Tregtare mes Kosovës dhe Bashkimit Evropian – Shikim përtej Marrëveshjes për Stabilizim dhe Asocim

Petrit Gashi, Fakulteti Ekonomik, Universiteti i Prishtinës,

Geoffrey Pugh, Staffordshire University Business School

Fondacioni i Kosovës për Shoqëri të Hapur
Prishtinë, Kosovë
Mars 2015

ABSTRAKT

Ky studim i tregtisë së Kosovës me 28 vendet e BE-së gjatë periudhës 2005-2012 zbulon se liberalizimi i tregtisë në vete nuk do të promovojë bilancin tregtar dhe zhvillimin ekonomik në Kosovë. Tregtia e pabarabartë – në të cilën importet tejkalojnë dukshëm eksportet – së bashku me modelet e qëndrueshme historike të eksportit dhe me mungesën e ndryshimit të eksporteve karshi ndryshimeve në të ardhura – qoftë në tregjet e BE-së apo në atë vendor – tregojnë mungesë të ekuilibrit në zhvillimin ekonomik të Kosovës. Domethënë, dinamizmi në anën e kërkesës (rritje rapide në kërkesën për import) bie në kontrast me mungesën e dinamizmit në anën e ofertës (investimet në kapacitetin prodhues dhe eksportet). Këto të gjetura kanë implikime madhore në politikat për nxitje të konkurrencës dhe zhvillimit ekonomik në Kosovë. Të gjeturat tjera kanë implikim të veçantë për politikat zhvillimore, dhe përfshijnë dhe rëndësinë e komunitetit të diasporës kosovare në promovimin e eksporteve. Në përgjithësi, do të nevojitet një kombinim i politikave qeveritare dhe veprimeve specifike të fuqishme për t'u dhënë shtytje të fuqishme konkurrencës dhe eksporteve. Qeveria e Kosovës duhet të krijojë ambient mundësues për biznesin, të sigurojë qasje të konkurrueshme tek shërbimet efikase të infrastrukturës; të lehtësojë lëvizjen e besueshme dhe efikase të mallrave drejt tregjeve të jashtme; dhe të sigurojë përmbushje të standardeve ndërkombëtare të kualitetit. Për më tepër, Qeveria ka për detyrë të luajë edhe një numër të roleve kyçe në mbështetje të drejtpërdrejtë ndaj konkurrueshmërisë së ekonomisë. Në kontekst të bizneseve, investimet duhet të drejtohen drejt faktorëve që përforcojnë prodhueshmërinë, pasi që ata diktojnë konkurrueshmërinë e kompanive në vend dhe jashtë.

TABELA E PËRMBAJTJES

ABSTRAKT	5
TABELA E PËRMBAJTJES.....	6
PËRMBLEDHJE EKZEKUTIVE	8
1. Hyrje	15
2. HISTORIKU	17
3. ANALIZA EMPIRIKE	25
3.1 Modeli dhe Hipoteza.....	25
3.2 Të dhënat.....	32
4. REZULTATET	33
4.1 Statistikat përshkruese	33
4.2 Gjetjet empirike	38
Përmbyllje.....	54
Rekomandimet politike.....	57
6.1 Parimet e politikave që përforcojnë konkurrueshmërinë.....	59
6.2 Politikat pas kufirit	60
6.3. Politikat Brenda Kufirit.....	62
6.4 Politikat përtej kufirit	63
6.5 Politikat Industriale dhe Konkurrueshmëria	64
6.6. produktivitetit dhe konkurrenca – masat specifike për kompanitë	65
Bibliografia.....	66
Aneks 1: MODELI I GRAVITETIT:	71
A1.1 Literatura mbi Modelin e Gravitetit.....	71
A 1.2 Çështje Ekonometrike të Modelit të Gravitetit	74
Aneksi 2: interpretimi dhe specifikacionet ekonometrike të modelit tonë të gravitetit	80
A.2.1 Interpretimi i rezultateve	80
A 2.2.Specifikat ekonometrike të modelit	81
Aneks 3: Statistikat përshkruese	83

PËRMBLEDHJE EKZEKUTIVE

Qëllim i këtij studimi është të hulumtojë ndikimin e faktorëve të ndryshëm të cilët veprojnë në tregtinë mes Kosovës dhe BE-së. Studimi synon të kontribuojë në debatin aktual politik mbi marrëdhëniet tregtare mes Kosovës dhe BE-së, që pasuan pas përmbylljes së negociatave për Marrëveshje të Stabilizim Asociimit (MSA). Për BE-në, MSA-ja është mekanizëm që promovon të drejtat politike, ekonomike, tregtare, dhe të njeriut kundrejt reformave në vendin i cili synon anëtarësinë evropiane. Në shkëmbim, përmes liberalizimit të tregut të përfshirë në MSA, BE-ja ofron qasje pa tarifa në tregun e saj, të shoqëruar me asistencë teknike dhe financiare. Për këtë arsye, komponentë kryesore e procesit të MSA-së është negociimi i liberalizimit të tregut për mallra dhe pjesërisht për shërbime. MSA-ja do të avancojë marrëdhëniet ekzistuese tregtare me Kosovën, e të cilat tani janë të ndërtuara mbi skemën e Masave Tregtare Autonome (MTA), një iniciativë e njëanshme e BE-së në afat të caktuar e cila u mundësoi 90 për qind të mallrave të Kosovës hyrje pa doganë në tregun e BE-së. Pritet që liberalizimi i tregtisë të eliminojë gradualisht pagesat e tarifave e mbetura doganore mes partnerëve tregtarë, dhe të vendosë marrëdhëniet tregtare mes Kosovës dhe bllokut në rrugë të qëndrueshme.

Pas hyrjes në fuqi (në kohë të shkrimit, MSA-ja pret ndë miratim nga Kuvendi i Kosovës dhe institucionet e BE-së), pritët që liberalizimi të ketë ndikim të dukshëm tek prodhuesit vendor sa i përket qasjes në treg, pasi që BE-ja tanimë përbën tregun më të madh botëror. Aq më tepër liberalizimi do të ndikojë edhe në hyrjen e kapitalit të huaj në vend. Për Kosovën, këto përparësi do të duhej të përktheheshin në vende të reja pune, rritje ekonomike, dhe mirëqenie. Megjithatë, shfrytëzimi më i mirë dhe benefitet e ndërlidhura me liberalizim varen nga një sërë faktorësh. Së pari, MSA-ja nuk nënkupton liberalizimin e plotë të fluksit tregtar. Kërkesat teknike dhe ato të cilësisë do të mbesin në fuqi edhe pas nënshkrimit të MSA-së. Në fjalë tjera, kriteret e cilësisë të cilave duhet të ju përmbahen produktet brenda BE-së do të sfidojnë dukshëm prodhuesit Kosovarë. Çështja tjetër, bile më e rëndësishme, janë se përfitimet e MSA-së varen kryesisht nga kapacitet prodhues brenda një vendi. Baza prodhuese e Kosovës, edhe pse e zgjeruar viteve të fundit, është ende shumë e vogël. Ky është një indikatorë i sektorit privat të pazhvilluar mjaftueshëm dhe të nivelit të ultë të afarizmit në Kosovë, dy faktorët kryesor shtytës të konkurrueshmërisë dhe eksportit. Nga këtu ne nxjerrim hipotezën se *pengesat ndaj një fluksi të rritur të mallrave në të dy anët nuk dalin vetëm nga lëvizja e lirë e mallrave*. Në rastin e Kosovës, pengesat kryesisht mund të definohen si “të dala nga zona përbrenda-kufijve” dhe mu këtu duhen orientuar synimet politike. Më poshtë, studimi rekomandon një kornizë të formësuar mirë për identifikimin e kufizimeve kryesore ndaj investimeve

private dhe veprimtarisë ndërmarrëse në Kosovë, dhe propozon një sërë instrumentesh politike të cilat do të kenë mundësi të ulin ndikimin e këtyre kufizimeve dhe të risin konkurrueshmërinë e Kosovës.

Për të hulumtuar këto marrëdhënie, studimi aplikon mjetin kryesor të ekonomisë së aplikuar ndërkombëtare, e që është modeli i gravitetit. Në formën e tij elementare, modeli i gravitetit nxjerr ndërlidhjen direkte të fluksit tregtar me madhësinë e ekonomisë (BPV) dhe anasjelltas me koston tregtare (p.sh. distancën) duke kapur kështu disa rregullsi të thella në mostrat e tregtisë ndërkombëtare. Në fakt, modeli i gravitetit është një ekuacion i shpenzimeve, përmes së cilit BPV i importuesit inkadrohet në formulë për të zënë efektin e të hyrave standarde, që d.m.th., ndikimin e ndryshimeve në të hyrat e një ekonomie në lidhje me sasinë e kërkuar të mallrave dhe shërbimeve. Përpos kësaj, faktori i distancës shtohet në ekuacion si përfaqësues i kostove në tregtinë bilaterale. Në fund, BPV i eksportuesit, në vlerësimin tradicional përfaqëson kapacitetin eksportues apo ofertues të një vendi. Përtej kësaj forme të thjeshtëzuar të modelit, ne prezantojmë në model mostrat historike të tregtimit mes partnerëve tregtarë, rolin e Diasporës në shkëmbime tregtare, dhe faktorin e valutës së përbashkët. Në argumentojmë se asnjë veçori e modelit të gravitetit me të cilën disponojmë tani nuk është mjaftueshëm e avancuar për të integruar të gjitha veçoritë e sugjeruara me përparimet e fundit teorike dhe përlllogaritjet sipas metodave aktuale ekonometrike. Për këtë detyrë të veçantë, e cila ka për qëllim të rritë nivelin e njohurive mbi marrëdhëniet tregtare që Kosova ka me BE-në dhe të implikimeve përkatëse politike, kompromisi ynë i veçantë është të përlllogarisim modelin dinamik i cili kontrollon efektet mes dy vendeve. Në argumentojmë se kjo qasje ka parasysh dinamikën, të cilat zakonisht mungojnë nga modeli i gravitetit, dhe në këtë mënyrë marrin parasysh historinë e veçantë të tregtisë së Kosovës me shtetet e BE-së, përderisa së paku pjesërisht adresojmë aspektet e “rezistencës” tregtare, të theksuar me teorinë e kohës së fundit.

Për të studiuar marrëdhëniet tregtare mes Kosovës dhe BE-së, ne kemi krijuar dhe analizuar një panel 8 vjeçar të eksporteve dhe importeve, të grumbulluara dhe zbërthyera sipas sektorëve. Në vazhdim, studimi ka aplikuar një gamë të gjerë të teknikave ekonometrike, e sidomos modelin me panele dinamike, për të analizuar marrëdhëniet në shqyrtim. Për shkak të një numri të karakteristikave të tij, në i japim rëndësi përlllogaritjes dinamike Poisson. Në përgjithësi regresioni Poisson tashmë është dëshmuar të jetë modeli më përshtatshëm për llogaritje të graviteti tregtar. Përveç mundësisë që të përlllogaris me zero observime në matricën tregtare (vendet të cilat nuk tregtojnë me Kosovën), e që është problem i veçantë me të dhënat në Kosovë, ky model merr parasysh heteroskedasticitetin në termin e gabimit. Për më tepër, ky model është i përshtatshëm për të vlerësuar modelin e gravitetit të informuar nga teoria, për shkak të

dy supozimeve kryesore të tij, dinamikës së specifikuar në formë korrekte, dhe regresioneve ekzogjene.

Në përgjithësi rezultatet konfirmojnë atë që kemi supozuar, si për eksport ashtu edhe për import. Për të përmbledhur, rezultatet e eksporteve veçojnë në vijim:

- Historia çon peshë! Modelet tregojnë koeficientë pozitiv dhe me koeficient me të rëndësi lartë statistikore mbi kushtet fillestare tregtare dhe/ose tregtinë në të kaluarën. Niveli e të dy koeficienteve është i lartë, pa marrë parasysh a vlerësojmë sipas modeleve dinamike lineare apo regresionit dinamik Poisson. Domethënia ekonomike e këtyre vlerësimeve është se modeli aktual i eksporteve të Kosovës nuk është i ndikuar nga e kaluara e afërt, por për më tepër, nga modelet e krijuara në vitin 2005. Kjo nënkupton mungesë të fleksibilitetit të ofertës; që nënkupton me shumë gjasa, kapacitete të mangëta të kompanive Kosovare për të hyrë në tregje të reja.
- Modeli gjeneron indikatorë të ndryshëm mbi efektin e të hyrave të eksportit nga Kosova
 - Modeli dinamik Poisson tregon se elasticiteti i të hyrave nga oferta për eksportin total të Kosovës të jetë mesatarisht zero. Edhe pse dinamika Poisson vlerëson se të dhënat sektoriale të eksportit, dhe vlerësimet dinamike lineare japin elasticitetin e të hyrave nga kërkesa për eksportet e Kosovës të jenë, mesatarisht, të ndryshme nga zero, këto efekte të vlerësuara janë ende mjaft të ulët. Elasticiteti i ulët ose zero elasticiteti i vlerësuar i të hyrave nga kërkesa sugjerojnë se Kosova eksporton lloje të mallrave për të cilat kërkesa përgjigjet pak ose aspak për të hyrat në rritje. Çfarë habit më tutje është se elasticiteti i parëndësishëm i furnizimit për nga aspekti statistikor sugjeron se rritja e të hyrave kombëtare të Kosovës nuk është duke gjeneruar kapacitete përkatëse eksportuese.
- “Distanca është gjallë e mirë” është një influencues i eksportit të Kosovës në vendet evropiane. Koeficientët e vlerësuar janë pothuajse njëtrajtësisht të rëndësishëm në nivelin 1 për qind dhe kanë shtrirje të madhe.
- Efektet e diasporës në eksportin e Kosovës janë mjaft të mëdha. Vlera e koeficientëve të llogaritur tregon rëndësinë e komunitetit të Diasporës për eksportin drejt vendeve të BE-së ku diaspora kosovare është relativisht e madhe në krahasim me vendet e BE-së ku diaspora është e vogël në numër.

Sa i përket importit, me poshtë renditen tendencat kryesore:

- Edhe një herë, historia çon peshë! Modelet gjenerojnë koeficientë pozitiv dhe me vlerë e rëndësi të lartë statistikore mbi kushtet fillestare tregtare dhe/ose tregtinë në të kaluarën. Këto rezultate dalin konsistente nëpër të gjitha modelet dhe shembujt. Megjithatë, në kundërshtim me efektet më të mëdha e dominuese të eksporteve, modeli aktual i importeve të Kosovës zbulon varësi dukshëm më të ultë në modelet e së kaluarës, dhe rrjedhimisht, fleksibilitet më të lartë në anën e kërkesës; p.sh. aftësinë e eksportuesve nga BE për të hyrë në tregun e Kosovës.
- Sa i përket efekteve në të hyra, për nga cilësia rezultatet përputhen me parashikimet e modelit të gravitetit, megjithatë, dallojnë për nga sasia me shumicën e modeleve të vlerësuara të gravitetit. Efekti i të hyrave në kërkesën kosovare për importe vlerësohet të jetë jashtëzakonisht i lartë dhe shumë domethënës për nga vlera statistikore. Këto vlerësime vejnë në pah se Kosova ka uri të theksuar për importe; në vlerësimet tona të preferuara sipas dinamikës Poisson, rritja e importeve tejkalon rritjen e të hyrave nga importet për 3 deri 4 pika. Në anën tjetër, eksportet drejt Kosovës nuk u gjenerojnë të hyra e veçanta eksportuesve evropian (elasticitetet e vlerësuara janë të vlefshme nga aspekti statistikor, megjithatë të ulta).
- Edhe për importe, distanca çon peshë! Koeficientet e vlerësuar janë pothuajse njëtrajtësisht të vlefshëm në vlerë 1 për qind dhe kanë shtrirje të madhe, edhe pse, më të ulët se në rastin e eksporteve.

Përmbledhja e rezultateve nga importi dhe eksporti sugjeron se tregtia e Kosovës nuk po i përgjigjet plotësisht përcaktuesve tradicional të tregtisë sikur një ekonomi e vendosur e tregut. Kjo nënkupton se karakteri i tregtisë së Kosovës me BE-në dallon dukshëm me karakterin e tregtisë ndërkombëtare mes ekonomive të vendosura të tregut. Dëshmi për këtë është kundërshtimi mes persistencës historike mjaft të lartë të modeleve të eksportit dhe persistencës relativisht të ultë të modeleve të importit, gjë që nënkupton një ekonomi shumë më dinamike në anën e kërkesës se sa në anën e ofertës. Dëshmi e radhës për këtë interpretim është raporti kundërshtues statistikor mes importeve dhe eksporteve në njërën anë dhe të të hyrave të ndryshuara në anën tjetër. Anasjelltas, eksportuesit kosovar ende nuk duken të përfitojnë prej asaj që në përgjithësi perceptohet si shtytësi më i fuqishëm i eksporteve, e që është rritja e të ardhurave të konsumatorëve të huaj. Në veçanti, kur është fjala për eksportim, investigimi ekonometrik tregon se qasja ndaj zhvillimit ekonomik në Kosovë nuk është e natyrës stimuluese për firmat dhe industrinë eksportuese. Për më tepër, efektet e distancës, kanë rezultuar me vlera jashtëzakonisht të larta negative, duke zbuluar kështu se kostot e

transaksioneve në eksport dhe import, mes Kosovës dhe shteteve anëtare të BE-së, janë jashtëzakonisht të larta. Ashtu siç është sqaruar, kostot tregtare mes Kosovës dhe BE-së janë të ndërlidhura me politikat, kushtet fizike, dhe ato institucionale. Në fund, efekti i diasporës tregon se eksportet e Kosovës po reagojnë fuqishëm në faktorë të tjerë, më pak të zakonshëm. Ky rezultat i fundit vë theksin në rëndësinë që kanë lidhjet personale dhe shoqërore, të cilat ndihmojnë në uljen e kostove të transaksionit mes Kosovës dhe shteteve të BE-së.

Përfundimet e dala nga modeli ynë i gravitetit kanë implikime të rëndësishme për politik-bërjen në Kosovë, dhe atë përtej asaj që mund të konsiderohet si çështje të tregtisë dhe politikave tregtare. Në të vërtetë, implikimet vejnë theksin në zhvillimin dhe konkurrueshmërinë e sektorit privat në Kosovë. Ky i fundit është përbërësi kryesor për rritje afat-gjate, ndërsa faktorët mjedisor dalin të jenë ndihmues për zhvillimin e tij. Në këtë kontekst, për një vend të vogël çfarë është Kosova, ekziston argumenti i cili thotë se rritja e qëndrueshme është e shtyrë kryesisht nga eksportet. Zhvillimi i eksportit i udhëhequr nga sektori privat ka qenë përbërësi jetik i konkurrueshmërisë, rritjes dhe mirëqenies së shumë ekonomive të tregut, si të zhvilluara po ashtu edhe i ekonomive në zhvillim. Prandaj, eliminimi i barrierave ndaj investimeve të sektorit privat dhe aktiviteteve ndërmarrëse duhet të jetë çështja më e rëndësishme e politik-bërjes në Kosovë, pasi që bizneset nuk do të investojnë kur risku dhe paqartësitë janë të mëdha. Për të fiksuar pengesat kryesore të zhvillimit dhe të konkurrueshmërisë të sektorit privat, ky studim sugjeron kornizën e “diagnostikimi i rritjes” të zhvilluar nga Hausmann et al (2008). Ashtu siç sugjeron kjo kornizë, në një ekonomi me performancë shumë të dobët e cila ka nevojë për reforma, mospërkryerjet e tregut dhe shtrembërimet qeveritare janë të papërmbajtura.³ Në rastin e Kosovës, pavarësisht nga problemet e tjera strukturore, përfitimet e ulta nga aktiviteti ekonomik janë mbi të gjitha rezultat i institucioneve dhe politikave të ndërlidhura me resurset njerëzore, furnizimin elektrik, korrupsionin, mekanizmat e sundimit të ligjit, taksave, stabilitetit financiar dhe fiskal, e që së bashku rezultojnë në risk të lartë të nivelit makro dhe mikro në një vend.

Sidoqoftë, është pothuajse e pamundur që në praktikë të gjitha këto pengesa të eliminohen përnjëherë. Në të vërtetë, autorët argumentojnë se korniza e “diagnostikimi i rritjes” është strategji për të radhitur prioritetet politike në vend. Ideja është që të identifikohen “kufizimet me të detyrueshme” të aktivitetit ekonomik dhe të dizajnohet një set politikash të cilat do të gjenerojnë efektet më të mëdha. “Kufizimi më i madh i detyrueshëm” në rritjen dhe konkurrueshmërinë e sektorit privat dhe ndërmarrësisë në

³ Kjo kornizë njihet edhe si Korniza e Diagnostikimit Hausmann-Rodrik-Velasco Growth (shih Todaro dhe Smith, 2009)

Kosovë ka të bëjë me strukturën e dobët institucionale.⁴ Kufizimet që dalin nga mjedisi i papërshtatshëm institucional në Kosovë jashtëzakonisht marrin formën e shtrembërimeve të tregut, një klimë e pafavorshme për biznesin, aftësi të dobëta të punës, qeverisjes së dobët, dhe nivelit të lartë të korrupsionit, infrastrukturës së dobët, e kështu me radhë. Përmirësimet në kualitetin e institucioneve me shumë gjasa do të prodhonin efektin me të madh pozitiv e direkt në eksporte, dhe si përfundim, edhe në rritjen dhe mirëqenien në Kosovë.

Bazuar në paradigmen liberale, një listë me një numër të limituar të rekomandimeve janë dhënë në këtë studim, e që përbëjnë një kombinim të veprimeve që Qeveria e Kosovës duhet të ndërmarrë në mënyrë që të risë konkurrueshmërinë e sektorëve vendor. Në kontekstin e “politikave-prapa-kufirit,” këto masa përfshijnë veprime për përmirësim të mjedisit biznesor, sipas pikëpamjes se duhet promovuar fillimisht IDH të cilat përforcojnë eksportin. Po ashtu, masat duhet të jenë të orientuara kah ofrimi i shërbimeve infrastrukturore konkurruese, veçanërisht ato të energjisë. Për më tepër, një numër i hapave të rëndësishëm duhen ndërmarrë drejt forcimit të institucioneve që sigurojnë kualitetin, dhe drejt vetëdijesimit të bizneseve për t’i përmbushur standardet ndërkombëtare të produkteve. Grupi i rekomandimeve “brenda kufijve” kanë të bëjnë me lehtësimin e tregtisë, përfshirë këtu riorganizimin e procedurave kufitare, adoptimin e inspektimit të bazuar në risk, dhe eliminimit të ngushticave tjera në kufij. Në fund, politikat-prapa-kufirit përfshijnë propozimet për sigurim të qasjes më të lirë në tregjet evropiane dhe rajonale të shërbimeve. Barrierat jo-tarifore, e veçanërisht barrierat teknike të tregtisë dhe sanitare e fito-sanitare, janë ende dominuese në vendet me të cilat Kosova tashmë ka marrëveshje të tregtisë së lirë e të cilat në veçanti kanë ndikim në mallrat industriale dhe bujqësore.

Megjithatë, duke pasur parasysh vështirësitë ofertuese të ekonomisë kosovare, është me shumë pak gjasa që politika kaq liberale të jenë të mjaftueshme për rritje të konkurrueshmërisë së industrisë vendore; prandaj Qeveria e Kosovës ka një numër rolesh esenciale në mbështetjen e industrisë vendore. Është përtej shtrirjes së këtij studimi që të propozojë politika industriale të cilat do të nxisnin aktivitetet vendore. Mirëpo, duke u bazuar në literaturën e kësaj çështjeje, kemi ofruar një set të parimeve të nevojshme për të dizajnuar dhe zbatuar politika të suksesshme industriale. Parimi themelor ka të bëjë me arkitekturën adekuate institucionale, e cila është e liruar nga korrupsioni dhe marrja e mitos.

⁴ Shih *Raportin e Progresit*, Komisionit Evropian, 2013, http://ec.europa.eu/enlargement/pdf/key_documents/2013/package_brochures/kosovo_2013.pdf (vizituar më 30 janar, 2014).

Në fund, reduktimi i riskut dhe paqartësive mjedisore në ekonominë e Kosovës do të duhej të hapte rrugë për investimet e sektorit privat dhe aktivizmit afarist. Këto investime shtesë duhet të kenë fokus të veçantë: duhet të jenë të drejtuara kah mekanizmat për përforsim të produktivitetit e të cilat e përcaktojnë konkurrueshmërinë. Prej këtui grup i propozimeve ka të bëjë me nevojën për të drejtuar investimet e kompanive kah burimet njerëzore me aftësi të larta, kapital, dhe teknologjitë e reja e të avancuara, përhapje të produktivitetit, e të ngjashme.

Rezultat që dalin nga ky studim dhe rekomandimet pasuese ushqejnë diskutimin aktual mbi qasjen aktuale ndaj rritjes ekonomike në njërën anë, dhe të liberalizimit të tregut dhe ndikimit të tij në tregun e Kosovës në anën tjetër, e veçanërisht në rritjen e konkurrueshmërisë së sektorit privat. Aq më tepër, ky studim do t'i kontribuojë diskutimit mbi marrëveshjet e mundshme për tregti të lirë dhe anëtarësimin të Kosovës në Organizatën Botërore të Tregtisë. Për nga ana e hulumtimit, modeli i gravitetit do të përdoret si vegël nga politik-bërësit në të ardhmen për të vlerësuar në formë retrospektive (ex-post) ndikimin e politikave të ndryshme në fluksin tregtar.

1. Hyrje

Në vitin 2013, Kosova hyri në një fazë të re të marrëdhënieve me BE-në. Në qershor, Këshilli i Bashkimit Evropian autorizoi Komisionin Evropian që të nisë negociatat për Marrëveshje të Stabilizim Asociimit (MSA) mes Kosovës dhe BE-së. Sipas BE-së, MSA-ja definon të drejtat dhe detyrimet e palëve deri në realizim të anëtarësisë së plotë në BE.⁵ Për BE-në, MSA-ja është mekanizëm që promovon të drejtat politike, ekonomike, tregtare, dhe të njeriut kundrejt reformave në vendin i cili synon anëtarësinë evropiane. Në shkëmbim, përmes Marrëveshjes për Tregti të Lirë (MTL), BE-ja ofron qasje pa tarifa në tregun e saj, të shoqëruar me asistencë teknike dhe financiare. Zyrtarisht, negociatat për MSA-në filluan me 28 tetor, 2013, ndërsa në mes të vitit 2014, marrëveshja u siglua, ndërsa tani pret nënshkrimin zyrtar dhe ratifikimin.

MSA-ja është një kombinim i dispozitave të cilat pikësepari sigurojnë liberalizimin e tregtisë në mallra dhe shërbime, ndërsa së dyti kërkon reforma institucionale të nevojshme në mënyrë që Kosova të takohet me rregullat dhe standardet institucionale të BE-së. Sa i përket të parës, pritet që MSA-ja gradualisht të eliminojë tarifën për mallrat e tregtuara mes BE-së dhe Kosovës. Në të vërtetë, BE-ja do të shfuqizojë të gjitha tarifën doganore me Kosovën pas hyrjes në fuqi të Marrëveshjes, përpos për disa produkte bujqësore, të cilat i nënshtrohen tarifave të veçanta doganore apo kuotave. Në anën tjetër, Kosova do të zhdukë tërësisht të gjitha tarifën doganore në një sërë të vijave tarifore (prodhimeve industriale, bujqësore, dhe të peshkut) derisa për të tjerat do të reduktojë tarifën në formë progresive brenda pesë, shtatë, dhe dhjetë viteve. MSA-ja merret poashtu me ofrimin e shërbimeve; dispozitat mbulojnë të drejtën për themelimin, p.sh. të drejtën për të ndërmarrë veprim ekonomik në territoret e palëve negociuese në bazën Kombi më i Favorizuar. Përveç kësaj, palët pajtohen për dispozitat specifike në lëvizjen e personave natyral e cila mundëson lëvizjen e personelit kyç të kompanisë së themeluar në territorin e palës tjetër. Për më tepër, në kontekst të prezencës komerciale, palët pajtohen të u japin të drejtën e përdorimit dhe qiramarrjes ndaj bashkëkombësve të vetë (në rastin e Kosovës, do t'i nënshtrohet përkufizimeve specifike kohore).

Para hyrjes së MSA-së në fuqi, duhet pasur parasysh se Kosova tashmë përfiton nga Masat Tregtare Autonome të BE-së, në kuadër të të cilave mbi 90 për qind e prodhimeve me origjinë nga Kosova hyjnë në tregun e BE-së pa taksa doganore. Në anën tjetër, Kosova i ka liruar gati të gjitha mallrat kapitale nga taksat doganore e të cilat janë me origjinë kryesisht nga BE-ja. Megjithatë, MSA-ja do të forcojë me tutje marrëdhëniet tregtare mes Kosovës dhe BE-së. Liberalizimi prezanton një mundësi të veçantë për

⁵ European Parliament, *New horizon for Kosovo's EU Integration*. Vizituar në: <http://www.europarl.europa.eu/nes/en/news-room/content/20130204IPR05608/html/New-horizon-for-Kosovo's-EU-integration> vizituar më 5 Janar, 2014.

prodhuesit Kosovar që t'i qasen tregut më të madh botëror. Përveç tjerash, Marrëveshja do të dërgojë sinjal të fortë tek investitorët e huaj potencial, Evropian dhe jo-evropian, që të investojnë në një shtet të pajisur me burime njerëzore dhe natyrore, së bashku me qasje pa taksa doganore, në tregun evropian. Për një shtet të rënduar nga e kaluara e tij i cili kalon nëpër vështirësi ekonomike, këto përparësi do duhej të përktheheshin herët a vonë në vende të reja pune, rritje të eksporteve, rritje ekonomike, dhe përfundimisht në mirëqenie të përmirësuar.

Megjithatë, mbetet një pyetje e madhe e hapur nëse liberalizimi me BE-në do të prodhojë efekte imediate për Kosovën. Para së gjithash, lirimi nga taksat doganore nuk nënkupton qasje të plotë në tregun e BE-së. Kriteret e kualitetit të cilave duhet të ju përmbahen produktet brenda BE-së do të sfidojnë dukshëm prodhuesit Kosovarë. Në anën tjetër, është e paqartë nëse investitorët e huaj do të bien në karremi e MSA-së dhe të shpërfillin problemet madhore strukturore me të cilat po ballafaqohet Kosova. Është evidente se në kontekstin aktual, se paku në afat të shkurtër, liberalizimi me BE-në do të mund t'i sjellë me shumë sfida se sa përfitime shoqërisë Kosovare. Prandaj, kjo bëhet ngrit nevojën për masa politike “përbrenda kufijve” drejt aktivizimit të sektorit të eksporteve në Kosovë. Mu kjo është ajo pika në të cilën përqendrohet ky studim. Bazuar në të dhënat historike, studimi hulumton ndikimin e faktorëve të ndryshëm të cilët veprojnë në marrëdhënien tregtare mes Kosovës dhe BE-së. Pikësëpari, studimi përqendrohet në ndikimin e “forcave binjake,” d.m.th. masave ekonomike dhe kostove tregtare në fluksin e mallrave mes Kosovës dhe BE-së. Studimi aplikon të ashtuquajturën qasjen sipas Modelit të Gravitetit, e cila për mbi pesëdhjetë vite ka qenë ‘kalë pune’ për analiza empirike të faktorëve të cilët përcaktojnë shkëmbimet tregtare mes shteteve, përfshirë këtu edhe politikat e ndërlidhura me tregtinë. Ashtu siç sugjeron literatura, modeli i gravitetit ndërlidh fluksin tregtar (eksportin, importin, apo fluksin tregtar) drejtpërdrejtë me madhësinë e një ekonomie (BPV nominal) , koston tregtare (të përllogaritur me distancën gjeografike mes kryeqyteteve të partnerëve tregtar), duke nxjerrë kështu disa trende të rregullta në mostrat e tregtisë ndërkombëtare.

Studimi bazohet në një panel 8-vjeçar të të dhënave mbi eksportin dhe importin - që të dyja të grumbulluara dhe zbërthyera sipas sektorëve. Studimi përdorë një gamë të gjerë të teknikave ekonometrike, e sidomos modelet me panele dinamike të cilat janë vlerësuar si më të përshtatshmet për të analizuar marrëdhëniet në shqyrtim. Rezultatet tregojnë se fluksi tregtar është tmerrësisht i varur nga ndryshimet në nivelin e të hyrave të të dy palëve tregtare. Të njëjtat rezultate tregojnë se ndryshimet në nivelin e BPV-së të Kosovës nuk ndikojnë në potencialin eksportues të kompanive kosovare. Me fjalë tjera, studimi sjell prova se zhvillimi ekonomik i Kosovës nuk është i natyrës stimuluese për

firmat dhe industritë eksportuese. Faktori i koston tregtare ushtron ndikim të madh në fluksin tregtar, dhe shumë shpesh është arsye e studimeve të ngjashme. Mes Kosovës dhe BE-së, koston tregtare mes Kosovës dhe BE-së janë të ndërlidhura me politikat, kushtet fizike, dhe ato institucionale. Përndryshe, efekti i diasporës kosovare në promovimin e eksporteve nga Kosova është i madh dhe me shumë ndikim. Kjo e fundit thekson rëndësinë e rrjeteve personale dhe shoqërore, të cilat mund të zbusin përndryshe koston e lartë të transaksionit.

Pjesa në vazhdim përqendrohet në historikun e këtij problemi. Pjesa në vazhdim prezanton metodologjinë e aplikuar, përfshirë këtu edhe përshkrimin e modelit, burimin e të dhënave, dhe specifikat ekonometrike të aplikuara në këtë studim. Pjesa e fundit prezanton rezultatet, nxjerrë përfundimet, dhe prezanton rekomandimet politike. Ndërsa në Aneksin 1, mund të gjeni një recension të shkurtë të literaturës mbi modelin e gravitetit dhe disa çështjeve tjera specifike ekonometrike.

2. HISTORIKU

Krahasuar me shtetet e tjera në rajon gjatë viteve të fundit, performanca e Kosovës në rritjen ekonomike ka qenë mjaft premtuese (shih Tabelën 1). Megjithatë, *Raporti i Progresit* për vitin 2011 argumenton se rritja ekonomike e Kosovës mbetet e dobët dhe e brishtë, pasi që një numër i instrumenteve makroekonomike të aplikuara nuk kanë prodhuar rezultatet e pritura.⁶ E para ka të bëjë me rritjen e ngadalshme të nxitur nga shpenzimet në sektorin publik, edhe pse në ndërkohë shpenzimet kapitale kanë krijuar një jo-stabilitet makroekonomik duke rritur deficitin e buxhetit të Kosovës. Tjetra, rritja e konsumit nga ana e sektorit privat mbetet kryesisht e pandryshuar, për shkak të nivelit konstant të dërgesave nga diaspora, nivelit të ultë i krijimit të vendeve të punës në ekonomi, dhe nivelit të moderuar por të qëndrueshëm të inflacionit.⁷ Kur është fjala për dërgesat e të punësuarve, siç raportohet në Tabelën 1, neto dërgesat e tyre janë rritur në mënyrë të qëndrueshme gjatë pesë viteve të fundit, mirëpo pjesëmarrja e tyre në BPV pothuaj mbetet e pandryshuar. Dërgesat e të punësuarve jashtë vendit kanë ndikim të dyfishtë në ekonominë e Kosovës: si burim kryesor i financimit të kërkesës vendore; dhe së bashku me ndihmën e huaj, si kontribuues kryesor i deficitit aktual buxhetor. Së fundi, investimet private kanë qenë të drejtuara kryesisht në aktivitetet jo-produktive. Për shembull, në vitin 2011, mbi 30 për qind e të ardhurave prej investimeve të huaja direkte

⁶ http://ec.europa.eu/enlargement/pdf/key_documents/2011/package/ks_rapport_2011_en.pdf (vizituar më: 30 Janar, 2014).

⁷ Rënia e nivelit të papunësisë më 2012 është rezultat i ndryshimeve në metodologjinë për llogaritje të shkallës së papunësisë. Shumë (e posaçërisht partitë opozitare) e kanë quajtur këtë thjeshtë veprim popullist nga ana e qeverisë aktuale.

(IHD) u përqendruan në patundshmëri dhe ndërtimtari, dhe 22 për qind të tjera në shërbimet financiare (Raporti i Progresit i Komisionit Evropian 2011). Në vitin 2012, neto investimet e huaja direkte përbënë vetëm 5 për qind të BPV, duke shënuar kështu një rënie prej 3 për qind nga një vit më herët. Rritjet e mëhershme të derdhjes së kapitalit të huaj në vend kanë qenë të lidhura më shumë me marrëveshjet e privatizimit se sa me IHD-të në investime në fusha-të-gjelbra.

Tabela 1. Kosova – indikatorët kryesor makroekonomik

Indikatorët	2008	2009	2010	2011	2012
BPV (aktual, mil. €)	3,940.2	4,045.7	4,334.0	4,769.8	5,016.5
BPV-rritja (vjetore %)	7.0	3.0	3.0	5.0	3.0
BPV për kokë banori (aktuale, €)	2,255.0	2,297.0	2,441.0	2,663.0	2,777.0
BPV për kokë banori-rritja (vjetore%)	6.0	2.0	2.0	4.0	2.0
IHD, neto hyrja (aktuale, mil. €)	366.7	293.4	367.3	392.6	228.2
IHD, neto hyrja (% e BPV-së)	9.0	7.0	8.0	8.0	5.0
Dërgesat e të punësuarve dhe kompensimi i punëtorëve, të pranuar (aktuale, mil. €)	712.1	758.8	752.5	806.3	824.2
Dërgesat e të punësuarve dhe kompensimi i punëtorëve, të pranuar (% e BPV-së)	18.0	19.0	17.0	17.0	16.0
Papunësia, total (% fuqisë totale punëtore)	48.0	45.0	-	-	31.0
Inflacioni, çmimet e konsumit(vjetore%)	9.0	-2.0	3.0	7.0	2.0

Burimi: *World Development Indicators* (2014). <http://data.worldbank.org/data-catalog/world-development-indicators>

Së bashku me nivelin e lartë të papunësisë, pozita e jashtme e Kosovës mbetet çështja e vetme më sfiduese e Kosovës. Që nga viti 1999, tregu i Kosovës ka qenë i vërshuar nga importet, ndërsa eksportet kanë qenë të parëndësishme. Edhe pse në rritje të vazhdueshme, eksporti i mallrave ende mbulon vetëm rreth 10 për qind të mallrave të importuara. Industritë vendore ende duhet të krijojnë prezencë në tregjet e eksportit, edhe pse duket se sektori i minierave ka filluar të marrë pozitën udhëheqëse tradicionale.

Për një dekadë, eksportet e Kosovës janë rritur me një shkallë të lartë, megjithëse nga një bazë tepër e ultë (tabela 2 tregon trendët e fundit). Eksportet e mallrave dhe shërbimeve arritën kulmin e pak mbi €950 milion në vitin 2011, duke zënë kështu rreth 20 për qind të BPV-së. Megjithatë, importet në vitin 2011 kaluan €2.7 miliard, që përbën përndryshe mbi 57 për qind të BPV-së së Kosovës. Importet janë rritur me një shkallë më të ngadalshme, rreth 20 për qind në disa vitet e fundit. Raporti mesatar i mbulimit të importeve, d.m.th., eksportet e mallrave dhe shërbimeve si përqindje e importeve, gjatë tre viteve të fundit qëndron në rreth 35 për qind.

Tabela 2. Kosova – indikatorët e tregtisë ndërkombëtare

Indikatorët	2008	2009	2010	2011	2012
Shkalla e përgjithshme e hapjes(%)	67.9	68.9	75.3	77.7	71.0
Eksportet e mallrave dhe shërbimeve (aktuale, mil. €)	543.7	658.7	829.5	959.1	918.9
Mallra të eksportuar (aktuale, mil. €)	120.1	174.7	298.1	317.2	281.8
Shërbime të eksportuara (aktuale, mil. €)	423.7	483.9	531.4	642.1	637.1
Eksportet e mallrave dhe shërbimeve (% e BPV)	13.8	16.3	19.1	20.1	18.3
Importet e mallrave dhe shërbimeve (aktuale, mil. €)	2,131.7	2,129.5	2,433.5	2,749.4	2,644.1
Mallra të importuar (aktuale, mil. €)	1,854.4	1,833.0	2,034.9	2,364.4	2,327.3
Shërbime të importuara (aktuale, mil. €)	277.4	296.5	398.5	385.0	316.7
Importet e mallrave dhe shërbimeve (% e BPV)	54.1	52.6	56.1	57.6	52.7
Bilanci tregtar në mallra dhe shërbime	-1588.0	-1470.8	-1604.0	-1790.3	-1725.2

(aktuale, mil. €)

Bilanci Tregtar në mallra (aktuale, mil. €)	-1734.4	-1658.3	-1736.8	-2047.2	-2045.5
Bilanci tregtar në shërbime (aktuale, mil. €)	146.3	187.4	132.9	257.0	320.4

Burimi: World Development Indicators (2014). <http://data.worldbank.org/data-catalog/world-development-indicators>

Megjithatë, situata aktuale me tregtinë fsheh një dallim të rëndësishëm mes tregtisë në mallra dhe tregtisë në shërbime. Në sektorin e mallrave, bilanci tregtar vazhdimisht negativ tejkalon vlerën e €2 miliard. Një sinjal tjetër dekurajues sa i përket tregtisë së mallrave është shkalla e ultë e diversifikimit të eksporteve dhe dominimi i mallrave me vlerë të shtuar të ultë, çfarë janë metalet dhe mineralet bazë (se bashku këto përbëjnë rreth 75 për qind të eksporteve totale në 2011). Pjesëmarrja e mallrave të eksportuara në BPV u rrit nga 3 për qind me 2008 në 5 për qind në vitin 2012. Për kontrast, sektori i shërbimeve në formë të arsyeshme ka performuar më mirë. Kosova ka regjistruar bilanc tregtar pozitiv në shërbime që nga viti 2006. Tabela 2 raporton bilanc tregtar pozitiv të shërbimeve në vlerë prej €320 milion gjatë vitit 2012, në rritje prej €146 milionëve në vitin 2008. Ka indikacione se sektorët e transportit, shërbimeve turistike, teknologjisë informative, dhe sektorit të ndërtimit kanë qenë mjaft aktiv në shërbim të tregjeve eksportuese. Megjithatë, kontributin më të madh në eksportin e shërbimeve e ka shitja e shërbimeve kompanive dhe personave të huaj të cilët jetojnë në Kosovë, të ashtuquajturit eksportues virtual. Pjesëmarrja e eksporteve të shërbimeve u rrit nga 10.7 për qind e BPV-së me 2008 në 12.7 për qind në 2012.

Partnerët kryesor tregtar, si për importe ashtu edhe për eksporte, kanë qenë shtetet fqinje dhe ato të BE-së. Në rajon, Serbia dhe Maqedonia kanë qenë partnerët kryesor, ndërsa Shqipëria është duke u bërë partner i rëndësishëm tregtar vetëm pas zhvillimeve të fundit në infrastrukturë. Në anën tjetër, 28 anëtarët e BE-së kanë eksportuar në Kosovë gjatë gjithë kohës në periudha të ndryshme, përderisa eksportet tek një numër i anëtareve evropiane mbetet praktikisht zero (si për shembull në Maltë, Luksemburg, Estoni). Partnerët kryesor tregtar mbesin të ngjashëm si për eksporte ashtu edhe për importe: Gjermania, Italia, Greqia, Sllovenia, dhe Belgjika. Të gjitha figurojnë në listën e partnerëve më të mëdhenj tregtar të Kosovës (shih diskutimin më vonë).

Ekziston një listë e gjatë e faktorëve të cilët ndikojnë në këtë situatë komplekse: struktura e trashëguar industriale, sektori i dobët privat, privatizimi i vonuar i ndërmarrjeve në pronë shoqërore, fluksi i ultë i investimeve të huaja direkte, institucionet me performancë të

dobët, infrastruktura e kualitetit të ultë, dhe kostoja e lartë e financimit janë vetëm disa sosh. Për më tepër, paqartësitë (rreziqet, kryesisht të ndërlidhura me paqartësitë rreth njohjes së statusit politik të vendit) dhe jo stabiliteti (struktura të brendshme të dobëta politikisht) kanë qenë pengesat kryesore të zhvillimit ekonomik, përfshirë këtu edhe sektorin e jashtëm. Disa prej problemeve kanë të bëjnë me politikat e aplikuara nga shtetet tjera, si për shembull, subvencionimi i industrive vendore apo formave të tjera të mbështetjes së industrisë vendore. Disa prej tyre, kanë të bëjnë veçanërisht me kompanitë, siç është produktiviteti i ultë, e që në anën tjetër lidhet me dobësitë e jashtme të përmendura më lartë.

Ballafaquar me bilanc tregtar vazhdimisht negativ të mallrave, politik-bërësit Kosovar kanë konsideruar opsione të ndryshme të tejkalimit të situatës. Qeveria e Kosovës ka ndërmarrë një numër hapash politik dhe institucional për të forcuar sektorin e eksportit. Një masë direkte ka qenë miratimi i Politikës Tregtare të Kosovës në 2009 (nga këtu 'Politika'). Politika propozon një numër të masave për përmirësim të performancës së sektorit të eksporteve në Kosovë, përfshirë këtu liberalizimin e tregtisë (p.sh. negociimi i marrëveshjes së re për tregti të lirë). Në vazhdim, politika pranon se përmirësimi i performancës në eksporte kërkon një qasje më të gjerë ndaj reformave, e veçanërisht të atyre politikave të cilat shtyjnë zhvillimin dhe koordinimin e politikave sektoriale (si p.sh. bujqësia, industria, dhe shërbimet). Përfundimisht, Politika argumenton për një dizajn specifik të institucioneve të ndërlidhura me tregtinë, e në veçanti, të krijimit të një mekanizmi koordinues që të lehtësojë dizajnimin dhe zbatimin e politikave tregtare.

Deri më tash, ekzistojnë mekanizma koordinues të cilët merren vetëm me lehtësime sektoriale si dhe çështje lehtësuese tregtare. Një dimension tjetër institucional i tregtisë është korniza legislative, e cila pothuajse është kompletuar; Ligji i ri për Tregti të Jashtme është miratuar më 2011. Poashtu, Kodi i Doganave dhe Akcizave të Kosovës është amandamentuar me 2012 në mënyrë që të inkuadrojë procedurat e operatorëve të autorizuar ekonomik, vlerësimittë riskut, procedurave të ankimit, dhe kundërvajtjeve administrative. Legjislacioni për masat e paparashikuara (anti-dumping, masat kundërbalancuese dhe masat mbrojtëse) është amandamentuar po ashtu me 2014 dhe inkorporon praktikat më të mira ndërkombëtare.

Përndryshe, regjimi tregtar në Kosovë është relativisht i thjeshtë. Ai aplikon vetëm dy shkallë tarifore, d.m.th., shkallë zero dhe 10 për qind. Shumica e materialeve lëndë e parë dhe e makinerisë që shkon për proces prodhues është e liruar nga detyrimet tarifore. Instrumentet jo-tarifore nuk ekzistojnë pothuaj fare.

Kosova ka ndërmarrë hapa të rëndësishëm drejtë hyrjes së bizneseve të saj në tregjet kryesore. Tregtia me dy blloqet kryesore tregtare, atë të shteteve të Ballkanit Perëndimor

dhe të BE-së, është pothuajse plotësisht i liberalizuar.⁸ Marrëdhëniet tregtare me vendet fqinje po realizohen nën kornizën e Marrëveshjes CEFTA. Brenda kësaj kornize, vendet në rajon kanë negociuar qasje të liruar nga taksat doganore për mallrat, ndërsa shërbimet janë në negociim e sipër (dhe pritet të përmbyllen në fillim të vitit 2016). Në anën tjetër, marrëdhëniet tregtare Kosovë-BE janë aranzhuar përmes statusit të trajtimit preferencial të dhuruar nga BE-ja për produktet kosovare që nga viti 2000. Dhjetë vjet pas hyrjes në fuqi, në Janar 2011, këto masa u suspenduan për shkaqe politike brenda bllokut evropian (kryesisht falë kundërshtimit nga pesë shtetet BE-së të cilat nuk njohin Kosovën si shtet). Përfundimisht, BE-ja tejkaloi këtë ngushticë, dhe tretmani preferencial për mallrat e Kosovës u vazhdua në Janar 2012. Në qershor 2013, Këshilli Evropian miratoi rekomandimet e Komisionit Evropian për të filluar negociimin e Marrëveshjes për Stabilizim dhe Asocim me autoritetet kosovare. Negociatat filluan në vjeshtë të vitit 2013, dhe në to, liberalizimi i lëvizjes së mallrave përbën pjesën kryesore të Marrëveshjes. Siç u vë në pah më herët, MSA-ja përmban një mundësi të rëndësishme që prodhuesit kosovarë të i qasen tregut më të madh botëror, e që në anën tjetër u dërgon sinjale të forta investitorëve potencial të huaj. Në mes të vitit 2014 palët janë pajtuar për tekstin dhe ai është sigluar. Marrëveshja tash pret miratimin e Këshillit të BE-së. Më shumë detaje për marrëveshjen gjeni në kutinë më poshtë:

Kutia 1: MSA-ja e negociuar mes BE-së dhe Kosovë

Siç është cekur, MSA-ja vë theks të veçantë në lëvizjen e mallrave dhe shërbimeve dhe në nevojën për konvergjencë përmes reformave institucionale në Kosovë. Në fillim, MSA-ja ofron dispozitat e përgjithshme, dhe vazhdon me dispozita specifike për proceset e vazhdueshme politike në Kosovë, për të përmbyllur me kërkesat për Kosovën për bashkëpunim ekonomik dhe rajonal (titulli I-III). Për më tepër, MSA-ja përqendrohet në lëvizjen e lirë të mallrave (Titulli IV); themelimi, ofrimi i shërbimeve dhe kapitalit (Titulli V); përafrimi i ligjeve të Kosovës me *Acquis Communautaire*, Zbatimi i Ligjit dhe Rregullat e Konkurrencës (Titulli VI); Drejtësia, Liria, dhe Siguria (Titulli VII); Politikat e Bashkëpunimit (Titulli VIII); Bashkëpunimi Financiar (Titulli IX); dhe Dispozitat institucionale, të Përgjithshme dhe Përfundimtare (Titulli X). Në vijim, ofrojmë një përmbledhje të dispozitave të MSA-së për mallra dhe shërbime.

Liberalizimi i mallrave

⁸ Më pak se 20 për qind e tregtisë realizohet me shtetet jashtë këtyre dy blloqeve tregtare, sidomos me Turqinë dhe Kinën. Në tetor 2013 Kosova nënshkroi Marrëveshjen për Tregti të Lirë me Turqinë. Hyrja e kësaj marrëveshje në fuqi është në pritje të ratifikimit nga dy parlamentet.

Në kontekst të lëvizjes së lirë të mallrave, palët janë pajtuar si më poshtë:

- Të vendoset gradualisht zona e tregtisë së lirë bilaterale brenda një periudhe deri 10 vjeçare duke filluar nga hyrja në fuqi e Marrëveshjes;
- Për produktet industriale të prodhuara në Kosovë, BE-ja është pajtuar të heq taksat doganore dhe kufizimet sasiore në importe, dhe masat me efekt ekuivalent, pas hyrjes së marrëveshjes në fuqi;
- Për produktet industriale të prodhuara në BE, Kosova është pajtuar të heq taksat doganore në mënyrë progresive brenda pesë dhe shtatë vjetësh pas datës së hyrjes në fuqi të Marrëveshjes (apo 1 ose 2 cent për çdo vit), përderisa të gjitha kufizimet sasiore, apo masat me efekt ekuivalent, do të hiqen pas hyrjes së Marrëveshjes në fuqi;
- Për produktet bujqësore të prodhuara në Kosovë, BE është pajtuar të shfuqizojë të gjitha taksat doganore pas hyrjes së Marrëveshjes në fuqi, me përjashtim të gjashtë seksioneve brenda Nomenklaturës së Kombinuar, në cilat në kuptim të gjerë përfshijnë disa lloje të kafshëve, mishit, dhe sheqernave dhe produkteve të ngjashme. Kuotë tarifore e veçantë do të aplikohet për mishin e viçit;
- BE-ja do të shfuqizoj të gjitha kufizimet sasiore ose masat me efekt ekuivalent në produktet bujqësore dhe të peshkut të prodhuara në Kosovë;
- Për produktet e peshkut, të prodhuara në Kosovë, BE është pajtuar të shfuqizojë të gjitha taksat doganore përveç për troftë dhe krap të cilat i nënshtrohen kuotave tarifore
- Për produktet bujqësore të prodhuara në BE, Kosova do të shfuqizojë të gjitha kufizimet sasiore, apo masave me efekt ekuivalent, ndërsa sa i përket taksave doganore, janë arritur këto marrëveshje:
 - Njëmbëdhjetë linja tarifore janë lënë jashtë negocimit dhe për to do të aplikohet norma tarifore prej 10 për qind ad valorem. Në vija të gjera, këto linja përfshijnë qumështin dhe produktet e tij, patatet, mollat (verë molle), dhe verë;
 - Për produktet tjera bujqësore, Kosova është pajtuar të ulë taksat doganore në formë progresive në tri korniza të ndryshme kohore, në varësi nga ndjeshmëria e produktit, për pesë, shtatë, dhe dhjetë vite, respektivisht (1 ose 2 cent në çdo vit);
- Për produktet e peshkut të prodhuara në BE, Kosova është pajtuar të shfuqizojë taksat doganore për të gjitha produktet, me përjashtim të dy linjave tarifore, troftës dhe skumbrit. Për prodhimet e fundit, reduktimi do të jetë progresiv, për 5 dhe 7 vite (1 ose 2 për qind në vit);
- Një protokoll i veçantë (Protokolli 1) është pajtuar për shkak të ndjeshmërisë së produkteve bujqësore të procesuara. Protokolli liston mallrat me taksë doganore të

- pajtuar në zero për importet nga Kosova në BE, dhe liston produktet e prodhuara në BE, në të cilin rast Kosova është pajtuar të heq taksat doganore në formë progresive brenda pesë, shtatë, dhe 10 vitesh pas hyrjes së MSA-së në fuqi. Tri linja tarifore (lloje kosi) janë lënë jashtë negociatave të MSA-së, ndërsa produktet nga BE-ja do t'i nënshtrohen normës tarifore prej 10%;
- Protokolli 2 përcakton dispozitat të cilat qeverisin fluksin e prodhimeve të verës dhe pijeve alkoolike mes Kosovës dhe BE-se. BE-ja do të aplikojë kuotat tarifore në disa vera të Kosovës, ndërsa Kosova do të reduktojë taksat doganore për verë në formë progresive;
 - Përtej koncesioneve taksore të garantuara për produktet industriale dhe bujqësore, në kontekst të lëvizjes së lirë të mallrave, MSA-ja mbulon dhe një numër nenesh siç janë: garancitë për bujqësi dhe peshkatari; mbrojtje të indikacioneve gjeografike; pastaj diskriminimi fiskal, dumpingu, subvencionet, dhe garancitë, mungesat; monopolet shtetërore; rregullat e origjinës, etj.
 - *Liberalizimi i shërbimeve*
 - Dispozitat mbi liberalizimin e shërbimeve janë të përshkruara nën Titullin V: Themelimi, Ofrimi i Shërbimeve, dhe Kapitali. Marrëveshja përcakton dispozita mbi të ashtuquajturat 4 mënyrat e ofrimit të shërbimeve siç i definon Marrëveshja e Përgjithshme për Tregtinë në Shërbime e OBT-së (e njohur si GATS). Katër mënyrat e GATS janë: ofrimi i shërbimeve ndërkufitare; konsumi jashtë vendit; prezenca komerciale; dhe prezenca e personave fizik. Më poshtë janë disa nga pikat më interesante të marrëveshjes në kontekst të shërbimeve:
 - Sa i përket të drejtës për të ndërmarrë aktivitet ekonomik përmes themelimit të kompanive, filialeve, dhe degëve, Kosova dhe BE-ja pajtohen t'u akordojnë parimin e mos-diskriminimit Kombi më i Favorizuar ofertuesve të shërbimeve përkatëse;
 - Sa i përket prezencës komerciale, palët janë pajtuar që:
 - Filialet dhe degët e kompanive evropiane do të kenë të drejtën, që nga hyrja në fuqi e marrëveshjes, që të shfrytëzojnë dhe marrin me qira pronë të patundshme në Kosovë;
 - Megjithatë, si me rastin e kompanive kosovare, filialet dhe degët e kompanive nga BE do të kenë të drejtën të fitojnë të drejtat pronësore të pasurive të patundshme, pesë vite prej hyrjes së Marrëveshjes në fuqi, kur këto të drejta janë të nevojshme për zhvillim të aktivitetit ekonomik për të cilin janë themeluar
 - Sa i përket prezencës së personave fizik, kompanitë e themeluara në territorin e palëve përkatëse kanë të drejtë të punësojnë punëtorë të cilët janë shtetas të BE-së dhe Kosovës respektivisht, përderisa këta punëtorë janë personel i kompanisë,

d.m.th., personel në pozita menaxherie apo të tillë që posedojnë njohuri të specializuar

- Kapitulli IV, nën titullin aktual, mbulon dispozitat mbi pagesat aktuale dhe lëvizje të kapitalit.

Sidoqoftë, pasqyra complete e liberalizimit me BE-në nuk është ende plotësisht e qartë për ndikimin që do ta ketë në mirëqenien qytetare. Së fundmi janë prodhuar një numër i skenarëve të cilët vlerësojnë ndikimin fiskal të MSA-së. Në këtë kontekst është studiuar edhe ndjeshmëria e importeve në nivel 2-shifror NACE (Linotte et al., 2013).⁹ Megjithatë, ndikimi i liberalizimit me BE-në në konsumim dhe punësim mbetet mister në mungesë të të dhënave të besueshme. Studimi aktual shikon përtej këtyre efekteve, pasi që synon pikë së pari të zbulojë masat politike të ashtuquajtura “përbrenda-kufirit” e që janë të nevojshme për të aktivizuar potencialin eksportues të Kosovës. Me 80 për qind të tregtisë së liberalizuar, zgjedhja e barrës që del nga deficit i buxhetor duhet të gjendet brenda oborrit të vetë Kosovës.

3. ANALIZA EMPIRIKE

3.1 Modeli dhe Hipoteza

Ky studim shfrytëzon mjetin kryesor në fushën e ekonomisë ndërkombëtare të aplikuar, modelin e gravitetit (shih Aneksin 1 për një përshkrim të shkurtër të këtij modeli). Ky model është aplikuar në kontekst të kornizave të ndryshme teorike për tregtinë, përfshirë këtu qasjen krahasimore të Ricardo dhe Heckscher-Ohlin-it, si dhe kornizën teorike të mëvonshme në tregtinë ndërkombëtare. Për më tepër, ky model është përdorur gjerësisht për të përcaktuar efektet ex-ante dhe ex-post të tregtisë dhe mekanizmave të tjerë politik. Për më tepër, është aplikuar në kuadër të sektorëve dhe shteteve të ndryshme.

Peci dhe tjerët (2010) është punimi i vetëm i publikuar që ka aplikuar modelin e gravitetit në rastin e Kosovës. Studimi ynë dallon në disa aspekte nga ky punim. Së pari, Peci dhe tjerët (2010) mbulon një numër të madh të raporteve tregtare (ndërsa ky punim përkufizohet në tregtinë me shtetet e BE-së) dhe hulumton në bazë të të dhënave vetëm të vitit 2008, duke rezultuar kështu me një numër të vogël të observimeve ndër-sektoriale të përmbledhura në nivel shteti. Studimi ynë bazohet në një panel të dhënash për tregtinë, i cili përbëhet nga vëzhgimet vjetore prej 2005 deri 2012. Për më tepër, në hulumtojmë fluksin tregtar si të përmbledhur ashtu edhe të zbërthyer në sektorë në bazë

⁹ Linotte dhe tjerët, (2013), Preparing Kosovo for the Trade Aspects of the Stability and Association Agreement Negotiations with the EU. Punuar si pjesë e projektit “Further Development of Kosovo’s Trade Policy” mbështetur nga BE, dhe realizuar nga GFA Consulting Group/ACE/CARDNO.

të vlerave 2-shifrore HS, gjë që mundëson kontrollin e fuqisë së rezultateve të dala. Së dyti, studimi ynë ndërtohet në bazë të avancimeve të fundit në modelimin teorik të ekuacioneve për gravitetin. Në këtë kontekst, modeli ynë, për aq sa është e mundur, merr parasysh faktorët rezistues të fluksit tregtar shumëpalësh. Në veçanti, në aplikojmë teknikat dinamike ekonometrike, të cilat konsiderojnë historinë e fluksit tregtar. Poashtu, vlerësojmë një model dinamik Poisson i cili konsideron edhe fluksin tregtar zero. Ky i fundit vije në shprehje në diskutimet e fundme mbi përshtatshmërinë metodologjike të modeleve të gravitetit të cilat nuk i marrin parasysh ‘zerot’ në matricën tregtare. Për më tepër, studimi ynë adreson çfarëdo shqetësimi me endogjenitetin potencial në kuadër të modelit. Së treti, ekzistojnë disa dallime në mes të dy studimeve sa i përket përcaktimit të ndryshoreve. Një veçori e dallueshme e Peci dhe tjerët (2010), prezente dhe në këtë studim, është efekti i promovimit të tregtisë që kanë komunitetet e diasporës. Megjithatë, përderisa Peci dhe tjerët (2010) definojnë efektin e diasporës duke përdorur Gjermaninë dhe Zvicrën si ndryshore cilësore, në specifikimet tona, ndryshorja cilësore e diasporës mbulon njëmbëdhjetë shtete për të cilat të dhënat për remitancat janë mjaft të mëdha për t’u regjistruar. Përderisa të dy përafrueset janë larg nga të qenit të përsosura, gjasat që ndryshoret cilësore për dy shtete të gjenerojnë efekte specifike në baza shtetesh me ndikim në tregti përtej efektit të komunitetit të diasporës janë më të mëdha.

Në formë tipike, procedura standarde për përllogaritjen e modelit të gravitetit është transformim i thjeshtë i ndryshoreve në logaritme natyrore. Shkuar hapave të Anderson dhe van Wincoop (2003), kjo gjeneron ekuacion të gravitetit në përputhje me teorinë dhe të log-lineare:

$$\ln X_{ij,t} = \hat{\beta}_0 + \hat{\beta}_1 \ln BPV_{i,t} + \hat{\beta}_2 \ln BPV_{j,t} + \hat{\beta}_3 \ln t_{ij,t} + \hat{\beta}_4 \ln \Pi_{i,t} + \hat{\beta}_5 \ln P_{ij,t} + \epsilon_{ij,t}$$

në të cilën i i referohet Kosovës, j harton treguesin e 28 partnerëve tregtar në BE ($j=1, \dots, 28$) dhe t harton dimensionin kohor ($t=1, \dots, 8$). Më tutje:

BPV_{it} dhe BPV_{jt} – BPV e shteteve i dhe j në vitin t ;

t_{ijt} – kostoja në j për importim të mallit nga i për vitin t , që përafrohet me distance në mes të dy shteteve;

Π_{it} dhe P_{jt} – rezistenca shumëpalëshe kah jashtë e shtetit i dhe rezistenca shumëpalëshe kah brenda e shtetit j në vitin t (për sqarim të këtyre termeve, shih Aneksin 1);

$\beta_0 \dots \beta_5$ janë parametra që duhen llogaritur (që tregohen me theksin ^) te cilët, pas transformimit të ndryshoreve në logaritme natyrale (që tregohen me $\ln$), masin elasticitetin konstant (p.sh. vlerësimi β_2 mat ndryshimin mesatar në përqindje të eksporteve nga shteti i si reagim ndaj ndryshimit në përqindje në të hyrat kombëtare të shtetit j – me fjalë tjera, elasticiteti i të ardhurave të kërkesës për eksporte kosovare); dhe

ε_{ijt} është termi i gabimit.

Këtu modeli i gravitetit ka për detyrë të vlerësojë përcaktuesit e eksportit. Modeli i njëjtë mund të riformulohet për të vlerësuar faktorët përcaktues të importit në një shtet i nga shteti j në vitin t . Ndërsa ndryshorja dhe definicionet tjera mbesin të pandryshuara.

Para se të kthehemi kah disa nga kufizimet e modelit aktual (shih seksionin e radhës), na duhet të diskutojmë përbërësit e ekuacionit, dhe zgjedhjet për modelet që i bëjmë në studimin aktual. Filluar me zgjedhjen e ndryshoreve të varur, literatura thekson se mund të përdoren një numër i alternativave, si p.sh. tregtia totale, fluksi i eksporteve, fluksi i importeve, apo mesatarja e flukseve tregtare dypalëshe. Argumentohet se zgjedhja duhet bërë në bazë të gjykimeve të qëndrueshme teorike. De Benedictis dhe Taglioni (2011), Shepherd (2013), dhe të tjerët argumentojnë se duhen përdorë të dhënat njëkahëshe për importet dhe eksportet, pasi që zgjedhjet tjera kanë gjasa të prodhojnë rezultate çorientuese. Ne aplikojmë këtë të fundit, që nënkupton se secili rresht në bazën e të dhënave përfaqëson një fluks të vetëm, qoftë eksport nga Kosova drejt ndonjë shteti të BE-së, apo import nga ndonjë shtet i BE-së në Kosovë në një vit të veçantë (ndryshoret janë të përcaktuara në formën respektive si *ex_ks* dhe *im_ks*; shih Tabelën 3) së bashku me vlerat korresponduese për secilën ndryshore të pavarur në anën e djathtë mbi ekuacionin e gravitetit. Tabela 3 përfshin poashtu dy ndryshore cilësore shtesë për të cilat besojmë se kanë ndikim të rëndësishëm në tregtinë e Kosovës, e të cilat e plotësojnë modelin e mësipërm: ndryshorja cilësuese shtesë për fluksin tregtar me një shtet të BE-së që ka komunitet të rëndësishëm të diasporës nga Kosova; dhe një ndryshore cilësore shtesë për ato flukse tregtare në të cilat të dy palët përdorin euron (me fjalë tjera ku tregtia zhvillohet përmes valutës së njëjtë). Shenja e efektit të pritur tregtar të secilës ndryshore është dhënë në kolonën e fundit të Tabelës 3.

Tabela 3: Përshkrimi i ndryshoreve

Ndryshoret	Përshkrimi	Shenja Exp.
------------	------------	----------------

Ndryshoret e varura

<i>im_ks</i>	Vlera monetare e importeve nga BE në Kosovë €	/
<i>ex_ks</i>	Vlera monetare e eksporteve nga Kosova në BE, €	/

Ndryshoret e pavarura

<i>imp_gdp</i>	BPV nominal për shtetin importues	(+)
<i>exp_gdp</i>	BPV nominal për shtetin eksportues	(+)
<i>dis_km</i>	Distanca në kilometra mes kryeqyteteve	(-)
<i>comc</i>	Ndryshore cilësore shtesë për shtetet të cilat kanë futur në përdorim € si valutë shtetërore	(?)
<i>rem</i>	Ndryshore cilësore shtesë për 11 shtete të BE-së m proporcionet me të mëdha të diasporës Kosovare (Austria, Belgjika, Danimarka, Finlanda, Franca, Gjermania, Italia, Holanda, Sllovenia, Suedia, BeM). Këto janë shtete prej të cilave gjenerojnë dërgesa mjaft të mëdha për t'u regjistruar në studim. Ato shtete të BE-së prej të cilave nuk ka rrjedhë të rëndësishme të dërgesave janë pranuar si shtete pa komunitete të konsiderueshme të diasporës.	

Siç është diskutuar më herët, modeli i gravitetit është në të vërtetë model i shpenzimeve, përmes së cilit BPV i importuesit afekton shpenzimet në shtetin e destinuar, d.m.th., në rastin tonë kjo nënkupton kërkesën totale në shtetet evropiane për eksportet kosovare; përderisa në anën tjetër BPV i eksportuesit afekton ofertën në shtetin e origjinës, d.m.th., numrin total të eksportuesve kosovar që janë të gatshëm të furnizojnë tregun evropian. Teoria sugjeron se që të dy ndryshoret e BPV-së duhet të jenë në raport pozitiv me flukset tregtare mes shteteve. Në rastin e parë, sa i përket BPV-së së importuesit (*imp_gdp*), teoria sugjeron raport pozitiv mes të hyrave të rritura dhe flukseve tregtare dypalëshe. Në rrethanat e një shteti të vogël (çfarë është Kosova për shembull, që është pranues i çmimit në tregjet ndërkombëtare), sipas kornizës së ekuilibrit të pjesshëm, një rritje në të hyrat e shtetit importues do të lëkund trajektoren e kërkesës në shtetin

importues. Si rezultat, rritja në sasinë e kërkuar në tregun vendor nxit një rritje në sasinë që furnizohet nga tregjet botërore. Shikuar nga perspektiva e BE-së, ky raport është më tjetër pasi që BE-ja, si njëra nga ekonomitë më të mëdha botërore, është përcaktuese e çmimeve në tregun botëror. Prandaj, rritjet në të hyrat e BE-së do të mund të reflektoheshin me rritjen e kërkesës e cila mund të përmbushet nga ofertuesit vendor njësoj si nga importet prej aktorëve konkurrent ndërkombëtar (përfshirë këtu potencialisht edhe prodhuesit/eksportuesit Kosovarë).

Në rastin e BPV-së së eksportuesit (*exp_gdp*), një rritje në të hyrat e shtetit rritë edhe kërkesën vendore. Kërkesa e rritur rrjedhimisht jo vetëm që shtynë ngritjen e çmimeve vendore por njëkohësisht shtynë edhe rritjen e çmimit botëror të mallit përkatës (në rrethanat e ekuilibrit të pjesshëm, kjo do të ishte relevante për BE-në si përcaktues i çmimeve në tregun botëror). Çmimi më i lartë i një malli, i cili gjeneron një nivel më të lartë të të hyrave, shkakton aktivitet/produktivitet më të lartë në anën e prodhuesit/eksportuesit. Kjo rrit nivelin e tregtisë dypalëshe, e cila reflektohet në formë të marrëdhënies pozitive mes të hyrave të shtetit eksportues dhe tregtisë dypalëshe. Shikuar nga perspektiva kosovare, një lojtare e vogël në tregun botëror, dhe si e tillë dhe pranuese e çmimit, rritja në nivelin e të hyrave duhet shikuar përmes prizmit të rritjes së nivelit të produktivitetit dhe konkurrueshmërisë së lojtarëve vendor. Me fjalë tjera, rritja e të hyrave të një shteti do të përmirësojë kualitetin e institucioneve, do të krijojë mjedis më të favorshëm për bizneset, infrastrukturë më të mirë, etj., të cilat në anën tjetër do të forcojnë eksportet ose kapacitetin ofertues të shtetit përmes rritjes së produktivitetit dhe konkurrueshmërisë të sektorit ndërmarrës.

Faktori i distancës futet në ekuacion si përfaqësues i kostos së tregtisë dypalëshe (*dis_km*). Siç sqaron Jacks et al. (2008), kostot e tregtisë dypalëshe përfshijnë koston e transaksioneve të lidhura me shkëmbimin e mallrave përmes kufijve nacional. Anderson dhe van Wincoop (2004) ndajnë kostot e tregtimit në kostot e transportit (kostoja e shpeditimit dhe kohës); barrierat nga politikat si tarifatat dhe ato jo-tarifore; kostoja e informimit; kostoja e detyrimit të kontratave; kostot e ndërlidhura me valuta të ndryshme; kostot ligjore dhe rregullative; dhe kostot e shpërndarjes lokale. Teoria parashikon se sa më e madhe të jetë distanca aq më e madhe do të jetë kostoja e transaksionit ndërkombëtar. Prandaj, marrëdhënia e pritur mes distancës dhe flukseve tregtare dypalëshe është negative. Në fjalë tjera, rritja e çmimit shkaktuar nga rritja e kostos së transaksionit dhe transportit do të shkaktojë rënie të sasisë së kërkuar, dhe me këtë edhe të tregtisë bilaterale dypalëshe mes shteteve.

Ekuacioni i gravitetit është rritur për të krijuar hapësirë edhe për ndryshore të tjera të shumta të tregtisë dhe të politikave (shih Aneksin 1). E kemi pasur të pamundur të i inkorporojmë që të gjitha, duke marrë parasysh se Kosova nuk ka specifika të përbashkëta gjeografike apo historike me BE-në e të cilat janë inkorporuar në modelet tjera empirike të gravitetit. Megjithatë, pas luftës më 1999, në kontekstin e ndërtimit të paqes, Kosova vendosi të i bashkohet Euros si tender ligjor. Si rezultat, në prezantojmë në këtë studim ndryshoren cilësore shtesë duke përdorur vlerën 1 për çdo fluks tregtar me një shtet të BE-së që ka adoptuar Euron (*comc*), ndërsa zero për të tjerat. Çështja e miratimit të valutës së përbashkët në flukset tregtare ndërkombëtare ka qenë çështje e hulumtimeve të shumta. Në veçanti, unioni monetar brenda BE-së ka shkaktuar një rrjedhë të hulumtimeve të kësaj çështjeje. Shumica e hulumtimeve e pranojnë ndikimin pozitiv në fluksin tregtar. Arsyeimi për këtë është si në vijim: paqëndrueshmëria e kursit të shkëmbimit valutor rritë shkallën e paqartësisë në tregtimin ndërkombëtar, dhe me këtë edhe kostot e transaksionit ndërkombëtar. Rose (2000) dhe Frankel dhe Rose (2002) përdorin modelet e gravitetit për të vlerësuar efektet e paqëndrueshmërisë së kursit të shkëmbimit dhe unioneve monetare në tregti. Në një mostër prej 200 shtetesh, ata tregojnë ndikimin madhor pozitiv që valuta e përbashkët ka në tregti dhe të hyra. Megjithatë, analizat e meta-regresionit të kohës së fundit të kësaj literature tregojnë se “efekti i euros për të promovuar tregtinë është i parëndësishëm” (Havranek, 2010, p.241). Sipas kësaj, efekti i prituri i kësaj ndryshore është i dhënë si i ‘paqartë’ (?) në Tabelën 3.

Një shtojcë e rëndësishme në këtë model është diaspora e Kosovës në BE. Shumë studime e ndërlidhin diasporën, migrimin, dhe dërgesat me zbutjen e varfërisë dhe zhvillimin ekonomik të shtetit të origjinës. Njëra prej kanaleve se si është arritur kjo siç evidenton literatura është lidhja reciproke pozitive e fuqishme mes tregtisë dhe migrimit. Parsons (2012) përmbledh diskutimin në serinë e tregtisë dhe migrimit; duke pasuar Gouldin (1994) ai sqaron se literatura ka identifikuar dy kanale përmes të cilit diaspora ose migrimi ushqejnë tregtinë mes shteteve të banimit dhe shtetit të origjinës/lindjes: *e para*, përmes uljes së kostove të transaksionit në tregti; dhe *e dyta* duke kërkuar thjeshtë produkte të prodhuara në shtetin amë. Kanali i parë është i një rëndësie të veçantë dhe kërkon vëmendje të mëtutjeshme. Diaspora nuk ka barriera gjuhësore, pasi shumë shpesh flasin dy gjuhë. Ata janë mirë të informuar për legjislacionin në të dy vendet, dhe mund të kenë njohuritë e nevojshme për produktet në dispozicion në të dy shtetet. Për më tepër, diaspora/migrantët kanë pozitë ideale të promovojnë kontaktet dhe rrjetëzimin mes shitësve dhe blerësve, dhe në këtë mënyrë të tejkalojnë asimetrinë informative dhe të ulin kostot e transaksioneve tregtare. Në përputhje me rrethanat,

ndryshore cilësore shtesë është prezantuar në modelin i cili kapërthen shtetet e BE-së me numrin më të madh të diasporës kosovare (*rem*).

Në model inkuadrojmë edhe ndryshore të cilat shpjegojnë mostrat historike të tregtisë (në model i inkuadrojmë vlerat e para të kaluara të ndryshoreve të varura, dhe në specifikimin tonë të preferuar, edhe ndryshoren e kushteve fillestare, me fjalë tjera, niveli i tregtisë në periudhën e parë të mostrës). Ne kemi arsye të forta të besojmë se mostrat tregtare nga e kaluara e Kosovës ende janë aktuale, apo së paku ndikojnë ato aktualet. Teoria dhe të dhënat empirike së bashku sugjerojnë se historia luan rol të rëndësishëm në formësimin e flukseve tregtare ndërkombëtare (De Benedictis dhe Taglioni, 2011, f.85). Në punimin e tyre seminarik Eichengreen dhe Irwin (1998, f. 55) mbështesin fuqishëm këtë qëndrim; sipas tyre, shtetet me histori të bashkëpunimit tregtar mes njëra tjetrës vazhdojnë ta bëjnë këtë ose për arsye politike, politikash, apo ndonjë tjetër. Ato vënë gishtin tek një numër goditjesh (p.sh. lufta, depresioni, tarifat e përkohshme, goditjet nga shkëmbimi valutor, etj.) të cilat kanë ndikim në zhvillimet e ardhme të tregtisë dypalëshe. Duke u nisur nga këto premisa, autorët argumentojnë se ndryshimet në flukset tregtare mund të prodhojnë efekte me vazhdimësi të rëndësishme. Duke analizuar evoluimin e tregtisë mes viteve 1949 dhe 1964 përmes modelit të gravitetit, autorët argumentojnë se mosinkuadrimi i faktorëve historik ka gjasa të nxjerrë rezultate të njëanshme të efekteve tregtare, duke ekzagjeruar në veçanti ndikimin e instrumenteve politike tregtare (siç janë marrëveshjet tregtare). Nga të gjeturat e tyre, autorët vijnë në përfundim se (f. 56):

Ajo çfarë nënkuptohet nga e tërë kjo është se ne kurrë më nuk do të ekzekutojmë një ekuacion tjetër graviteti i cili përjashton flukset e kaluara tregtare. Në punimi ynë do të jetë i suksesshëm (dhe i lexuar anë e mbanë), nuk do të jenë as hulumtuesit e tjerë.

Të dhënat nga niveli i kompanive, teorike dhe empirike, mbështesin gjerësisht qëndrimin e Eichengreen dhe Irwin. Për shembull, teoria e mësimit – e rrënjësuar në teorinë e sjelljes së kompanive – argumenton se zhvillimi i njohurive dhe përtëritja e tyre me aktivitet vendore dhe të huaja mund të këtë ndikim në perceptimet e mundësive të ofruara nga ndërkombëtarizimi i mëtutjeshëm (shih Clercq et al., 2005). Në vazhdim, në kohën e fundit është zhvilluar një vijë e re e literaturës për tregtinë ndërkombëtare e cila ndërlidh heterogjenitetin e kompanive me pjesëmarrjen në tregjet e huaja. Kjo qasje, të cilin e inicoi Melitz (2003) me punën e tij kërkimore, argumenton se hyrja dhe dalja e kompanisë në tregjet ndërkombëtare varet nga dallimet në produktivitet. Sipas tyre, vetëm kompanitë më produktive e shohin si profitabile të eksportojnë. Argumenti shkon më tutje të theksojë se profitabiliteti është në varësi me distancën; që nënkupton se është më i lartë për eksportet

në shtetet me nivele më të larta të kërkesës dhe me ndryshore më të ultë dhe kosto fikse të eksportit. Sipas të dhënave empirike, përvoja nga eksportet ka shërbyer në disa raste të sqarojë mostrat e strategjive hyrëse dhe dalëse të kompanive në prezencë të kostove të fundosura. Në një panel të dhënash për periudhë nëntë-vjeçare të kompanive prodhuese, Roberts dhe Tybout (1997) gjejnë se përvoja e mëhershme eksportuese rritë probabilitetin për eksport për 60 për qind. Ngjashëm, Bernard dhe Jensen (2004), në një panel të dhënash për periudhë dymbëdhjetë-vjeçare për kompanitë prodhuese amerikane vijnë në përfundim se eksportimi sot rritë gjasat për eksportim nesër për 39 për qind. Me tutje, Bernard dhe Wagner (1998), në një panel me të dhënat për kompani prodhuese gjermane gjejnë se eksporti i mëhershëm rrit gjasat që fabrika të eksportoje në të ardhmen për 50 për qind.

Në fund, në kuadër të këtij studimi dhe brenda kufizimeve të dhëna nga domosdoshmëria prioritare për të vlerësuar modele dinamike, kontrollojmë rezistencën shumëpalëshe tregtare (Πit dhe Pjt) duke vlerësuar modele dinamike specifike për efektet në palë shtetesh – të përfshira në termin e gabimit – përderisa adresojmë problemin e jo-ekzogjenitetit të ndryshores së varur të tregtisë në të kaluarën. Për më tepër, në bëjmë përlogaritjen e efekteve tregtare, të kushtëzuara nga ndryshorja cilësore shtesë për vitin/periudhën (duke lënë jashtë vetëm të parin, në mënyrë që të gjitha efektet për periudhat të jenë të vlerësuara në raport me periudhën bazë të lënë jashtë). Këto vejnë kontrole mbi efektet e rezistencës shumëpalëshe tregtare të varura nga dimensionin kohor deri në atë masë sa që këto janë të ngjashme për gjitha çiftëzimet shtetërore. Vështirësitë dhe lëshimet pasuese që kanë të bëjnë me modelimin e efekteve dinamike dhe rezistencës tregtare shumëpalëshe janë të diskutuara në Aneksin 1.

3.2 Të dhënat

Ky studim përdorë data bazën e statistikave për tregtinë e jashtme, të organizuar në një panel 8-vjeçar (gjatësor) sipas të dhënave të siguruar nga Agjencia e Statistikave të Kosovës. Të dhënat vjetore përfshijnë periudhën prej vitit 2005 deri në vitin 2012. Të dhënat e grumbulluara përgjatë kësaj periudhe sigurojnë të dhëna të detajuara dhe të kualitetit të lartë për tregtinë agregate të Kosovës me gjithë botën. Për arsye se nuk janë të besueshme, ne nuk kemi përdorë të dhënat para vitit 2005. Përveç të dhënave agregate, baza e të dhënave ofron të dhëna të zbërthyer në nivel sektorial si për eksporte ashtu edhe për importe dhe atë sipas klasifikimeve HS dhe SITC (Rev. 4) . Për të dyja, shkalla e zbërthimit është e lartë dhe shkon deri në 8 shifra. Për qëllim të këtij studimi, ne do të përdorim të dhënat e zbërthyer deri në nivelin 2-shifror të HS-së.

Studimi poashtu fut në përdorim edhe burime të tjera të të dhënave për BPV nominal të vendeve eksportuese dhe importuese si dhe distancën në mes të kryeqyteteve.¹⁰ Për të parën analiza përdorë të dhënat e Indikatorëve të Zhvillimit Botëror të Bankës Botërore. Distanca është matur përmes platformës online “viamichelin.com,” përmes cilës është matur distanca gjeografike/fizike në kilometra mes kryeqyteteve.¹¹ Të dhënat për dërgesat janë siguruar nga Banka Qendrore e Kosovës. Pasi që të dhënat për dërgesat janë mbledhur vetëm nga shtetet prej të cilave janë pranuar shuma të konsiderueshme të dërgesave, këto të dhëna janë përdorë për të krijuar ndryshore cilësore shtesë (shih Tabelën 3 më lartë).

4. REZULTATET

Për t’u dhënë kuptim rezultateve ekonometrike, ne së pari i raportojmë statistikat përshkruese. Pastaj, diskutojmë radhazi secilën ndryshore të modelit. Veni re që diskutimi i rezultateve do të varet nga modeli dinamik Poisson, mirëpo ne do t’i referohemi edhe vlerësimeve të dala nga modeli dinamik linear.

4.1 Statistikat përshkruese


Tabela në vijim prezanton disa statistika të rëndësishme për ndryshoren e inkuadruar në model. Si plotësim, grafikët më poshtë tregojnë fluksin e importeve dhe eksporteve përgjatë periudhave kohore me partnerë të rëndësishëm nga BE-ja (shih po ashtu grafikët A1 – A4 në Aneksin 3, të cilat prezantojnë fluksin e importeve dhe eksporteve, përgjatë kohës, vlerën mesatare 8-vjeçare të importeve dhe eksporteve për secilin shtet anëtar të BE-së). Mesatarisht, gjatë periudhës 2008-2012, vlera e importeve ishte gati nëntë herë më e lartë se vlera e eksporteve. Të dhënat tregojnë se gjithë 28 anëtarët e BE-së kanë eksportuar në Kosovë, në një periudhë apo tjetrën gjatë dekadës së fundit, ndërsa për dallim, Kosova ka eksportuar në vendet kryesore të BE-së. Partnerët madhor tregtar janë të ngjashëm për eksporte dhe importe. Me mbi €1.7 miliard, eksportuesi më i madh në Kosovë gjatë periudhës 8-vjeçare ka qenë Gjermania, pas të cilës pason Italia me pak më pak se €800 milion për periudhën e njëjtë, dhe Greqia me mbi €600 milion. Sa i përket eksporteve, të dhënat tregojnë se gjatë periudhës 8-vjeçare, Italia ka qenë dukshëm tregu kryesor evropian për mallrat nga Kosova me vlerë prej €335 milion, e pasuar nga Gjermania në të cilën janë eksportuar mallra në vlerë rreth €100 milion, dhe Belgjika me rreth €55 milion.

Tabela 4. Statistikat e përmbledhura për të dhënat totale


¹⁰ Tashmë pranohet gjerësisht se në modelet e gravitetit duhen përdorur ndryshoret nominale

¹¹ Shih www.viamichelin.com (vizituar: nëntor-dhjetor 2013).

Ndryshoret	Mesata rja	Dev. stand.	Min	Max	Fraksionet	
					1	0
Ndryshoret e varura						
Importi në Kosovë (mln.)	27.1	47.8	0.0004	304.0	-	-
Eksportet nga Kosova (mln.)	3.1	10.2	0	8.4	-	-
Ndryshoret e pavarura						
BPV i Kosovës (miliard)	3.9	0.6	3.0	4.8	-	-
BPV i shteteve të BE-së (miliard)	436.0	659.0	4.9	2,650.0	-	-
Distanca (km)	1,706.7	829.3	286	3,504	-	-
Valuta e Përbashkët	-	-	-	-	75.9	24.1
Diaspora	-	-	-	-	39.3	60.7



Ekziston një gamë e gjerë e produkteve të importuara nga BE-ja. Prej 2005 deri më 2012, produktet elektronike, si makineria, vetura, dhe pajisje elektrike, dominojnë strukturën e importeve. Për më tepër, importet tjera përqendrohen tek produktet si benzina dhe derivatet e naftës, prodhimet ushqimore, druri, plastika, dhe kategori tjera të mallrave. Në anën tjetër, prodhimet e papërfunduara minerale dominojnë eksportin nga Kosova, dhe përfshijnë mbetjet dhe hekurishtet prej hekuri ose çeliku, bakri, alumini, zinku, dhe nikeli. Në total, gjatë periudhës 8 vjeçare, Kosova ka eksportuar këso mallrash përafërsisht në vlerë prej €500 milion. Prodhime tjera të eksportuara janë ato bujqësore, ushqim, gëzof dhe lëkura, si dhe disa prodhime tekstili. Tash për tash janë vetëm 8 kategori HS 2-shifrore në të cilat Kosova ka shënuar bilanc pozitiv tregtar gjatë periudhës 8-vjeçare. Kategoritë e mbetjeve dhe hekurishteve prej hekuri ose çeliku dhe xehet shënojnë suficitin më të lartë në tregti, me vlerë prej mbi €300 milion. Pas tyre pasojnë mineralet tjera, si bakri dhe plumbi, me një suficit tregtar prej €50 milion, dhe €4.5 milion respektivisht. Gëzofi dhe lëkura e papërpunuar, dhe prodhimet tjera relevante nga lëkura përbëjnë një suficit relativisht të lartë me vlerë prej €35 milion për periudhën 8-vjeçare.



Në gjithë botën, një pjesëz e tregtisë zhvillohet brenda industrisë së njëjtë. Një matje e përdorur më së shpeshti për të gjetur rëndësinë e tregtimit brenda industrisë së njëjtë është indeksi Grubel-Lloyd (për më shumë detaje në këtë indeks shih OBT, 2012). Indeksi Grubel-Lloyd merr vlerat prej 0-1, në të cilën 0 do të thotë tregtim një-kahësh, qoftë eksport apo import, ndërsa sa më afër të jetë unitetit, kjo nënkupton ngjashmëri më të madhe në fluksin tregtar. Tabela 5 raporton indeksin Grubel-Lloyd për shtatë industri për të cilat indeksi është më i lartë apo i afërt me 0.5. indeksi i tregtimit brenda industrisë është më i lartë se 0.5 vetëm në 4 industri, gjë që konfirmon argumentin se vetëm shtetet e ngjashme (përnga BPV) bëjnë më shumë tregti brenda industrisë.

Tabela 5. Tregtia brenda industrisë: Indeksi Grubel-Lloyd

Kapitu lli HS	2005	2006	2007	2008	2009	2010	2011	2012	Mesata rja	Bilanci tregtar (mil. €)

76	0.975	0.557	0.666	0.827	0.849	0.743	0.635	0.226	0.685	-29.2
47	0.823	0.559	0.725	0.713	0.294	0.499	0.712	0.516	0.605	-2.4
07	0.998	0.550	0.512	0.381	0.331	0.535	0.452	0.735	0.562	-13.7
72	0.461	0.946	0.803	0.882	0.490	0.243	0.237	0.322	0.548	-37.6
40	0.056	0.420	0.418	0.740	0.697	0.611	0.541	0.413	0.487	-6.5
79	0.526	0.805	0.164	0.177	0.413	0.140	0.489	0.949	0.458	-17.3
25	0.000	0.171	0.226	0.768	0.781	0.862	0.664	0.016	0.436	-29.2

Shënim: Emërtimet HS:

76: Alumin dhe artikuj prej tij

47: brumi i letrës, mbeturinë, dhe skrap letra

07: perime të ngrënëshme

72: Hekur dhe çelik

40: Gomë dhe artikuj prej saj

79: Zink dhe artikuj prej tij

25: Krip, sulfur, dhe gurrë, gëlqere dhe çimento

Duhet pasur kujdes gjatë interpretimit të indeksit Grubel-Lloyd, pasi që ai rritet me nivelin e agregimit të industrisë që analizohet (për të pasur më së shumti kuptim, indeksi duhet të përllogaritet në një shkallë delikate të zbërthimit të produkteve). Po ashtu, indeksi nuk tregon shumë sa i përket vlerës së mallrave të cilat lëvizin në të dy drejtimet (shiko trendët negative të bilancit për këto produkte në kolonën e fundit). Megjithatë, kur diskutohet tregtimi brenda industrisë, duhet pasur kujdes si vijon (që është mjaft

treguese për indeksin Grubel-Lloyd): së pari, ashtu si ecën para niveli i integritit (për shembull, me liberalizmin e pritur), ai do të stimulojë tregtimin vertikal mes Kosovës dhe BE-së, e që është tregtim në mallra më avantazhe krahasuese. Së dyti, ashtu siç madhësia ekonomike e Kosovës i afrohet mesatares evropiane, ashtu do të nxitet tregtimi horizontal, e që nënkupton, tregtimin në mallra të ngjashëm por të diferencuar. Indeksi Grubel-Lloyd do të jetë i dobishëm për t'i përcjellë ndryshimet me kohë.

4.2 Gjetjet empirike¹²

4.2.1 Roli i Historisë

Pa marrë parasysh nëse vlerësojmë të dhëna për eksportin apo importin, gjejmë koeficientë pozitiv dhe me vlerë të lartë statistikore për kushtet fillestare të tregtimit dhe/ose tregtimin në të kaluarën. Me përjashtim të koeficientit për tregtimin në të kaluarën në vlerësimet dinamike Poisson për eksportet agregate, edhe pse kjo është pak a shumë në kufi të rëndësisë statistikore në nivele konvencionale, të gjithë koeficientët e tjerë që lidhen me ndikimet historike janë në përputhje dhe kryesisht me rëndësi statistikore në nivelin 1 për qind. Këto rezultate konfirmojnë preferencën tonë për modelimin dinamik të tregtisë së Kosovës (shih Tabelat 8 deri 11).

Për eksportet agregate (Tabela 8, kolona 2), në qoftë se eksportet në 2005 drejt një vendi të BE-së kishin qenë për 1për qind më të larta, atëherë koeficienti i vlerësuar në 2.29 me këtë kusht fillestar sugjeron që – përderisa faktorët tjerë mbesin të pandryshuar – eksportet nga Kosova në këtë vend të veçantë në çdo vit në mostër do të kishin qenë gati 23 € milionë më të lartë (duke reflektuar në rishkallëzimin të njërive prej € 10 milionë; kjo vlen për të gjitha vlerësimet dinamike Poisson). Në të kundërtën, koeficienti në ndryshoren e varur të kaluarës sugjeron që një rritje prej një për qind i tregtisë *në vitin paraprak* shkakton një rritje në vitin aktual prej € 2.3 milion. Në nivel të sektorit, të dy koeficientët e vlerësuar sugjerojnë efekte më të mëdha të eksportit: për vetëm 1 qind eksporte më të larta fillestare në një sektor të caktuar, koeficienti 13.80 sugjeron eksporte deri në €138,000,000 më pas; ndërsa koeficienti 0.75 sugjeron persistencë të lartë në nivel sektori, duke theksuar se 1 për qind rritje në tregtinë e vitit paraprak shkakton mesatarisht një rritje të eksportit në vitin aktual prej €7.5 milion. Vlerësimet dinamike lineare të kushteve fillestare dhe ndryshoreve të varura nga e kaluara të raportuara në Tabelën 8 në aspektin kualitativ janë të ngjashme me ato nga modeli

¹² Para se të fillohet me interpretimin e të dhënave, lexuesi këshillohet të shikojë Aneksin 2 i cili diskuton veçantitë për interpretimin e të dhënave dhe specifikacionet ekonometrike të Modelit Dinamik Poisson, përfshi këtu diskutimin në specifikacionet e preferuara të modelit tonë.

përkatës dinamik Poisson sepse janë nxjerrë nga mostra më të vogla (shumë më të vogla në rastin e vlerësimeve sektoriale).

Për të dy llojet e importeve, sektoriale dhe totale (tabela 10), efektet dinamike të llogaritura janë kryesisht më të ulta, dhe kështu demonstrojnë se efekti i historisë në importe nuk është përbërës i fuqishëm në raportet tregtare mes Kosovës dhe BE-së siç është në rastin e eksporteve. Me rastin e importeve, koeficientet e gjendjes fillestare kanë domethënie statistikore në nivelin 1 për qind me shtrirje prej 0.21 dhe 6.60 për importet totale dhe sektoriale, respektivisht (krahasuar me 2.29 dhe 13.80 në rastin e eksporteve). Koeficienti i vlerës së kaluar të importeve totale, 0.025, në aspektin statistikor nuk dallon shumë nga zero, përderisa importet sektoriale në të kaluarën tregojnë koeficient të rëndësisë statistikore prej 0.35 (krahasuar me 0.23 dhe 0.75 në rast të eksporteve).

Kjo është e dhënë e re për tregtinë ndërkombëtare të Kosovës e cila kombinon përshtypjet e mëhershme për mungesën e dinamizmin të eksporteve Kosovare. Mostra aktuale e eksporteve nga Kosova nuk është e ndikuar vetëm nga e kaluara, por është më shumë e ndikuar nga mostrat e krijuara në vitin 2005. Kjo sugjeron mungesë të fleksibilitetit në ofertë; që nënkupton, me shume gjasa mungesën e mundësisë së kompanive kosovare për të hyrë në tregjet e reja. Në të kundërtën, mostra aktuale e importeve të Kosovës zbulon varësi dukshëm më të ultë në mostrat e kaluara, dhe fleksibilitet shumë më të lartë në anën e kërkesës; që nënkupton mundësi për kompanitë evropiane të hyjnë në tregun e Kosovës. Si mund të sqarohet kjo për Kosovën? Për këtë duhet shikuar të dhënat mbi tregtinë e Kosovës me shtetet e hemisferës perëndimore derisa ishte ende pjesë e Jugosllavisë dhe duke reflektuar në disa sqarime të cilat i ofron literatura.¹³

Kur shikohen të dhënat zyrtare të tregtisë në Kosovë në të kaluarën, ajo çfarë shihet mes viteve 1970 deri 1980 në strukturën e tregtisë dhe partnerëve tregtarë kryesisht paralajmëron situatën aktuale në tregtinë ndërkombëtare (shih Tabelën 6). Në vazhdojmë të eksportojmë pak a shumë mallrat e njëjtë dhe tregtojmë kryesisht me partnerët e njëjtë. Përgjatë viteve 1970 dhe 1980 eksportin nga Kosova e kanë dominuar metalet si boksiti, plumbi, zinku, kromi, magnezi, nikeli, etj. duke përbërë kështu gati 50 për qind të eksportit total në fillim të viteve 1970, e duke vazhduar me rënie konstante deri kah fundi i viteve 1980. Produktet tjera të eksportuara në këtë periudhë janë mallrat gjysmë të përpunuara nga fuqia e ultë punëtore, siç janë tekstilet dhe prodhimet ushqimore. Që nga fillimi i viteve 1980, me avancimin në ekonomi strukturën e

¹³ Nuk ekzistojnë të dhëna për fluksin tregtar prej dhe në Kosovë gjatë viteve të para të tranzicionit, d.m.th., gjatë viteve 1990

eksporteve fillojnë ta dominojnë mallrat që kërkojnë kapital intensiv, çfarë janë makineria dhe pajisjet.

Tabela 6: Struktura e eksporteve nga Kosova, 1976 – 1986, në %

	1976-78	1979-81	1982-84	1985-86
Metalet	45.79	30.34	23.62	23.85
Prodhimi i makinerisë dhe pajisjeve	9.92	14.52	33.36	36.82
Prodhime tekstili	25.46	21.07	15.52	12.18
Energji	0	0.32	2.11	6.81
Prodhime ushqimore, pije, dhe duhan	5.09	5.89	3.38	1.25
Të tjera	13.75	27.87	22.01	19.09

Burimi: Vjetari Statistikor i KSA të Kosovës (1976 - 1988)

Sa i përket tregjeve kryesore për eksport, ngjashëm me kohën e tashme, eksportet e fillimit të viteve 1970 ishin të përqendruara në dy blloqe tregtare, domethënë, shtetet në rajon (apo shtetet që ishin në ndikim të Rusisë) dhe shtetet e OBZhE-së.¹⁴ Ngjashëm si në kohën e pasluftës, Gjermania dhe Italia ishin destinacionet kryesore të mallrave kosovare. Së bashku, këto dy shtete absorbonin mesatarisht rreth 15 për qind të eksporteve të Kosovës mes viteve 1972-1986. Tani, shtetet evropiane, siç u cekë më lartë, absorbojnë diku rreth 50 për qind të eksporteve kosovare. Ky ndryshim mund t'i atribuohet ndryshimeve të rezultuara nga kalimi prej ekonomisë së kontrolluar në ekonomi të tregut. Me fillimin e këtij tranzicioni, dhe liberalizim të gjerë të tregut, eksportet e Kosovës u orientuan kah partnerët e përforcuar tregtar e që janë BE-ja dhe shtetet fqinje.

Tabela 7: tregjet kryesore të eksportit, 1972 – 1986, në %

	1972-74	1975-77	1978-80	1981-83	1984-86
Shtetet OBZhE					

¹⁴ Veni re që të dhënat nuk inkuadrojnë tregtinë me entitetet tjera jugosllave, pasi që kjo trajtohej si tregti e brendshme

Gjermani ^a	16.60	8.20	11.13	8.51	9.67
Itali	4.03	5.19	6.23	4.39	4.07
SHBA	10.01	14.15	10.48	4.07	1.55
Shtetet socialiste					
BRSS	24.57	43.57	36.94	47.24	39.59
Çekosllovakia	18.40	8.35	7.49	17.17	13.21
Shqipëria	0.80	0.55	2.15	1.68	0.90
Bullgaria	4.71	0.58	1.70	1.35	0.49
Rumania	4.41	4.11	2.52	2.32	5.38
Shtetet tjera	16.47	15.29	21.37	13.27	25.14

Çfarë tregojnë këto modele persistente të tregtisë? Siç e kemi cekur më herët,

Burimi: Vjetari Statistikor i KSA të Kosovës (1976 - 1988)

^{a)} Gjermania përfshin Republikën Federal Gjermane dhe Republikën Demokratike të Gjermanisë. Eichengreen dhe Irwin (1998) vënë në pah aksidentet historike si luftën, depresionin, ndryshimin e përkohshëm të tarifave, shokun në kurse të shkëmbimit, etj, si përgjegjës kryesor të mostrave persistente të tregtisë. Asnjëra nga këto nuk mund të shihet në tregtinë mes Kosovës dhe BE-së. Bazuar në strukturën e tregtisë para dhe pas shpërbërjes së Jugosllavisë shumë lehtë shihet se këtu hyjnë në lojë forcat e përparësisë krahasuese. Ngjashëm me kornizën Heckscher-Ohlin, Kosova tradicionalisht në BE ka eksportuar prodhime në vijë me përparësitë krahasuese statike siç janë

Tabela 8: përcaktuesit e tregtisë dypalëshe: të dhënat për eksportin

	Modeli Dinamik Poisson		Modeli dinamik linear		model FE (pooled OLS)	
<i>Ndryshoret e pavarura</i>	Niveli i eksporteve		Log-u i eksporteve		Log-u i eksporteve	
<i>Ndryshoret e varura</i>	total	sektorial	total	sektorial	total ¹⁾	sektorial

Log-u i importuesve BPV(<i>lnim_gdp</i>)	0.104 (0.592)	0.408*** (0.005)	0.296** (0.052)	0.191** (0.015)	-	0.359 (0.816)
Log-u i eksportuesve BPV (<i>lnex_gdp</i>)	5.313 (0.463)	5.081 (0.484)	4.287 (0.320)	-0.436 (0.858)	0.732 (0.760)	1.522 (0.839)
Log-u i distancës (<i>Indist_km</i>)	-1.404*** (0.002)	-1.673*** (0.000)	-1.182** (0.024)	-0.747*** (0.000)	-3.691*** (0.000)	-4.774 (0.161)
Valuta e përbashkët (<i>comc</i>)	-0.189 (0.722)	0.125 (0.808)	-0.037 (0.924)	0.119 (0.577)	-0.017 (0.984)	0.136 (0.734)
Komuniteti i Diasporës (<i>rem</i>)	1.807*** (0.000)	2.182*** (0.000)	0.468 (0.402)	0.331 (0.120)	4.209*** (0.001)	0.378 (0.301)
Gjendja fillestare (tregtia në vitin 2005)	2.285** (0.025)	13.799** * (0.000)	-	-	-	-
Tregtia në të kaluarën	0.233*** (0.001)	0.747*** (0.000)	0.630*** (0.000)	0.364*** (0.000)	-	-
Konstanta	-24.880 (0.553)	-28.129 (0.504)	-88.242 (0.365)	16.246 (0.762)	17.131 (0.783)	-0.569 (0.997)

Ndryshore cilësore shtesë për vitin	Po	Po	Po	Po	Po	Po
Ndryshore cilësore shtesë për palë shtetesh	Po	Jo	Po	Jo	Jo	Jo
Palë shtetesh me ndryshore cilësore shtesë sektoriale	Jo	Po	Jo	Po	Jo	Jo
Ndryshore cilësore shtesë për sektorë	Jo	Jo	Jo	Jo	Jo	Po
Ndryshore cilësore shtesë për shtetin importues	Jo	Jo	Jo	Jo	Po	Jo
Ndryshore cilësore shtesë për sektorë të shtetit importues	Jo	Jo	Jo	Jo	Jo	Po
Numri i vëzhgimeve	196	19,012	158	1,222	190	2,290

Veni re: vlera p në kllapa është përlogaritur nga gabimet standarde në grup-mallra të fuqishme (cluster-robust), me përjashtim të llogaritjeve me modelin dinamik Poisson ku gabimet janë të shpërndara sipas parametrin Gamma. Niveli i rëndësisë është i dhënë si: *** $p < 0.01$; ** $p < 0.05$; * $p < 0.1$.

- 1) BPV i BE-së ndryshon nga viti në vit (pa variacione mes grupeve) prandaj është perfekt kolinear me vlerës shtesë për vitin/periudhën

Tabela 9. Përcaktuesit e tregtisë dypalëshe: efektet afatgjata për eksporte

	Modeli Dinamik Poisson	Modeli dinamik linear
--	------------------------	-----------------------

<i>Ndryshoret e varura</i>	Niveli i eksporteve		Log-u i eksporteve	
	total	sektorial	total	sektorial
<i>Ndryshoret e pavarura</i>				
Log-u për importues BPV (<i>lnim_gdp</i>)	0.136 (0.590)	1.614** (0.037)	0.802** (0.024)	0.299** (0.020)
Log-u për eksportues BPV (<i>lnex_gdp</i>)	6.923 (0.463)	20.093 (0.500)	11.603 (0.410)	-0.685 (0.858)
Log-u për distancën (<i>Indist_km</i>)	-1.831*** (0.001)	-6.616** (0.014)	-3.177*** (0.000)	-1.174*** (0.000)
Valuta e përbashkët (<i>comc</i>)	-0.247 (0.721)	0.492 (0.809)	-0.101 (0.924)	0.188 (0.571)
Komunitetit i diasporës(<i>rem</i>)	2.355*** (0.000)	8.631** (0.028)	1.266 (0.261)	0.520 (0.117)
Gjendja fillestare (tregtia në 2005)	2.977** (0.020)	54.572** (0.016)	-	-
Numri i vëzhgimeve	196	19,012	158	1,222

Shënim: shih shënimin në Tabelën 8.

metalet dhe mallrat tjerë të prodhuar në sektorë ku kërkohet punë intensive dhe fuqi e ultë punëtore, ndërsa ka importuar nga BE-ja prodhime që kërkojnë kapital intensiv dhe aftësi të larta. Mbështetja për këtë qëndrim mund të gjendet dhe në shpjegimin që Paul Wonnacott (pp.59-62) i bën punimit të Eichengreen dhe Irwin-it nga viti 1988. Këtu ai sqaron:

Tregtinë e shtynjë jo vetëm ndryshoret në modelin e gravitetit dhe aksidentet historike, por edhe ideja tradicionale e përparësisë krahasuese. Përderisa përparësia krahasuese mund të ndryshojë, në përgjithësi ajo ndryshon shumë ngadalë. Kështu për shembull, shtetet me klimë të butë dhe tokë e stepa e pjellore kanë shumë gjasa t'u eksportojnë grurë shteteve me popullsi të madhe

por tokë të varfër, dhe ky model i tregtimit do t'i qëndrojë kohës. Në mënyrë të ngjashme mund të shpjegohet importi i madh në Japoni nga Gjiri Persik për shkak të rezervave të mëdha të naftës atje, dhe etja e industrisë japoneze për këtë naftë. Gjithashtu, boksiti transportohet nga shtetet të cilat kanë miniera boksiti tek ato të cilat kanë ofertë të gjerë të rrymës elektrike, kryesisht hidrocentraleve të lira, dhe se furnizimi me të dyja ka gjasa të zgjas për një periudhë të zgjatur kohore.

Përveç kësaj, Wonnacot bën dhe një vëzhgim shumë të rëndësishëm në lidhje me rëndësinë e izolimit të përparësisë krahasuese nga faktorët tjerë të cilët dalin si përcaktues të persistencës së modeleve të tregtisë. Sipas tij, identifikimi i përparësisë krahasuese si burim i modeleve persistente të tregtisë luan një rol të rëndësishëm në integrimin e mëtutjeshëm të partnerëve tregtar. Ai sqaron:

Nëse shtetet janë partnere të afërta tregtare para vendosjes së tregtisë së lirë për shkak të forcave themelore ekonomike – si përparësia krahasuese dhe afërsia gjeografike – atëherë do të argumentoja se arsyet për marrëveshje për tregti të lirë janë më të forta. Shtetet tashmë janë partner tregtar natyral, dhe diskriminimi ndaj të tjerëve që do të shkaktonte një marrëveshje e tillë ka efekte relativisht të dobëta në devijimin e tregtisë.

Ky argument ka rëndësi shumë të madhe për Kosovën, e cila tashmë ka finalizuar negociatat me BE-në për MSA-në.

Ndërsa është shumë e mundur që përparësia krahasuese të jetë vetëm njëra anë e medaljes. Ana tjetër ka të bëjë me koston e hyrjes në tregje të reja, apo ato ekzistueset. Hapja e tregjeve të reja ka kosto të fundosur dhe pas kësaj Eichengreen dhe Irwin (1998) sqarojnë se modelet pasuese tregtare në përgjithësi i qëndrojnë kohës. Zgjerimi apo kalimi në tregjet të reja kushton, për shkak të dallimeve kulturore, gjeografike dhe gjuhësore. Për më tepër, krijimi i rrjetit shpërndarës, trajnimi i njerëzve, mbledhja e të dhënave për tregjet e jashtme, themelimi i rrjeteve, etj., të gjitha kanë kosto të pakthyeshme. Për shumë kompani, përfshi këtu dhe ato kosovaret të cilat kanë resurse të pakta, hyrja në mjedise të reja dhe të panjohura është një strategji me shumë risk. Eksportuesit kosovar mund të ballafaqohen me kosto të larta të fundosura në kushte të paqartësisë së madhe, në të cilat teoria parashikon efekte të histerezisë, që nënkupton se eksportuesit në kësi lloj situatë shumë më parë do të rrinë në tregun ekzistues dhe të refuzojnë hyrjen në tregje të reja (për efektin e histerezisë shih Dixit, 1989). Për më tepër, Dutt dhe tjerët (2014) tregojnë se kostot e tregtisë kanë gjasa të ndikohen dhe nga përvoja e kompanisë. Ata sqarojnë se përvoja e fituar nga ndërveprimi i përsëritur në treg është efektive në krijimin e afërsisë dhe mund të kontribuojë në zbutjen e efektit të koston të lartpërmendur në transaksionet ndërkombëtare. Prandaj, efekti i kostove në

vëllimet e tregtisë ka gjasa të jetë më i ultë me akumulimin e përvojës nga marrëdhënia afatgjate dypalëshe.

4.2.2. Eksportet nga Kosova dhe elasticiteti i ofertës dhe kërkesës

Rezultatet nga modelet dinamike Poisson dhe dinamike lineare për elasticitetin e të ardhurave dhe efektin e tyre në eksportet nga Kosova japin sugjerim të fuqishëm mbi karakterin e eksporteve kosovare dhe si kjo bie në kontrast të dukshëm me karakterin e eksporteve prej ekonomive më të forta të tregu. Përderisa modelet gravitetit në mënyrë tipike zbulojnë efekte të fuqishme të të ardhurave në eksport, llogaritjet në tabelën 8 dhe 9 japin indikacione më të përziera në efektin e të ardhurave mbi eksportin kosovar. Llogaritjet sipas dinamikës Poisson tregojnë se elasticiteti i kërkesës për eksportet totale nga Kosova është mesatarisht zero për koeficientët afat-gjatë dhe afatshkurtër ($p=0.59$ në që të dy tabelat, 8 dhe 9 respektivisht). Efekti pa vlerë statistikore del nga kjo vetëm pasi të kemi kontrolluar efektin e komunitetit të diasporës në tregjet importuese nga Kosova dhe të kemi inkuadruar parametrin e gjendjes fillestare. Bazuar në të dhënat totale për eksportin, dhe duke konsideruar efektet simetrike, eksportet e Kosovës nuk ndikohen me rritjen e të ardhurave gjatë bumit ekonomik apo uljes së tyre gjatë recesionit në vendet e destinacionet. Me fjalë tjera, duket se eksportuesit Kosovar ende nuk duken të jenë të gatshëm të përfitojnë nga ajo që perceptohet në përgjithësi të jetë shtytësi më i fortë i eksporteve, e që është rritja e të ardhurave të konsumatorëve të huaj. Ky implikim mbështetet më tutje me mungesën e rëndësisë së ndryshoreve (jo vetëm individualisht, por edhe në grup $p=0.466$). Ndryshoret cilësore shtesë për vite kapin efektet sistematike të cilat shpërfaqen në vite specifike, nën ndikimin e krizës globale financiare dhe manifestimet e saj të veçanta në BE, por që përndryshe nuk kapen nga modeli. Jo-rëndësia e ndryshoreve shtesë për vite tregon se këto trazira kanë pasur shumë pak ndikim në eksportet nga Kosova.¹⁵

Përveç kësaj, për modelin dinamik Poisson i cili llogarit përcaktuesit e eksporteve totale nga Kosova, nuk bën të refuzohet testi statistikor LR i zeros se efekti fiks i një pale shtetesh ose komponenta e variancës në termin e përbërë të gabimit mund të jetë zero – apo së paku shumë afër zeros në të vërtetë, për qëllim të rëndësisë (Stata 12.1 reference, “help j_chiibar”) ($=100$). Sugjerimi ekonomik i këtij rezultati është se efektet e “potencialit tregtar” të modeluar – së paku pjesërisht – me këto efekte për palë shtetesh (Baldwin dhe Taglioni, 2007) po ashtu nuk luajnë rol të rëndësishëm e shtytjen e eksporteve totale nga Kosova. Kjo e gjetur konfirmohet edhe duke vlerësuar modelin si model Poisson të grumbulluar (që

¹⁵ Rezultatet mund të kërkohen nga autorët.

nënkupton mos marrjen parasysh të efekteve për palë shtetesh) dhe duke gjetur rezultate identike.

Megjithatë, vlerësimet në të dhëna të eksportit sektorial sipas dinamikës Poisson si dhe sipas dinamikës lineare dallojnë thellësisht sepse elasticiteti i të ardhurave të kërkesës për eksporte të Kosovës është mesatarisht tjetër nga zero, edhe pse ende shumë i ultë. Në llogaritjet sektoriale, koeficienti në BPV të log-ut të importuesit është 0.41, që nënkupton se për 1 për qind ndryshim në BPV të importuesit, me gjitha parametrat tjerë të pandryshuar, ndryshimi që rezulton në eksportet sektoriale është vetëm 0.41 për qind (natyrisht, elasticiteti afatgjatë është më i lartë 1.61). Sipas vlerësimeve dinamike lineare, 1 për qind ndryshim në BPV të importuesit do të rezultojë mesatarisht në 0.3 dhe 0.2 për qind rritje të eksporteve totale dhe sektoriale nga Kosova. Megjithatë, ndryshoret cilësore shtesë për vite mbesin të pavlefshme nga aspekti statistikor, me përjashtim nga vlerësimet dinamike lineare për të dhënat e eksportit total. Në rastin e fundit, vetëm ndryshorja cilësore shtesë për vitin 2009 ka vlerë statistikore në nivelin 10 për qind ($p=0.078$), dhe me sa duket kështu kap efektin e rënies së kërkesës për import, e shkaktuar me efektet e krizës financiare në raport me vitet para krizës.

Në të dhënat për eksportin ndoshta rezultati më befasues është koeficienti pa rëndësi statistikore në elasticitetin e të ardhurave të kërkesës (që nënkupton BPV e Kosovës si eksportuese). Rezultati është i njëjtë përgjatë specifikimeve ekonometrike, përfshirë këtu edhe modelet për efektet fikse (*vlera p* për llogaritjet dinamike është prej 0.320 deri në 0.858). Ky rezultat i fuqishëm sugjeron se zhvillimi ekonomik në Kosovë nuk është duke e rritë kapacitetin ofertues që do të krijonte eksporte. Me fjalë tjera, provat tregojnë se zhvillimi ekonomik në Kosovë nuk është i asaj natyre që do të zhvillonte kompanitë dhe industritë eksportuese. Kjo duket të sugjerojë që çelësi i përforsimit të eksporteve të Kosovës qëndron tek reformimi i anës ofertuese të ekonomisë. Ndoshta, shtytësit e rritjes në vitet e fundit (si projektet madhore të infrastrukturës) nuk kanë bërë shumë për të ndërtuar kapacitetet eksportuese të Kosovës. Kjo alarmon për një qasje më të përqendruar në rritjen e kapaciteteve eksportuese të Kosovës. Masat do të duhet të bazohen në një qasje të integruar që do të rrisë kapacitetet eksportuese të sektorit privat në Kosovë, përfshirë këtu politikat/masat të cilat do të forconin kapacitetet e brendshme të kompanive (pikësëpari rritjen e prodhimit) të përcjellë me politikat/masat të cilat adresojnë mjedisin e përgjithshëm për biznes.

4.2.3 Importet e Kosovës dhe Elasticiteti i të ardhurave të kërkesës dhe ofertës

Sa i përket anës së importit, rezultat janë ashtu siç janë pritur, dhe në përputhshmëri me parashikimet e modelit të gravitetit. Llogaritjet dinamike Poisson për Kosovën sugjerojnë efekte të mëdha të të ardhurave në importe (Tabela 10, shtylla 2 dhe 3) dhe se efekti i të

ardhurave në shtetin e destinacionet ka rëndësi statistikore vetëm kur vlerësohet sipas të dhënave sektoriale dhe atëherë vetëm në nivelin 10 për qind. Përveç kësaj, edhe llogaritjet dinamike lineare nga të dhënat e importit total dhe sektorial janë të mëdha dhe me rëndësi statistikore (tabela 10, shtylla 4 dhe 5), njëjtë çfarë është llogaritja statike e efektit fiks nga të dhënat sektoriale (tabela 10, shtylla 7). Elasticiteti i importit të kërkesës, i vlerësuar sipas modelit dinamik Poisson për të dhënat sektoriale është 3.85 (tabela 10, shtylla 3). Natyrisht, elasticiteti afat-gjatë është edhe më i lartë dhe ka vlerën 5.93 (tabela 11, shtylla 3). Me fjalë tjera, një rritje mesatare e BPV të Kosovës për 1 për qind, rrit importin për gati 4 për qind në afat të shkurtër, dhe gati në 6 për qind në afat të gjatë. Këto vlerësime të elasticitetit të të ardhurave tregojnë për një etje të pamasë për importe, ku rritja e kërkesës tejkalon dukshëm rritjen e të ardhurave.

Tabela 10. Përcaktuesit e tregtisë dy-palëshe: të dhëna për importin

	Modeli Poisson	dinamik	Modeli linear	dinamik	Modeli FE (OLS të grumbulluara)	
	Niveli i importeve		Log-u i importeve		Log-u i importeve	
	Totale	sektoriale	Totale	sektoriale	Totale	sektoriale
<i>Ndryshoret e varura</i>						
<i>Ndryshoret e pavarura</i>						
Log-u i BPV të importuesit GDP (<i>lnim_gdp</i>)	3.251 (0.165)	3.848* (0.097)	2.681** (0.048)	1.278* (0.087)	-.1) (0.581)	4.411*** (0.006)
Log-u i BPV-së së eksportuesit (<i>lnex_gdp</i>)	0.520*** (0.000)	0.488*** (0.000)	0.647*** (0.000)	0.189** (0.024)	-0.377 (0.581)	-0.017** (0.039)
Log-u i distancës (<i>ln dist_km</i>)	- 1.581*** (0.000)	- 1.317*** (0.000)	- 1.563*** (0.000)	-0.631** (0.037)	1.843 (0.282)	- 6.122*** (0.000)
Valuta e përbashkët (<i>comc</i>)	-0.441* (0.069)	- 0.416*** (0.008)	-0.125 (0.542)	-0.055 (0.451)	-0.097 (0.647)	- 0.371*** (0.001)
Gjendja fillestare (tregtia më 2005)	0.212*** (0.001)	6.602*** (0.000)	-	-	-	-
Tregtia në të kaluarën	0.025 (0.116)	0.351*** (0.000)	0.416** (0.013)	0.621*** (0.000)	-	-
Konstanta	-12.559 (0.357)	-22.013 (0.098)	-54.854 (0.065)	-24.337 (0.126)	15.911 (0.026)	-43.502 (0.209)
Ndryshoret cilësore shtesë	Po	Po	Po	Po	Po	Po

për vitet						
Ndryshoret cilësore shtesë për palë shtetesh	Po	Jo	Po	Jo	Jo	Jo
Palë shtetesh sipas ndryshoreve shtesë për sektorë	Jo	Po	Jo	Po	Po	Po
Ndryshore cilësore shtesë për sektorë	Jo	Jo	Jo	Jo	Jo	Po
Ndryshore cilësore shtesë të shtetit eksportues	Jo	Jo	Jo	Jo	Po	Jo
Ndryshore cilësore shtesë për sektorë të shtetit eksportues	Jo	Jo	Jo	Jo	Jo	Po
Numri i vrojtimeve	196	19,007	189	8,297	216	10,806

Shënim: në kllapa p-vlera është kalkuluar nga gabimi standard për grupime të fuqishme (të grupuara për palë shtetesh), me përjashtim të vlerësimeve sipas dinamikës Poisson ku gabimet kanë shpërndarje Gamma. Shkalla e rëndësisë është paraqitur me sa vijon: *** $p < 0.01$; ** $p < 0.05$; * $p < 0.1$.

Table 11. Përcaktuesit e tregtisë dy-palëshe: efektet afatgjate të importeve

<i>Ndryshoret e varura</i>	Modeli dinamik Poisson		Modeli dinamik linear	
	Niveli i importeve		Log-u i importeve	
<i>Ndryshoret e pavarura</i>	Totale	sektoriale	Totale	sektoriale
Log-u i BPV të importuesit (<i>lnim_gdp</i>)	3.333 (0.165)	5.926* (0.106)	4.591* (0.077)	3.361 (0.111)
Log-u i BPV të eksportuesit (<i>lnex_gdp</i>)	0.534*** (0.000)	0.751*** (0.000)	1.107*** (0.000)	0.496*** (0.000)
Log-u i distancës (<i>lndist_km</i>)	-1.622*** (0.000)	-2.028*** (0.000)	-2.676*** (0.000)	-1.656*** (0.000)
Valuta e përbashkët (<i>comc</i>)	-0.451* (0.067)	-0.640** (0.011)	-0.214 (0.548)	-0.144 (0.440)
Gjendja fillestare (tregtia më 2005: T0)	0.217*** (0.001)	10.169*** (0.000)	-	-
Numri i vrojtimeve	196	19,007	189	8,297

BPV i eksportuesit, përkatësisht BPV i BE-së, prodhon vlerësime të elasticitetit me rëndësi statistikore por habitshëm me vlerë shumë të ultë. Elasticiteti i të ardhurave të ofertës prej shteteve evropiane karshi Kosovës në vlerësimet dinamike Poisson është 0.52 për importet totale dhe 0.49 për ato sektoriale. Sipas modelit dinamik linear, rritja prej 1 për qind e BPV të BE-së do të duhej të prodhonte rritje të eksporteve në Kosovë për 0.65 për qind në importet totale dhe 0.12 për qind në ato sektoriale. Ndërsa, modeli statik për efektet fikse sugjeron bile edhe elasticitet të ultë negativ. Prandaj ashtu siç mund të pritej, variacionet në të ardhurat kombëtare të shteteve të BE-së nuk kanë shumë ndikim në eksportet e tyre në Kosovë.

Efektet e llogaritura në të ardhura sugjerojnë se platforma e zhvillimit ekonomik në Kosovë deri më tani ka shkaktuar një dinamizëm të konsiderueshëm në importim, por ende jo në eksportim. Kjo nuk është e papritur pasi që dihet në çfarë stadi të zhvillimit gjendet Kosova tani. Kosova është thellësisht e varur nga importet. Edhe pse ekzistojnë brenga mbi bilancin tregtar që vazhdon të jetë negativ dhe i lartë, dhe se si do të ndikojë në perspektivën e Kosovës për rritje afatgjate dhe të qëndrueshme, duhet pasur parasysh se importimi, se paku për afat të shkurtër dhe të mesëm, është i rëndësishëm për rritjen ekonomike të Kosovës, si për rritje të konsumit ashtu edhe për transferim të teknologjisë dhe njohurive. Sa i përket të parit, një rritje në të ardhurat reale të Kosovës do të mund të nxiste një rritje të mallrave konsumuese. Në anën tjetër, importet janë me siguri i vetmi kanal përmes të cilit Kosova siguron qasje në teknologji dhe njohuri të huaja. Adoptimi i teknologjive do të nxisë produktivitetin e punës gjatë kohës dhe kështu të stimulojë rritjen ekonomike në Kosovë. Në këtë kontekst, importet kanë qenë të dobishme për rritjen e konkurrueshmërisë së Kosovës. Një hulumtim i fundit i nivelit mikro mbi sjelljen e kompanive eksportuese në vendet në tranzicioni (i cili përfshin dhe Kosovën) identifikon lidhje pozitive mes intensitetit të importit dhe tendencës dhe intensitetit të eksportit (shih Gashi dhe tjerët, 2014).

4.2.4 Distanca dhe kostoja e tregtisë

E vlerësuar sipas modelit të gravitetit të tregtisë, distanca ka efekt të fuqishëm negativ. Në këtë kuptim së paku, tregtia e Kosovës i nënshtrohet ndikimeve të njëjta negative të kostos së transaksionit dhe/ose dallimeve ‘psikike’ (kulturore, historike, etj.) të cilat në mënyrë tipike pengojnë të gjitha llojet e tregtisë mes shteteve. Në llogaritjet dinamike për eksporte dhe importe, koeficientët kanë gati në formë uniforme peshë në nivelin 1 për qind dhe kanë shtrirje tipike mes 0.75 dhe 1.70. Për ta ilustruar këtë, vlerësimet dinamike Poisson për të dhënat e eksportit total tregojnë se 1 për qind rritje në distancën

mes kryeqyteteve, ceteris paribus, ul vlerën e eksporteve për 1.4 për qind; për eksportet sektoriale elasticiteti është 1.67 (Tabela 8, shtylla 2 dhe 3). Në rastin e importeve totale, elasticitetit konstant korresponduese për importin sa i përket distancës është 1.58 për të dhënat totale dhe 1.32 për ato sektoriale (Tabela 10, shtylla 2 dhe 3).

Madhësia e koeficientit të distancës bie afërsisht brenda një serie që është gjetur nga studime të tjera, së paku brenda kufirit të ultë të serisë. De Benedict dhe Taglioni (2011 f. 75) raportojnë se vlerësimet e elasticitetit të vazhdueshëm të tregtisë ndaj distancës shtrihen prej -0.75 deri në -1.2. Çfarë pra mund të shpjegojë nivelet kaq të larta të kostos së tregtisë mes Kosovës dhe BE-së? Së pari duhet pasur parasysh se jemi duke vlerësuar kostot tregtare mes dy vendeve që janë “fqinj mjaft të largët” (pasi që Kosova dhe BE-ja nuk kanë kufi të përbashkët) dhe si të tillë efektet e distancës janë detyrueshëm më të fuqishëm. Së dyti, në rastin tonë faktori i distancës mund të kapë edhe efekte tjera të cilat zakonisht kontrollohen përmes ndryshoreve tjera në modelin e gravitetit – siç janë kufiri i përbashkët, gjuha e përbashkët, etj. – të cilat kanë rëndësi në studimin aktual por në të vërtetë mund të reflektojnë një dimension specifik të kostos. Në këtë kontekst, edhe një pjesë e efektit që ka ndryshorja e valutës së përbashkët do të mund të kapej nga ndryshorja e distancës, duke prishur potencialisht rezultatet e të parës (shih më poshtë për diskutim të efekteve negative të koeficientit të valutës së përbashkët).

Sidoqoftë, këto efekte jashtëzakonisht negative me shumë gjasa tregojnë se kostot aktuale të transaksioneve për eksport e import mes Kosovës dhe shteteve anëtare të BE-së janë shumë të larta. Ekzistojnë shkaktar të ndryshëm të këtij niveli të kostove: disa burojnë nga politikat e disa të tjerë nga burojnë nga gjeografia dhe institucionet. *Së pari*, në kontekst të barrierave politike, edhe pse BE-ja i ka hequr gati të gjitha normat tarifore për eksportet nga Kosova, ajo ende ka në fuqi barriera jo-tarifore në formë të kërkesave teknike (kualiteti i produktit, përshtatja, përputhja, etj.). Në anën tjetër, Kosova ende ka në fuqi normën tarifore prej 10 për qind në një numër të konsiderueshëm të produkteve që importohen nga BE-ja. Të dy palët tregtare ende kanë në fuqi procedura të lodhshme të licencimit, lejeve, dhe certifikimit për bizneset përkatëse, dhe kërkesa tjera të ngjashme. *Së dyti*, edhe pse ne argumentojmë se janë bërë një sërë përmirësimesh të rëndësishme në infrastrukturën e transportit në Kosovë, është e dukshme nevoja për të avancuar infrastrukturën rrugore dhe hekurudhore dhe për t’u lidhur me korridoret kryesore të transportit në rajon. Në këtë kontekst, fakti që Kosova nuk ka qasje në det vetëm sa e rrit nivelin e kostot në të dy anët. *Së treti*, vonesat në inspektim të mallrave janë shumë të zakonshme, e veçanërisht për mallrat e Kosovës të destinuara për tregun evropian. Vonesat dalin edhe nga mungesa e efikasitetit të agjencive doganore në Kosovë. Aq më tepër, kur të llogaritet edhe historia e shteteve të Ballkanit Perëndimor, bizneset të cilat kalojnë nëpër këto shtete do të duhet të ballafaqohen dhe me praktika

korruptive ose mitmarrje, rregulla rënduese, dhe mungesa tjera të efikasitetit (veçanërisht mallrat të cilat kalojnë kah Serbia). Gjatë rrugës, e bile edhe më e rëndësishme, koston totale logjistike e rrit edhe shkalla e ultë e shërbimeve serioze dhe të parashikueshme (që nënkupton, shërbime të pabesueshme). Së fundmi, vlera e ultë për peshë e mallrave ndikon në koston e eksportimit për prodhuesit/eksportuesit Kosovar.

4.2.5 Valuta e Përbashkët

Efektet e valutës së përbashkët në formë uniforme nuk kanë rëndësi statistikore për të gjitha modelet e bazuara në të dhëna të eksportit. Megjithatë, për import, llogaritjet dinamike Poisson tregojnë se valuta e përbashkët ka lidhje negative me fluksin e importeve në Kosovë. Arsye për këtë është se mes 4 shteteve me të cilat Kosova nuk ka pasur valutë të përbashkët për periudhën e hulumtuar është Kroacia, dhe ndër 7 të cilat kanë adoptuar Euron deri diku është Sllovenia. Tregtia me këto vende ka qenë dikur tregti e brendshme, brenda ish-Jugosllavisë. Duke reflektuar në këtë histori, tregtia me kësi lloj shtetesh – e në veçanti importi - është me i lartë se që mund të pritej, prandaj kjo kthen prapa efektet e përgjithshme negative të tregtimit në valutë tjetër, siç është identifikuar në studime tjera. Në kemi testuar hipotezën duke vlerësuar modelet tona të importit pas filtrimit nga vërtetimet për Kroacinë dhe Slloveninë. Në të gjitha rastet, efekti i valutës së përbashkët ka rezultuar nga negativ dhe me rëndësi statistikore në pozitiv dhe pa rëndësi statistikore: për fluksin total tregtar nga -0.44 ($p=0.07$) në 0.04 ($p=0.90$); dhe për fluksin e tregtisë për sektor nga -0.42 ($p=0.01$) në 0.13 ($p=0.57$). Sa për krahasim, asnjëri nga efektet e vlerësuara për ndryshoret tjera me interes nuk janë ndryshuar. Një ushtrim i ngjashëm në eksporte zbulon ndryshime në koeficientët e vlerësuar në formë hipotetike por me mungesë të vazhdueshme të rëndësisë. Së bashku, efektet e valutës së përbashkët në formë rezultojnë të mos kenë rëndësi statistikore, që është në përputhje me provat e fundme të meta-regresionit (Havranek, 2010).

4.2.6 Komuniteti i diasporës

Në fund, ndikimi i madh, pozitiv, dhe me shumë rëndësi i komunitetit të diasporës në eksportet totale dhe sektoriale ($p=0.000$ në të dy rastet) sugjeron rëndësinë e lidhjeve personale dhe në komunitet të krijuara në të kaluarën.¹⁶ Vlera e këtij koeficienti është e lartë, dhe kjo tregon për rëndësinë e komunitetit të diasporës në eksportim drejt vendeve të BE-së ku diaspora është relativisht e madhe në krahasim me vendet e BE-së ku diaspora është relativisht me vogël në numër. Për nivelin 1 për qind të rëndësisë, një

¹⁶ Kjo ndryshore nuk luan kurrfarë roli në modelet e importit, si për mungesë të justifikimit teorik dhe kur inkudrohet në formë uniforme tregohet pa rëndësi statistikore në nivele konvencionale

ndryshim diskret nga 0 në 1 të ndryshoreve shtesë që krahasojnë shtetet me pak apo pa komunitet të diasporës (ndryshorja cilësore shtesë=0) dhe vendet me komunitet të madh të diasporës (ndryshorja cilësore shtesë=1) rezulton një rritje e faktorëve të tregtisë përmbi 5 ose gati 8 në varësi prej asaj nëse vlerësimi është bërë me të dhëna të eksportit total apo për sektorë (Tabela 8, shtylla 2 dhe 3).¹⁷

Këto efekte të diasporës janë mjaft të mëdha. Megjithatë dy faktorë sugjerojnë se këto vënë në pah karakteristika të rëndësishme të tregtisë kosovare. Së pari, provat në këtë studim me të madhe sugjerojnë se eksportet nga Kosova nuk po u përgjigjen përcaktuesve tradicional të tregtisë në mënyrë të ngjashme me ekonomitë e zhvilluara të tregut. Anasjelltas, efekti i diasporës sugjeron se eksportet nga Kosova po u përgjigjen fuqishëm faktorëve të tjerë, më pak të zakonshëm. Së dyti, qasja jone e preferuar për llogaritje – modeli dinamik Poisson – na mundëson një rritje të madhe të madhësisë së mostrës krahasuar me qasjet konvencionale për llogaritje të modelit të gravitetit të tregtisë. Nga ana e tij, zerot e nxjerra nga llogaritja Poisson janë që të gjitha apo kryesisht nga shtetet për të cilat ndryshorja cilësore shtesë për diasporën ka vlerë ‘zero’: në të dhënat e Kosovës për eksportin total, 15,150 të flukseve zero janë drejt vendeve të cilat nuk kanë diasporë të konsiderueshme, përderisa 4,288 janë tek vendet të cilat kanë diasporë të konsiderueshme. Nxjerrja e zero flukseve tregtare mundëson që efekti madhor i diasporës të dalë në fokus të mprehtë.

Dy kushte qëndrojnë. Kushti i parë, më i vogël, është se derisa llogaritjet dinamike lineare suplementare dhe llogaritjet statike të efekteve fikse janë të gjitha pozitive, vetëm njëra nga këto llogaritje ka rëndësi statistikore. Kushti i dytë, dhe më i rëndësishëm është se ndryshorja cilësore shtesë e cila modelon efektin e diasporës nuk ndryshon me kohë, që e vë efektin e llogaritur të diasporës me modelin dinamik Poisson nën ndikim të kufizimeve të diskutuara në kontekst të efekteve të valutës së përbashkët. Megjithatë, ky kusht zbutet nga faktet e prezantuara më lartë se efekti i ‘potencialit për tregti’ i modeluar sipas këtyre efekteve për palë shtetesh nuk luan ndonjë rol të fuqishëm në shtytjen e eksporteve totale nga Kosova (shih seksionin 4.2.2. më lartë) në të cilin rast bëhet më e mundshme që në rast të eksporteve totale kemi arritur të identifikojmë efektin e diasporës (deri në atë masë që mund të injorojmë korrelacionin e pjesshëm me efektet e rastësishme pa rëndësi statistikore – d.m.th. efekt zero). Për më tepër efekti i diasporës i llogaritur nga të dhënat për eksportin total (1.81) është i ngjashëm me efektin e diasporës të llogaritur nga të dhënat për eksportin sipas sektorëve (2.18), i cili lë të

¹⁷ Siç është cekur më herët, ndryshorja shtesë në regresionet Poisson me ndryshore të varur të specifikuar në nivele duhet të interpretohen në mënyrë të njëjtë si në regresionet OLS me ndryshore të varur të specifikuar në logaritme; në të dy rastet, nëse ndryshorja shtesë e vlerësuar është e paraqitur si DV, formula për përqindje të efektit në ndryshoren e varur është $[\exp(DV)-1]*100$

kuptohet se ky i fundit nuk ka ndonjë ndikim madhor. Së fundi, këto efekte të dukshme dhe shumë të rëndësishme të diasporës janë në përputhje me supozime të fuqishme teorike.

Efekti i diasporës dhe remitancat rrjedhëse në Kosovë janë hulumtuar gjerësisht nga perspektiva e ndikimit në ulje të varfërisë, konsumit, dhe investimeve (shih Riinvest, 2007). Megjithatë, raporti mes komunitetit të diasporës dhe aktiviteteve eksportuese nuk janë analizuar në gjerësi të njëjtë me analiza ekonometrike të të dhënave për tregtinë. Për shkak të kostos shumë të lartë të tregtisë mes Kosovës dhe BE-së (shih diskutimin për distancën dhe koston e tregtisë) është e kuptueshme që bizneset kosovare do të synojnë të përfitojnë nga bashkatdhetarët biznesmen në Diasporë për të siguruar informatat e nevojshme për tregun, ligjet dhe rregullat në fuqi, zbatimin e kontratave, si dhe për të siguruar qasje në rrjetet e tyre shpërndarëse (me pakicë dhe shumicë). Për më tepër, komuniteti i diasporës është në pozitë të mbulojë zbrazëtirën kulturore dhe gjuhësore, që ka çon shumë peshë në transaksionet tregtare ndërkombëtare.

Përmbyllje

Kosova është në proces të avancimit të mëtutjeshëm të marrëdhënies së saj tregtare me BE-në. Ajo ka negociuar MSA-në, përfshi krijimin e zonës për tregti të lirë, e cila do të trashëgojë Masat Tregtare Autonome me pak të favorshme, një marrëveshje tregtare mes Kosovës dhe BE-së e cila ka zgjatur tashmë një dekadë e gjysmë. Ky studim vërteton efektet gjithëpërfshirëse të liberalizimit të tregut me BE-në. Megjithatë shkon përtej marrëveshjes aktuale tregtare. Në kemi hulumtuar përcaktuesit e marrëdhënieve tregtare mes Kosovës dhe BE-së, nën hipotezën se pengesat e një fluksi më të madh të mallrave në të dy anët nuk kanë të bëjnë vetëm me lëvizjen e lirë të mallrave, pasi që ky fluks tashmë ka qenë mjaft i liberalizuar.

Bazuar në panelin 8-vjeçar të të dhënave për tregtinë, ky studim hulumtoi ndikimin që faktorë të ndryshëm kanë në tregtinë mes Kosovës dhe BE-së. Studimi u përqendrua në ndikimin e “forcave binjake”, që nënkupton, masën ekonomike dhe kostot e tregtisë në fluksin e mallrave mes Kosovës dhe BE-së. Studimi aplikoi qasjen e quajtur Modeli i Gravititetit i cili për mbi pesëdhjetë vite ka qenë “kalë pune” që analizon faktorët dhe politikat që përcaktojnë fluksin tregtar mes dy vendeve. Ne demonstrojmë se asnjë specifikim aktual i modelit të gravitetit nuk ka mundësi të inkuadrojë të gjitha karakteristikat të cilat i propozon teoria e kohës së fundit dhe të jetë i llogaritur përmes metodave aktuale ekonometrike. Për detyrën tonë specifike, e që është ngritja e njohurive për tregtinë e Kosovës me BE-në dhe implikimet politike korresponduese, kompromisi ynë i veçantë është të llogarisim modelin dinamik i cili kontrollon efektet për

palë shtetesh. Në argumentojmë që kjo qasje merr parasysh dinamikën, të cilat zakonisht mbeten jashtë modelit të gravitetit, dhe në këtë mënyrë merr parasysh historinë e raporteve tregtare mes Kosovës dhe shteteve të BE-së, derisa pjesërisht adreson aspektet rezistuese ndaj tregtisë të cilat theksohen nga teoria e fundit. Ne kemi gjykuar qasjet alternative si të pakënaqshme: në veçanti, për të specifikuar modelin tonë të gravitetit që të inkuadrojë numër të madh të ndryshoreve shtesë të ndryshueshme në kohë të propozuar nga teoria nënkupton se modelet dinamike nuk mund të llogariten; përderisa llogaritjet me modelet e zakonshme statike jo vetëm që nënkuptojnë specifikim të gabuar dinamik (për nga konstrukti) por po ashtu edhe lënie jashtë fluksit të tregtar zero dhe rezultateve të gabuara rrjedhëse. Sipas kësaj, ne aplikojmë një sërë teknikash ekonometrike për të vlerësuar modelin e gravitetit, e sidomos modelin panel dinamik Poisson, që mbetet qasja jonë e preferuar.

Në përgjithësi, rezultatet konfirmojnë pritjet tona, si për eksporte ashtu edhe për importe. Për t'i përmbledhur, rezultatet për eksportin tregojnë me sa vijon:

Në përgjithësi rezultatet konfirmojnë atë që kemi supozuar, si për eksport ashtu edhe për import. Për të përmbledhur, rezultatet e eksporteve veçojnë në vijim:

- Historia çon peshë! Modelet tregojnë koeficientë pozitiv dhe me koeficient me të rëndësi lartë statistikore mbi kushtet fillestare tregtare dhe/ose tregtinë në të kaluarën. Niveli e të dy koeficienteve është i lartë, pa marrë parasysh a vlerësojmë sipas modeleve dinamike lineare apo regresionit dinamik Poisson. Domethënia ekonomike e këtyre vlerësimeve është se modeli aktual i eksporteve të Kosovës nuk është i ndikuar nga e kaluara e afërt, por për më tepër, nga modelet e krijuara në vitin 2005. Kjo nënkupton mungesë të fleksibilitetit të ofertës; që nënkupton me shumë gjasa, kapacitete të mangëta të kompanive Kosovare për të hyrë në tregje të reja.
- Modeli gjeneron indikatorë të ndryshëm mbi efektin e të hyrave të eksportit nga Kosova
 - Modeli dinamik Poisson tregon se elasticiteti i të hyrave nga oferta për eksportin total të Kosovës të jetë mesatarisht zero. Edhe pse dinamika Poisson vlerëson se të dhënat sektoriale të eksportit, dhe vlerësimet dinamike lineare japin elasticitetin e të hyrave nga kërkesa për eksportet e Kosovës të jenë, mesatarisht, të ndryshme nga zero, këto efekte të vlerësuar janë ende mjaft të ulët. Elasticiteti i ulët ose zero elasticiteti i vlerësuar i të hyrave nga kërkesa sugjerojnë se Kosova eksporton lloje të mallrave për të cilat kërkesa përgjigjet pak ose aspak për të hyrat në rritje.

Çfarë habit më tutje është se elasticiteti i parëndësishëm i furnizimit për nga aspekti statistikor sugjeron se rritja e të hyrave kombëtare të Kosovës nuk është duke gjeneruar kapacitete përkatëse eksportuese.

- “Distanca është gjallë e mirë” është një influencues i eksportit të Kosovës në vendet evropiane. Koeficientët e vlerësuar janë pothuajse njëtrajtësisht të rëndësishëm në nivelin 1 për qind dhe kanë shtrirje të madhe.
- Efektet e diasporës në eksportin e Kosovës janë mjaft të mëdha. Vlera e koeficientëve të llogaritur tregon rëndësinë e komunitetit të Diasporës për eksportin drejt vendeve të BE-së ku diaspora kosovare është relativisht e madhe në krahasim me vendet e BE-së ku diaspora është e vogël në numër.
- Sa i përket importit, me poshtë renditen tendencat kryesore:
- Edhe një herë, historia çon peshë! Modelet gjenerojnë koeficientë pozitiv dhe me vlerë e rëndësi të lartë statistikore mbi kushtet fillestare tregtare dhe/ose tregtinë në të kaluarën. Këto rezultate dalin konsistente nëpër të gjitha modelet dhe shembujt. Megjithatë, në kundërshtim me efektet më të mëdha e dominuese të eksporteve, modeli aktual i importeve të Kosovës zbulon varësi dukshëm më të ultë në modelet e së kaluarës, dhe rrjedhimisht, fleksibilitet më të lartë në anën e kërkesës; p.sh. aftësinë e eksportuesve nga BE për të hyrë në tregun e Kosovës.
- Sa i përket efekteve në të hyra, për nga cilësia rezultatet përputhen me parashikimet e modelit të gravitetit, megjithatë, dallojnë për nga sasia me shumicën e modeleve të vlerësuara të gravitetit. Efekti i të hyrave në kërkesën kosovare për importe vlerësohet të jetë jashtëzakonisht i lartë dhe shumë domethënës për nga vlera statistikore. Këto vlerësime vejnë në pah se Kosova ka uri të theksuar për importe; në vlerësimet tona të preferuara sipas dinamikës Poisson, rritja e importeve tejkalon rritjen e të hyrave nga importet për 3 deri 4 pika. Në anën tjetër, eksportet drejt Kosovës nuk u gjenerojnë të hyra e veçanta eksportuesve evropian (elasticitetet e vlerësuara janë të vlefshme nga aspekti statistikor, megjithatë të ulta).
- Edhe për importe, distanca çon peshë! Koeficientet e vlerësuar janë pothuajse njëtrajtësisht të vlefshëm në vlerë 1 për qind dhe kanë shtrirje të madhe, edhe pse, më të ulët se në rastin e eksporteve.

Përmbledhja e rezultateve nga importi dhe eksporti sugjeron se tregtia e Kosovës nuk po i përgjigjet plotësisht përcaktuesve tradicional të tregtisë sikur një ekonomi e vendosur e

tregut. Kjo nënkupton se karakteri i tregtisë së Kosovës me BE-në dallon dukshëm me karakterin e tregtisë ndërkombëtare mes ekonomive të vendosura të tregut. Dëshmi për këtë është kundërshtimi mes persistencës historike mjaft të lartë të modeleve të eksportit dhe persistencës relativisht të ultë të modeleve të importit, gjë që nënkupton një ekonomi shumë më dinamike në anën e kërkesës se sa në anën e ofertës. Dëshmi e radhës për këtë interpretim është raporti kundërshtues statistikor mes importeve dhe eksporteve në njërën anë dhe të të hyrave të ndryshuara në anën tjetër. Anasjelltas, eksportuesit kosovar ende nuk duken të përfitojnë prej asaj që në përgjithësi perceptohet si shtytësi më i fuqishëm i eksporteve, e që është rritja e të ardhurave të konsumatorëve të huaj. Në veçanti, kur është fjala për eksportim, investigimi ekonometrik tregon se qasja ndaj zhvillimit ekonomik në Kosovë nuk është e natyrës stimuluese për firmat dhe industrinë eksportuese. Për më tepër, efektet e distancës, kanë rezultuar me vlera jashtëzakonisht të larta negative, duke zbuluar kështu se kostot e transaksioneve në eksport dhe import, mes Kosovës dhe shteteve anëtare të BE-së, janë jashtëzakonisht të larta. Ashtu siç është sqaruar, kostot tregtare mes Kosovës dhe BE-së janë të ndërlidhura me politikat, kushtet fizike, dhe ato institucionale. Në fund, efekti i diasporës tregon se eksportet e Kosovës po reagojnë fuqishëm në faktorë të tjerë, më pak të zakonshëm. Ky rezultat i fundit vë theksin në rëndësinë që kanë lidhjet personale dhe shoqërore, të cilat ndihmojnë në uljen e kostove të transaksionit mes Kosovës dhe shteteve të BE-së.

Rezultat që dalin nga ky studim dhe rekomandimet pasuese ushqejnë diskutimin aktual mbi qasjen aktuale ndaj rritjes ekonomike në njërën anë, dhe të liberalizimit të tregut dhe ndikimit të tij në tregun e Kosovës në anën tjetër, e veçanërisht në rritjen e konkurrueshmërisë së sektorit privat. Aq më tepër, ky studim do t'i kontribuojë diskutimit mbi marrëveshjet e mundshme për tregti të lirë dhe anëtarësimin të Kosovës në Organizatën Botërore të Tregtisë. Për nga ana e hulumtimit, modeli i gravitetit do të përdoret si vegël nga politik-bërësit në të ardhmen për të vlerësuar në formë retrospektive (ex-post) ndikimin e politikave të ndryshme në fluksin tregtar.

Rekomandimet politike

Nga perspektiva e politikave, rekomandimi kryesor i studimit tonë është që vendim-marrësit duhet të kërkojnë zgjidhjet në oborrin e vetë Kosovës nëse duan të nxisin aktivitete eksportuese. Ata duhet të tentojnë të ndërmarrin hapat e nevojshëm politik dhe institucional për të rritur kapacitetin ofertues të vendit dhe konkurrueshmërinë e ekonomisë në përgjithësi. Kjo do të kërkojë masat të cilat fillimisht do të eliminojnë pengesat ndaj investimeve në sektorin privat, motorin kryesor të rritjes në ekonominë e

tregut. Korniza “diagnostikimi i rritjes”, e zhvilluar nga Hausmann dhe të tjerët (2008) mund të futet në përdorim që të fiksojë faktorët të cilët pengojnë zhvillimin e eksporteve nga sektori privat në Kosovë, dhe si rrjedhojë, të rritjes dhe mirëqenies ekonomike. Korniza “diagnostikimi i rritjes” është ‘një strategji për identifikimin e prioriteteve politike,’ siç dëshmojnë arkitektët e saj (f.325). Sipas kësaj qasjeje, në një ekonomi të pazhvilluar mjaftueshëm, e cila kërkon reforma të thella, janë gati se gjithmonë prezentë me të madhe pa-përsosmëritë dhe shtrembërimet qeveritare, të cilat krijojnë një ambient me risk të lartë për biznes shkatërrues për investimet biznesore dhe aktivitetet afariste.

Një përbërës i rëndësishëm i kornizës “diagnostikimi i rritjes” është identifikimi i “kufizimet më të detyrueshme,” pasi që, siç argumentojnë autorët, në bollëkun e kufizimeve me të cilat ballafaqohen vendet në zhvillim, përfshi këtu edhe Kosovën, është e rëndësishme më të lartë të identifikohen këto kufizime ndaj aktivitetit ekonomik dhe të dizajnohen grupe politikash të cilat “kur të targetojnë këto shtrëngesa në çfarëdo kohe, kanë potencial të sigurojnë fitimit më të madh për euron e investuar në reformë” (f. 325). Ngjashëm argumenton një publikim i kohës së fundit nga Qendra Ndërkombëtare për Tregti (QNT) (2011, f 5-6) për konkurrueshmërinë ndërkombëtare të vendit:

Lista e shtrëngesave që parandalojnë një shtet të zgjerojë tregtinë është shumë e gjatë. Shumica e vendeve në zhvillimin nuk mund të ndërmarrin politika të shumta reformimi njëkohësisht. Kjo është pikësëpari rezultat i dështimit në krijimin e bazës elektorale për reformë. Pasi politik-bërja kërkon mbështetjen e një spektri të gjerë të hisedarëve me qëndrime konkurruese, ata duhet të binden për arsyet e reformës. Së dyti, shumë vende janë të shtrënguara nga mungesa e burimeve financiare për të zbatuar reformat shumë shpesh të shtrenjta. Si rrjedhojë është kritike të nxitet motivimi i hisedarëve rreth shtrëngesave kryesore të cilat në rast adresimi do të kenë efektin më të madh në zgjerimin e tregtisë dhe në rritje ekonomike. Pasi që situatat në vende dallojnë aq shumë, nuk ekziston një kornizë e vetme e politikave tregtare të cilat do të mund të avokoheshin në gjithë botën.

Çfarë pengon investimet e sektorit privat dhe afarizmin në Kosovë, e në të njëjtën kohë edhe konkurrueshmërinë e ekonomisë kosovare? Përgjigja duket të dalë nga performanca e dobët e institucioneve kosovare. Raporti i Progresit i BE-së (2013) tregon se shtrëngesat që dalin nga mjedisi institucional joadekuat në Kosovë marrin formën e shtrembërimeve të tregut, qeverisjes së dobët dhe shkallës së lartë të korrupsionit, burokracisë së tepërt (lejet, licencat, dhe certifikata), paqartësi e madhe e të drejtave pronësore, zbatim i dobët i

mekanizmave ligjor, mungesa e stabilitetit financiar dhe fiskal, shërbime të dobëta infrastrukturore (ndërprerjet e rrymës janë ende të shpeshta), infrastruktura joadekuate (rrjeti hekurudhor gati jo-ekzistues), mungesa e burimeve njerëzore të afta dhe konkurruese për kosto, e kështu me radhë. Prandaj, përmirësimi i kualitetit të institucioneve me shumë gjasa do të prodhonte efektin me të madh pozitiv dhe të drejtpërdrejtë në konkurrueshmërinë, rritjen, dhe mirëqenien e Kosovës.

6.1 Parimet e politikave që përforcojnë konkurrueshmërinë

Përforcimi i konkurrueshmërisë në Kosovë kërkon një grup politikash të ndërtuara në parime specifike. Më poshtë japim parimet e dizajnuara nga Ketels (2010):

- Politikat të cilat do të shkrehnin konkurrueshmërinë e Kosovës duhet të jenë të gjera, të ndërtuara mbi nevojën për përmirësim të performancës përgjatë ekonomisë, e jo vetëm të sektorëve me orientim eksportues. Këto politika do të duhet të sigurojnë një sistem efikas transmissiion nga sektorët me orientim eksportues tek industritë lokale. Në këtë mënyrë vlera e sektorëve me orientim eksportues, të cilat në esencë janë motori i një ekonomie, do të gjeneronin rezultate me ndikim të gjerë e të cilat pastaj do të përktheheshin në standard të lartë jete dhe mirëqenieje;
- Politikat e konkurrueshmërisë duhet të jenë të orientuara kah arritja e nivelit më të lartë të prodhimtarisë. Politikat duhet të përqendrohen në rritje të prodhimtarisë, si synimi më i mirë afatgjatë dhe afatmesëm për rritje të prosperitetit dhe mirëqenies në vend;
- Politikat të cilat do të përforcojnë konkurrueshmërinë duhet të marrin parasysh kontekstin specifik të Kosovës, dhe të targetojnë barrierat aktuale të rritjes ekonomike dhe ato që ndërlidhen me konkurrueshmërinë;
- Strategjitë e konkurrueshmërisë duhet të kombinojnë përpjekjet për përmirësimin e kushteve të përgjithshme në ekonominë kosovare me përpjekjet të cilat targetojnë kushtet specifike e të cilat ndikojnë në aktivitetet individuale

Korniza e konkurrueshmërisë sipas QNT-së (2011) sipas të cilës janë hartuar një numër i rekomandimeve të dhëna këtu, mbështeten thellë në parimet e skicuara më lartë. Më tej, korniza sugjeron që reforma e politikave kombëtare për tregtinë duhet të kenë një qasje holistike. Kjo do të nënkuptonte së pari identifikimin e objektivave thelbësore dhe instrumenteve të përshtatshme politike për të adresuar shtrëngesat e konkurrueshmërisë ndërkombëtare.

Pastaj, hapat politik, përfshi ndryshimet e nevojshme në legjislacion dhe rregullative, duhet të zbatohen në radhë të duhur, dhe të kombinohen në sinergji për të krijuar politika dhe korniza institucionale përforcuese të dyanshme. Për më tepër, politika kombëtare e tregtisë duhet të vendosë ekuilibrin e duhur mes interesave të ndryshëm dhe kundërshtues në sektorin e tregtisë. Për këtë qëllim, Qeveria e Kosovës duhet të sigurojë mbështetjen e të gjithë hisedarëve, e veçanërisht të atyre nga sektori privat.

Në radhë, rekomandime të detajuara politike përqendrohen në shtrëngesat me të cilat bizneset kosovare ballafaqohen përtej kufirit, në kufi, dhe brenda tij.

6.2 Politikat prapa kufirit

Në kontekst të politikave prapa kufirit, Qeveria e Kosovës duhet të drejtojë vëmendjen e saj në këto fusha kryesore:

- Krijimi i një ambienti stabil, të parashikueshëm, dhe serioz për biznes i cili do të jetë i favorshëm për investimet e sektorit privat – vendor dhe të huaj – konkurrueshmëria, dhe aktiviteti ekonomik në përgjithësi. Në këtë kontekst, përpjekjet duhen përqendruar në tërheqjen e IHD, e veçanërisht IHD të cilat do të përforcojnë eksportin, pasi që potenciali investues në Kosovë është i kufizuar. Prandaj, rekomandimet kanë për qëllim të promovojnë rritjen e eksportit përmes adoptimit të politikave të favorshme për hyrjen e kapitalit të huaj:
 - Stabiliteti politik dhe makroekonomik
 - Shërbime me kosto të ultë dhe infrastrukturë efikase
 - Qeverisje të mirë, përfshirë uljen e korrupsionit
 - Mjedis më i mirë rregullativ përfshirë reduktimin e burokracisë
 - Zhvillim më i mirë aftësive dhe arsimimit të fuqisë punëtore
 - Mbrojtje më e mirë e të drejtave pronësore
 - Strategji më të mira për promovimin e investimeve, përfshi këtu edhe skemat nxitëse
- Ofrimi i shërbimeve konkurruese dhe infrastrukturë me kosto të ultë, si energjia, telekomunikacioni dhe transporti, do të rrite dukshëm konkurrueshmërinë e vendit. Kjo do të kërkonte:
 - Furnizim të rregullte me energji elektrike dhe me kosto të ultë
 - Infrastrukturë më të mirë rrugore dhe hekurudhore e cila do të lidhte Kosovën me rrugët kryesore rajonale dhe portet detare. Përderisa investime madhore janë në realizim e sipër, investimi

në rrjetin hekurudhor duhet të jetë prioriteti i mandatit të ardhshëm

- Pasi që anëtarët e CEFTA-s kanë filluar negociatat për liberalizimin e shërbimeve në rajon, shërbimi i transportit duhet të jetë me prioritetin më të lartë për Qeverinë e Kosovës. Flota transportuese e Kosovës po kalon nëpër pengesa madhore për ofrimin e shërbimeve të transportit rajonal dhe ndërkombëtar;
- Aplikimi i rregullave të përshtatshme të konkurrencës në sektorët të cilat ofrojnë shërbime të infrastrukturës është vitale për furnizimin efikas me kësi lloji shërbimesh
- Sigurimi se produktet përmbushin standardet e kualitetit dhe ato fito-sanitare (KFS). Të gjitha produktet, qofshin bujqësore apo të prodhuara, i përmbushin kërkesat teknike (KT). Produktet me origjinë shtazore dhe bimore duhet po ashtu të përmbushin standarde sanitare dhe fito-sanitare. Këto çështje që kanë të bëjnë me qasjen në treg duhen adresuar nga institucionet e Kosovës duke u përqendruar në:
 - Të ridrejtohet vëmendja e organeve të cilat sigurojnë kualitetin e produkteve drejtë mbështetjes së aktiviteteve eksportuese. Sipas UNIDO¹⁸ kjo mund të arrihet me:
 - Identifikimin e sektorëve eksportues dhe gamën e produkteve të prodhuara në Kosovë
 - Identifikimin e tregjeve për të cilat destinohen këto produkte kosovare dhe standardet KFS dhe KT të cilat duhen përmbushur në tregun e destinuar
 - Të përcaktohet vëllimi i tregtisë dhe të llogaritet numri i testimeve dhe inspektimeve laboratorike, kalibrimi i pajisjeve, dhe certifikimet e sistemeve ndërmarrëse të nevojshme për përmbushjen e standardeve KFS dhe KT
 - Të mbështeten bizneset në përmbushjen e kërkesave KFS dhe KT nga tregjet tek të cilat synojnë të depërtojnë. Përmbushja e standardeve është e kushtueshme, e veçanërisht për bizneset e vogla në Kosovë;
 - Përmes Drejtoratit për Akreditim, të sigurohet për pajtueshmëria e organeve vlerësuese (laboratorët dhe inspektimet) me praktikën dhe standardet më të mira ndërkombëtare;
 - Të sigurohet se organet laboratorike dhe inspektuese që ofrojnë shërbime të plotësimit të standardeve kanë akreditim

¹⁸ Vizituar në: http://www.unido.org/fileadmin/user_media/Publications/documents/fast_forward.pdf

ndërkombëtar për të garantuar pranimin global të certifikatave të lëshuara;

- Të sigurohet saktësia e testimeve dhe kalibrimi i besueshëm i pajisjeve testuese duke rritur kapacitetet e Departamentit për Metrologji në fushat e dimensioneve, vëllimit, masës, termometrisë, shtypjes, dhe metrologjisë elektrike;
- Të vetëdijesohen bizneset për rëndësinë e përmbushjes së standardeve ndërkombëtare për produktet;
- Të rriten kapacitetet institucionale të mekanizmave sigurim të kualitetit në Kosovë për t'i ofruar bizneseve kosovare shërbime efikase

6.3. Politikat Brenda Kufirit

Politikat brenda kufirit i referohen mundësimit të tregtisë efektive e të cilat risin konkurrueshmërinë duke u mundësuar eksportuesve të tregtojnë mallra dhe shërbime me kohë dhe me kosto të ultë transaksioni. Modernizimi i shërbimeve logjistike kërkon lëvizjen e një grupi të këtyre shërbimeve brenda kufijve. Disa nga reformat e fundit logjistike në Kosovë përfshijnë inspektimin e mallrave në терминаlet brenda vendit, magazinimin, menaxhimin e të dhënave, vlerësimin e riskut, etj.

Masat që duhen ndërmarrë për lehtësimin e tregtisë në Kosovë duhet të nxjerrën nga vetë-vlerësimi i fundit i realizuar nga vetë Qeveria e Kosovës për përmbushjen e Marrëveshjes se OBT-së për Lehtësim të Tregtisë. Megjithatë, në theksojmë se çështjet në vijim kërkojnë adresim urgjent:

- Riorganizimin e mëtutjeshëm të procedurave dhe sistemeve të zhdoganimit duke reduktuar dokumentacionin e kërkuar dhe eliminuar praktikat komplekse që shkaktojnë vonesa në lëvizjen ndërkufitare të mallrave;
- Për një vend si Kosova, pa qasje në det, konkurrueshmëria e sektorëve eksportues varet ehe nga efikasiteti i shërbimeve doganore në shtetet fqinje. Prandaj, pavarësisht nga vendet tjera, autoritetet kosovare duhet të punojnë nga afër me homologët e tyre në Shqipëri (pasi që Shqipëria është dalja e vetme për eksportuesit kosovar drejt tregjeve ndërkombëtare) në riorganizimin e procedurave të inspektimit në kufi, harmonizimin e procedurave dhe dokumentacionit, ngritjen e efikasitetit

- të agjencive kufitare dhe autoriteteve detare, lehtësimi e transitit, profilizimin e përbashkët të riskut, e kështu me radhë;
- Përkushtim më i madh në zbatimin e sistemeve të integruara për menaxhimin e riskut gjatë regjimeve të zhdoganimit dhe inspektimit në kufi, e veçanërisht të Agjencisë Kosovare për Ushqim dhe Veterinari. Doganat e Kosovës e kanë të vendosur sistemin e riskut mirëpo janë të nevojshme përpjekje më të shumta për ta bërë këtë më efikas. Megjithatë, Agjencia Kosovare për Ushqim dhe Veterinari vazhdon ta kryejë inspektimin fizik të 100 për qind të ngarkesave me produkte që kanë origjinë shtazore dhe bimore; gradualisht kjo duhet të bartet tek inspektimi i bazuar në risk;
 - Të përmirësohet kualiteti dhe furnizimi me shërbime logjistike, e veçanërisht të agjentëve që ofrojnë shërbime doganore. Tash për tash, agjentët doganor janë një ngushticë e rëndësishme në operimet ndërkufitare. Zakonisht, përfitimet nga avancimi i një apo me shumë agjencive kufitare nuk mund të realizohen në tërësi përderisa nuk eliminohen pengesat e procesit të kontrollit kufitar në hallkat tjera të zingjirit; si për shembull, agjentët doganor. Dogana e Kosovës duhet mbështetur në procesin e certifikimit, të filluar se voni për të reformuar sektorin e agjentëve doganor në Kosovë;
 - Të përforcohet më tutje e ashtuquajtura infrastruktura e rëndë që lehtëson tregtinë, përfshirë këtu infrastrukturën fizike në kufi dhe teknologjinë informative dhe të komunikimit për të përmirësuar efikasitetin dhe produktivitetin drejt uljes së kostos së transaksionit.

6.4 Politikat përtej kufirit

Përfundimisht, siç është diskutuar, Kosova ka liberalizuar, dhe është në proces të liberalizimit të gati 80 për qind të tregut të saj. Kjo nënkupton se mallrat kosovare janë duke dhe do të lëvizin të liruar nga ngarkesat tarifore drejt tregjeve kryesore të eksportit siç janë shtete fqinje, ato të BE-së, dhe Turqisë. Megjithatë, janë të shumta pengesat në rrugë të qarkullimit të lirë të mallrave, e veçanërisht ato që vijnë në formë të masave jo-tarifore si KFS dhe KT. Prandaj kërkohet vëmendje e veçantë që:

- Të negociohet me shtetet e CEFTA-s dhe të BE-së, qoftë në formë bilaterale apo multilaterale, reduktimi i barrierave jo-tarifore për mallrat industriale dhe bujqësore, e veçanërisht standardet e KFS dhe KT. Çështjen më urgjente përbëjnë barrierat jo-tarifore që ka imponuar Serbia e të cilat vijnë në forma të ndryshme, dhe kështu pengojnë edhe transitin prej dhe në Kosovë. Në rast të dështimit,

Qeveria duhet të konsideroj marrjen e masave të njëanshme drejt shteteve specifike pasi që këto rrisin shumë kostot për bizneset kosovare

- Të negociohet qasje më e madhe tek shërbimet e CEFTA-s. Siç u cekë më parë në kuadër të shërbimeve të transportit, Kosova është duke negociuar shërbimet brenda CEFTA-s dhe për këtë është e rëndësishë më të madhe që të sigurohet pjesëmarrje e gjerë e hisedarëve, përmbushje e kërkesave të OBT-së, vlerësim i ndikimit në ekonomi, negocim dhe pajtim për afatet të cilat do të i sigurojnë Kosovës përfitimet maksimale ekonomike;
- Siç u cekë më lartë, tashmë është arritur pajtimi me BE-në në kuadër të MSA-së për dispozitat kryesore për tregtim të shërbimeve. Megjithatë është rrugë e gjatë deri të arrihet liberalizimi i plotë i shërbimeve mes palëve. Rishikimi i dispozitave që mbulojnë shërbimet të parapara me MSA duhet përqendruar në eliminimin e kufizimeve ndaj lëvizjes së fuqisë punëtore, pasi kjo e fundit duket të ketë efekt të fuqishëm negativ në fitimet potenciale të Kosovës.
- Të lëvizet në mënyrë konstante drejt anëtarësisë në OBT. Anëtarësia ka përfitime madhore, por as rreziqet nuk bën injoruar. Anëtarësia e Kosovës në OBT duhet shikuar nga perspektiva zhvillimore e vendit.

6.5 Politikat Industriale dhe Konkurrueshmëria

Ashtu siç tregojnë rezultatet e studimit, brenga më e madhe me ekonominë e Kosovës ka të bëjë me kapacitetin e saj furnizues. Prandaj, përpos masave të propozuara, Qeveria e Kosovës duhet të mbështetet edhe në mekanizmat e politikave industriale të cilat nxisin kapacitetin ofertues të vendit dhe konkurrueshmërinë e vendit. Shembuj udhëzues ka shumë, por njëkohësisht janë të larta edhe rreziqet. Një shembull udhëzues përbëhet nga dhjetë studime industrish të prezantuar nga Chandra (2006) të cilat tregojnë se me përkrahjen dhe promovimin e zhvillimit të teknologjisë dhe inovacionit industrial, politikat përkrahëse të qeverisë luajnë rol kritik sepse i mundësojnë kësaj industrie të bëhet konkurruese si në tregun vendor ashtu edhe në atë ndërkombëtar.

Është përtej kornizave të këtij studimi që të identifikojmë mekanizmat potenciale të politikave industriale që do të mbështesin re-industrializimin e Kosovës. Megjithatë, duke u mbështetur në literaturën në këtë temë, mund të zhvillojmë një grup të parimeve udhëzuese (shih Rodrik, 2007). Një ndër parimet kryesore ka të bëjë me arkitekturën institucionale të nevojshme për politika të suksesshme industriale. Arsyeja kryesore pse politika industriale nuk ka qenë e favorizuar në qarqet akademike dhe organet politik-bërëse që nga fillimi i viteve 1980 ishte dështimet e qeverisë – që nënkupton asimetrinë në informim, korrupsionin, dhe mitmarrjen – janë parë si shkaktare të shtrembërimeve shumë më të mëdha në ekonomi se sa dështimet e tregut. Prandaj, ringjallja e vonshme e

politikave industriale si mekanizëm i tërheqjes së vendeve në zhvillim nga vështirësitë persistente ekonomike i jep vëmendje me të madhe strukturës së nevojshme institucionale për politika të suksesshme industriale. Në këtë kontekst, politikat industriale duhet të ndërtohen në bazën e:

- Përkrahjes dhe udhëheqjes së fuqishme politike që nga maja
- Sigurimit të koordinimit të fuqishëm të të gjithë hisedarëve, si privat ashtu edhe publik, dhe
- Ndërtimit mbi mekanizma të fuqishëm të llogaridhënies dhe transparencës.

Përpos domosdoshmërisë së një dizajni specifik institucional për politika të suksesshme industriale, shtytësit e tjerë vijnë nga përbërës tjerë si: përcaktimi i standardeve bazë për sukses dhe dështim; mbështetja e aktiviteteve më shumë se sektorëve; mbështetja e aktiviteteve të cilat gjenerojnë efekt ‘spillover’ brenda industrisë dhe më tej, e kështu me radhë. Një vërejtje veçohet nga diskutimet e fundit për politikat industriale e kjo është që duhet patjetër ‘identifikuar humbësit’ (njëra nga hallkat e dobëta të kësaj politike). Megjithatë, Rodrik argumenton (2007, f. 116) “... synim nuk duhet të jetë minimizimi i rasteve për shfaqje të gabimit ... por të minimizohen kostot e gabimeve kur ato ndodhin. Nëse qeveritë nuk gabojnë, atëherë ato nuk janë duke punuar sa duhet”.

6.6. Produktiviteti dhe Konkurrenca – masat specifike për kompanitë

Mjedisi miqësor për biznes redukton shkallën e përgjithshme të riskut dhe të paqartësisë në ekonomi dhe indukon investimet në kompanitë private dhe rrite aktivitetin afarist. Në këtë kontekst është me shume rëndësi që t’u jepet prioritet mekanizmave specifike për kompanitë e të cilat do të rrisin produktivitetin në nivel të kompanive. Prandaj, për të arritur shkallë më të lartë të konkurrencës, bizneset kosovare me orientim ndërkombëtar duhen synuar këto mekanizma – në mes tjerash – të cilat forcojnë produktivitetin:

- Menaxherët kanë rol kritik në nxitjen e ndryshimeve në produktivitet. Prandaj bizneset duhet të aplikojnë ose krijojnë mekanizma të cilat zhvillojnë menaxhere të talentuar dhe të aftë dhe me vizion ndërkombëtarë;
- Produktiviteti është i ndërlidhur me kualitetin e fuqisë punëtore, përfshi këtu arsimimin, trajnimin, ekspertizën e përgjithshme, dhe kohën në kompani. Prandaj kompanitë duhet të punësojnë fuqi punëtore të arsimuar dhe të aftë. Veç kësaj, kompanitë duhet të dizajnojnë dhe të themelojnë mekanizma për zhvillim të fuqisë punëtore, përfshi trajnimet dhe mentorimet në vend të punës. Kjo e fundit është kritike për bizneset me orientim ndërkombëtar pasi që dihet se në përgjithësi fuqia punëtore në Kosovë ka aftësi të ulta;
 - Investimet kapitale në teknologji të re dhe të avancuar përfshirë atë informative duhet të jetë prioriteti tjetër për biznes. Veç kësaj, kompanitë

duhet të përqendrohen në avancimin e të ashtuquajturit “kapital i paprekshëm” siç është reputacioni, njohuria, dhe të ngjashme:

- Gradualisht, bizneset duhet të fillojnë me investime në hulumtim dhe zhvillim (H&Zh). Shpenzimet H&Zh, dhe inovacionet pasuese, janë shtytësi kryesor i diferencialit produktiv të tyre;
- Për bizneset e vogla me orientim ndërkombëtar nevojitet të arrihet një ndërlidhje me homologet e tyre më të mëdhenj dhe kompanitë e huaja. Efektet ‘spillover’ të produktivitetit nga kompanitë e mëdha të huaja janë dëshmuar si nxitës të produktivitetit të kompanive tjera.

Bibliografia

Anderson, J. E. (1979). A Theoretical Foundation for the Gravity Model, *American Economic Review* 69(1): 106-116.

Anderson, J. E. (2010). The Gravity Model. NBER Working Paper 16576.

Anderson, J. E. and van Wincoop, E. (2003). Gravity with Gravitas: A Solution to the Border Puzzle, *American Economic Review* 93(1): 170-192.

Anderson, J. E. and van Wincoop, E. (2004). Trade Costs, *Journal of Economic Literature* 42(3): 691-751.

Baldwin, R. and Taglioni, D. (2007). Trade Effects of the Euro: a Comparison of Estimators. *Journal of Economic Integration* 22(4): 780-818.

Bernard, A. B. and Jensen, J. B. (2004). Why Some Firms Export? *The Review of Economics and Statistics* 86(2): 561–569.

Bernard, A. B. and Wagner, J. (1998), Export Entry and Exit by German Firms, NBER Working Paper 6538.

Cameron A. and Trivedi, P. (2010; revised edition). *Microeconometrics Using Stata*. Stata Press: College Station, Texas.

Chandra, V. (2006), *Technology, Adaptation, and Exports: How Some Developing Countries Got It Right*, ed. Washington DC: The World Bank.

- Clercq, D. D., Sapienza, H. J., and Crijns, H. (2005). The Internationalisation of Small and Medium-sized Firms. *Small Business Economics* 24: 409–419.
- De Benedictis, L., and D. Taglioni (2011). The Gravity Model in International Trade, in L. De Benedictis and L. Salvatici (eds.) *The Trade Impact of European Union Preferential Policies: An Analysis through Gravity Models*. Berlin: Springer.
- Deardorff, A. V. (1998). Determinants of Bilateral Trade: Does Gravity Work in a Classical World? In Frankel, J. A. (ed.) *The Regionalization of the World Economy*. Chicago: Chicago University Press.
- Dixit, A. (1989). Entry and exit decisions under uncertainty, *Journal of Political Economics*, 97 (3): 620-38.
- Dutt, P. Santacreu, A. M. and Traca, D. (2014). The Gravity of Experience. mimeo. <http://federation.ens.fr/ydepot/semin/texte1314/DUT2014GRA.pdf>. Accessed on: December 8, 2013.
- Eaton, J., and S. Kortum (2002). Technology, Geography, and Trade. *Econometrica* 70(5): 1741-1779.
- Enti Krahinor i Statistikës (various years). *Vjetari Statistikor i KSA të Kosovës*, Prizren: OPGL Ramiz Sadiku
- Feenstra, R., Markusen, J., and Rose, A. (2001), Using the Gravity Equation to Differentiate Across Alternative Theories of Trade, *Canadian Journal of Economics* 34: 430–47.
- Fontagné, L., Freudenberg, M., and Péridy, N. (1997). Trade Patterns Inside the Single Market. CEPII Working Papers 1997-07. <http://www.cepii.fr/anglaisgraph/workpap/pdf/1997/wp97-07.pdf> Accessed on: October 15, 2013.
- Frankel, J. A, and Rose, A. (2002). An Estimate of the Effect of Common Currencies on Trade and Income. *The Quarterly Journal of Economics* 117: 437-466
- Gashi, P., Hashi, I. and Pugh, G. (2014). Export behaviour of SMEs in transition countries. *Small Business Economics* 42: 407–435
- Gould, D. (1994). Immigration Links to the Home Country: Empirical Implications for US Bilateral Trade Flow, *Review of Economic and Statistics* 76 (2): 302–316.
- Greene, W. (2008; 6th Ed.). *Econometric Analysis*, New Jersey: Prentice Hall.

Hausmann, R., Rodrik, D. and Velasco, A. (2008). Growth Diagnostics. In Serra, S. and Stiglitz, J. E. The Washington Consensus Reconsidered: Towards a New Global Governance. Oxford: Oxford University Press.

Havranek, T. (2010). Rose Effect and the Euro: Is the Magic Gone? Review of World Economics 146(2): 241-261.

Head, K. and Mayer, T. (2013). Gravity Equations: Workhorse, Toolkit, and Cookbook. http://strategy.sauder.ubc.ca/head/papers/headmayer_revised.pdf. Accessed on: January 15, 2014.

Helpman, E., M. Melitz, and Y. Rubinstein (2008). Estimating Trade Flows: Trading Partners and Trading Volumes. Quarterly Journal of Economics 103(2): 441-487.

International Trade Centre (2011), National Trade Policy for Export Success, ITC: Geneva. <http://www.intracen.org/National-Trade-Policy-for-Export-Success/>.

Jacks, D. S., Meissner, C. and Novy, D. (2008). Trade Costs, 1870–2000, American Economic Review: Papers & Proceedings 98(2): 529–534

Kandilov, I. T., and Grennes, T. (2010). The determinants of service exports from Central and Eastern Europe. Economics of Transition 18(4): 763–794

Ketels, C. (2010), Export Competitiveness: Reversing the Logic. Paper prepared for World Bank's Development Debate, 'What do we mean by Export Competitiveness and How do Countries Achieve it in an Uncertain World?', Harvard Institute for Strategy and Competitiveness, 2010.

Linneman, H., and Verbruggen, H. (1991). GSTP Tariff Reduction and its Effects on South-South Trade in Manufacturers. World Development 19: 539-551.

Linotte, D., Gashi, P., Dalladaku, Rr., Mahmudi, B., Fetahu, M., and Islami, M. (2013), Preparing Kosovo for the Trade Aspects of the Stability and Association Agreement Negotiations with the EU. A part of the EU funded project "Further Development of Kosovo's Trade Policy" implemented by GFA Consulting Group/ACE/CARDNO.

McCallum, J. (1995). National Borders Matter: Canada – US. Regional Trade Patterns. American Economic Review 85(3): 615-623.

Melitz, M. (2003). The Impact of Trade on Intra-industry Reallocations and Aggregate Industry Productivity. Econometrica 71(6): 1695–1725.

- Parsons, C. R. (2012). Do Migrants Really Foster Trade? The Trade-Migration Nexus, a Panel Approach 1960–2000, World Bank Policy Research Working Paper 6034.
- Peci, F., Holzner, M. and Kutllovci, E. (2010). Determinants of Kosovo Trade: A Gravity Model Approach. *South East European Journal of Economics and Business* 5(2): 33-41.
- Riinvest (2007). Diaspora and Migration Policies. Study Prepared for Forum 2015. Prishtina: Kelmendi Paper.
- Roberts, B. A. (2004), A Gravity Study of the Proposed China-ASEAN Free Trade Area. *The International Trade Journal* XVIII(4): 335-353
- Roberts, M. J., and Tybout, J. R. (1997). The Decision to Export to Columbia: An Empirical Model of Entry with Sunk Costs. *American Economic Review* 87(4): 545–564.
- Rodrik, D. (2007), *One Economics, Many Recipes*, New Jersey: Princeton University Press
- Roodman, D. (2009a). How to do xtabond2: An introduction to difference and system GMM in Stata. *The Stata Journal*, 9(1): 86-136.
- Roodman, D. (2009b). A short note on the theme of too many instruments. *Oxford Bulletin of Economics and Statistics* 71(1): 135-158
- Rose, A. (2000). One Money One Market: Estimating the Effect of Common Currencies on Trade, *Economic Policy*, 15: 7–46.
- Rose, A. (2004). Do We Really Know That the WTO Increases Trade?, *American Economic Review* 94: 98–114.
- Santos Silva, J. and Tenreyro, S. (2006). The Log of Gravity, *The Review of Economics and Statistics*, 88(4): 641-658.
- Santos Silva, J. and Tenreyro, S. (2011). poisson: Some convergence issues, *The Stata Journal* 11(2): 207–212
- Shepherd, B. (2013). *The Gravity Model of International Trade: A User Guide*. United Nations ESCAP. <http://www.unescap.org/tid/publication/tipub2645.pdf>. Accessed on: October 5, 2013.
- Tinbergen, J. (1962). *Shaping the World Economy: Suggestions for an International Economic Policy*. New York: The Twentieth Century Fund.
- Todaro, M. P. and Smith, S. C. (2009). *Economic Development*. 10th edition. Harlow: Addison Wesley.

Wooldridge, J. (2005) Simple Solutions to the Initial Conditions Problem in Dynamic, Nonlinear Panel Data Models with Unobserved Heterogeneity, *Journal of Applied Econometrics* 20: 39-54.

WTO (2012), *A Practical Guide to Trade Policy Analysis*. Geneva: World Trade Organization

Yamarik, S., and Ghosh, S. (2005). A Sensitivity Analysis of the Gravity Model, *The International Trade Journal* XIX(1): 83-126

Aneks 1: MODELI I GRAVITETIT:

A1.1 Literatura mbi Modelin e Gravitetit

Studimi aplikon qasjen e ashtuquajtur Modeli I Gravitetit, i cili ka shërbyer si mjeti kryesorë empirik në analizimin e tregtisë mes shteteve dhe të politikave tregtare për mbi 50 vjet. Për rëndësinë e modelit të gravitetit si mjeti më i rëndësishëm empirik në tregtinë ndërkombëtare, shkruajnë De Benedictis dhe Taglioni (2011, f. 56) thonë:

... që nga konceptualizimi i parë nga ana e Tinbergen (1962) ekuacioni i gravitetit është përdorë shumë shpesh për të analizuar në formë empirike tregtinë mes shteteve. Është definuar si 'kalë pune' i tregtisë ndërkombëtare dhe është konsideruar si 'dëshmi i jetës' në fushën e hulumtimeve. Aftësia e ekuacionit të gravitetit për të përlogaritur saktësisht in tregtar mes dy vendeve e bën atë njërin nga raportet më të qëndrueshme empirike në ekonomi.

Në frymë të njëjtë, Anderson (2010, f.1) argumenton:

Ka që moti që graviteti është modeli më i suksesshëm empirik në ekonomi, duke i renditur jashtëzakonisht mirë vrojtimet enorme të variacioneve në ndërveprimin ekonomik në hapësirë si në lëvizjet e tregtisë ashtu edhe të faktorëve.

Ashtu siç sugjeron edhe vetë emri, modeli i gravitetit rrjedh nga ligji i Njutonit për gravitacionin: ashtu si planetët, të cilat tërhiqen mes vete në proporcion me madhësinë dhe distancën ndërmjet tyre, po ashtu edhe shtetet tregtojnë në proporcion me BPV dhe distancën (OBT, 2012). Në formën e tij më të thjeshtë, modeli i gravitetit, sipas Shephard (2013) ndërlidh fluksin e tregtisë (fluksin e eksportit, fluksin e importit, apo mesataren e fluksit të tregtisë bilaterale) drejtpërdrejtë me madhësinë e një ekonomie (zakonisht të përfaqësuar me BPK, BPV, dhe në disa raste edhe me popullatën) dhe me koston tregtare (të përfaqësuar nga distanca gjeografike mes qendrave ekonomike të dy shteteve, e që zakonisht janë kryeqytetet) duke nxjerrë në pah kështu disa rregulla të thella në mostrat e tregtisë ndërkombëtare. Në këtë kontekst, nga këndvështrimi teorik, sipas De Benedictis dhe Taglioni (2011), ekuacioni i gravitetit është në fakt ekuacion i shpenzimeve, përmes të cilit BPV i importuesit futet në ekuacion për të nxjerrë në pah efektin në të hyra, e që nënkupton, ndikimin e ndryshimeve në të hyrat e një ekonomie në sasinë e kërkuar të mallrave dhe shërbimeve. Përveç kësaj, me faktorët tjerë të pandryshuar, faktori i distancës futet si përfaqësues i koston së tregtisë bilaterale, e cila bartet pastaj në çmimin e konsumatorit. Në fund, BPV i eksportuesit, në formën tradicionale, përfaqëson kapacitetin eksportues apo ofertues të një shteti.

Që nga fillimi i tetëdhjetave, hulumtimi sipas modelit të gravitetit u rifokusua në

zhvillimin e mbështetjeve teorike për modelin. Anderson (2010, f. 1) dëshmon se për një periudhë të gjatë, modeli i gravitetit ka mbetur i distancuar nga teoritë dominonte ekonomike, gati si një “jetim intelektual, pa kurrfarë lidhjesh me familjen e pasur të teorive ekonomike.” Deri atëherë, gati pothuajse të gjitha zhvillimet rreth modelit të gravitetit kishin të bëjnë me të dhënat empirike për raportet brenda ekuacionit të gravitetit. Dhe siç është cekur më lartë, Anderson (2010) kishte dëshmuar më tutje se kredencialet empirike të modelit të gravitetit ishin të jashtëzakonshme.

Pas Anderson (1979) dhe të arriturave të mëvonshme të Anderson dhe van Wincoop (2003), Baldwin dhe Taglioni (2007), dhe Anderson (2010), një model i qëndrueshëm teorik i gravitetit ka këto përbërës:

$$X_{ij} = \frac{BPV_i BPV_j}{BPV_w} \left(\frac{t_{ij}}{\Pi_i P_j} \right)^{1-\sigma}$$

Ku:

X_{ij} – eksportet nga shteti i në j ;

BPV_w – BPV Botërore;

BPV_i dhe BPV_j – BPV i shteteve i dhe j ;

t_{ij} – kostoja në shtetin j për import të mallit nga shteti i ;

σ – elasticiteti i zëvendësimit;

Π_i dhe P_j – rezistenca shumëpalëshe të shtetit i ndaj kushteve të jashtme dhe të shtetit j ndaj kushteve të brendshme

Në këtë formulë, elasticiteti i faktorit të zëvendësueshmërisë është më i madh se 1 ($\sigma > 1$). Faktori i kostonë së tregtimit, $t_{ij} \geq 1$, shpjegohet si bruto kostoja bilaterale e importimit të mallit (një plus ekuivalenti i tarifës). Në fjalë tjera, nëse p në shtetin e origjinës (d.m.th. shtetin i) është kostoja e ofertës për një mall, $p_{ij} = t_{ij}p_i$ është çmimi të cilin e paguajnë konsumatorët në shtetin e destinacionit (dmth shteti j). Variabilet e rezistencës shumëpalëshe, apo të ashtuquajturat lehtësimet për importuesit dhe eksportuesit për qasje në treg, nxjerrin në pah mesataren shtetërore të barrierave ndaj tregtimit ndërkombëtar. Si të tilla, ato nxjerrin në pah si pengesat ndaj it tregtar mes dy vendeve, i cili shfaqet në nivel bilateral (rezistenca bilaterale) dhe të peshës së këtyre pengesave, në relacion me ato të të gjitha shteteve tregtuese (të njohura si rezistencë shumëpalëshe). Sipas Shepherd (2013, p.14), ‘ky model merr parasysh faktin se

ndryshimet e koston tregtare në një kahje bilaterale mund të ndikojnë në et tregtare në të gjitha kahjet tjera për shkak të efektit relativ të çmimit.’ Në fjalë tjera, rezistenca shumëpalëshe e drejtuar nga jashtë (Γ_i) nxjerr në pah se lehtësia e qasjes në eksporte për shtetin A në shtetin B varet jo vetëm nga kostoja e tregtisë bilaterale – rrjedhimisht dhe promovimi/pengimi i tregtisë bilaterale -- mes këtyre dyjave por edhe relacioni që këto shtete A dhe B e kanë me një shtet të tretë C (dhe njëkohësisht edhe me shtetet tjera) dhe mënyrën se si do të ndikonte marrëveshja e tregtisë së lirë mes B dhe C në eksportet prej A në B. Ngjashëm, rezistenca shumëpalëshe drejtuar kah brenda (P_j) izolon mundësinë që importi nga shteti B të varet jo vetëm nga kostoja e tregtisë bilaterale mes A dhe B, por po ashtu edhe nga relacioni mes që të dy shtetet A dhe B dhe një shteti të tretë C (dhe me shtete tjera). Futja në përdorim e kushteve të rezistencës shumëpalëshe drejtuar brenda (P_j) dhe drejtuar nga jashtë (Γ_i) në ekuacionin e gravitetit ka qenë më domethënëseja në shtojcat teorike të kohës së fundit në modelin e gravitetit.

Duke ndërtuar në këto zhvillime teorike, ekuacioni i gravitetit është nxjerr nga korniza të ndryshme të tregtisë, përfshirë këtu atë të avantazhit krahasues të Ricardos (Eaton dhe Kortum, 2002), qasjen e faktorit të prodhimit të Heckscher dhe Ohlin, kornizën e konkurrencës monopol (për më tepër shih Feenstra dhe tjerët, 2001), dhe së fundmi edhe modelet e tregtisë ndërkombëtare me heterogjenitet të kompanive (Helpman dhe tjerët, 2008).

Për më tepër, modeli i gravitetit ka gjetur përdorim të gjerë në përcaktimin e efekteve *ex-ante* dhe *ex-post* të tregtisë dhe mekanizmave të tjerë. Tarifat dhe instrumentet jo-trifore kanë qenë përbërësit më të shpeshtë të modeleve të gravitetit (shih Linneman dhe Verbruggen, 1991, dhe WTO, 2012). Përveç kësaj, efektet e MSA-së në fluksin tregtar janë analizuar gjerësisht dhe kanë përfshirë edhe efektet e krijimit dhe devijimit të tregtimit nga MSA-ja (shih De Benedictis dhe Taglioni, 2011, dhe Shepherd, 2013). Për më tepër, Rose (2004) dhe Helpman et al. (2008) studiojnë ndikimin që anëtarësia në OBT ka në tregti. Rose (2000) dhe Frankel and Rose (2002) përdorin modelin e gravitetit për të vlerësuar efektet e paqëndrueshmërisë së kursit të këmbimit dhe të unioneve monetare në tregti.

Modeli i gravitetit është aplikuar në sektorë të ndryshëm dhe rrethana të ndryshme shtetërore. Sa i përket të parës, ekuacioni i gravitetit është aplikuar të vlerësojë mostrat tregtare në manifakturë (Linneman dhe Verbruggen, 1991) dhe shërbime ((Kandilov dhe Grennes, 2010; Shepherd, 2013). Sa i përket të dytës, fluksi tregtar është përlllogaritur në nivel bilateral rajonal dhe botëror. Shembuj të vlerësimit të kampioneve tregtare në nivel bilateral përfshijnë McCallum (1995) për fluksin tregtar mes SHBA dhe Kanadës. Në nivel rajonal, vlen të përmendet studimi i Fontagné et al. (1997) për kampionet tregtare

brenda BE-së. Në fund, një numër i studimeve të kohës së fundit aplikojnë modelin e gravitetit në baza të të dhënave për shtetet përreth tërë globit (p.sh., Helpman et al., 2008, mbulojnë 158 shtete në mbarë botën).

A 1.2 Çështje Ekonometrike të Modelit të Gravitetit

Avancimet në modelin teorik dhe empirik të gravitetit janë bërë më të kushtueshme për shkak të vëmendjes që duhet kushtuar vetë teorisë. Megjithatë, kjo sjell përfitimin nga siguria me e madhe sa i përket specifikimeve të modelit të gravitetit dhe rrjedhimisht të raporteve që duhen marrë parasysh në model (shih diskutimin e mëhershëm). Së dyti, që nga Anderson dhe Wincoop (2003), një model graviteti i qëndrueshëm në aspektin teorik duhet të kontrollojë rezistencën ndaj tregtisë dy- dhe shumëpalëshe. Sipas argumentit të tyre, të kontrolluarit e rezistencës shumëpalëshe do të prodhojë llogaritje të paanshme të ndikimit që mund të ketë distanca dhe ndryshore tjera bilaterale në fluksin tregtar. Së treti, heterogjeniteti i kompanive nënkupton nevojën që një strategji të konsiderojë dhe zero vrojtimet në matricën tregtare, e cila në të kundërtën do të shkaktojë probleme të selektimit. Dhe së fundi, duhet adresuar edhe çfarëdo çështje tjetër mbi endogjenitetin e mundshëm brenda modelit.

Për të modeluar dinamikën e flukseve tregtare është e nevojshme të specifikohet modeli i panelit dinamik, që nënkupton se një model duhet të inkuadrojë ndryshoren e varur të së kaluarës – në këtë rast, tregtinë në të kaluarën – në mesin e ndryshoreve shpjeguese (për më tepër mbi modelet e paneleve dinamik shih Wooldridge, 2002; Greene, 2008). Perspektiva ekonometrike për rëndësinë e dinamikave modeluese është dhënë nga Greene (2008, f. 469) dhe është në përputhje me argumentin ekonomik të cilin e prezantojnë Eichengreen dhe Irwin (1998):

Me shtimin e dinamikës në një model ... krijohet ndryshim madhor në interpretimin e ekuacionit. Pa ndryshoren e të kaluarës, “ndryshoret e pavarura” përfaqësojnë setin e plotë të të dhënave të cilat prodhojnë rezultatin e vrojtuar y_{it} . Me ndryshoren e të kaluarës, në ekuacion kemi të tërë historinë e ndryshoreve nga ana e djathtë, kështu që *çfarëdo ndikimi i matur është i kushtëzuar nga kjo histori*; në këtë rast, çfarëdo ndikimi i x_{it} (ndryshoreja e pavarur) përfaqëson efektin e të dhënave të *reja*.

Kur të merren parasysh argumentet ekonomike për inkuadrimin e historisë së fluksit tregtar dhe mjeteve ekonometrike për këtë, modelet e paneleve dinamike, e veçanërisht kur të llogariten përmes vlerësuesve metoda-e-momentit, janë të përshtatshëm të vlerësojnë një model gravitet të përputhshëm me teorinë, ndërsa modelet panel të kryqëzuara apo statike nuk mund të jenë të tilla vetëm me përcaktim. Megjithatë, para se

të konkludohet me preferencën për modelimin dinamik, duhet të marrim parasysh edhe dy çështje tjera të cilat i thekson teoria, e që janë: kontrollimi i faktorëve të rezistencës tregtare shumëpalëshe; dhe adresimi i burimeve tjera të mundshme të endogjenitetit.

Baldwin dhe Taglioni (2007, f. 786) tregojnë se faktorët e rezistencës tregtare shumëpalëshe (apo si e quajnë ata jo-konstanta gravitacionale) mund të modelohen me ndryshore cilësore shtesë të cilat izolojnë kostot e tregtisë bilaterale mes palës shtet i origjinës dhe shtet i destinacionet ('kështu që është e ndryshme për çdo palë partnerësh tregtar, dhe ndryshon në periudha kohore'). Ndikimet e lëna jashtë të tregtisë mes seksioneve dhe/ose të ndryshme në periudha kohore të lidhura me ndryshoret e inkuadruara në model – p.sh. kostot tregtare të vlerësuara përmes distancës – do të shfaqen në gabimet në regresion dhe kështu do t'i japin rritje endogjenitetit dhe vlerësimeve të anëshme korresponduese. Baldwin dhe Taglioni (2007, f. 799) i analizojnë dy format më të shpeshta për të adresuar këtë problem, e që është: specifikimi i modelit të gravitetit ose me ndryshore cilësore shtesë për një shtet ('ndryshore me vlerën 1 për gjithë fluksin tregtar për një shtet specifik'); ose me ndryshoren për palë shtetesh ('ndryshore që ka vlerën 1 për të gjitha vërtetimet e tregtisë mes dy shteteve'). Natyrisht se nuk mund të inkuadrohet që të dyja sepse janë kolineare. Kur krahasuan meritat relative të këtyre dy qasjeve, Baldwin dhe Taglioni (2007, f. 799) vijnë në përfundim se përderisa që të dyja eliminojnë burimin e njëanshmërisë ndër seksione, një sasi e njëanshmërisë mbetet pasi që asnjëra nuk eliminon korrelacionet e mundshme kohore mes ndikimeve tregtare të lëna anash dhe ndryshoreve të inkuadruara në model. Megjithatë, ata vijnë në përfundim se 'ndryshorja cilësore shtesë për palë shtetesh së paku bën punë të mirë' dhe 'është superiore ndaj ndryshores shtese për një shtet në panelin e të dhënave.' Për më tepër Baldwin dhe Taglioni (2007, f. 793 dhe 795) i referohen dy shembujve në literaturë në të cilat kontrollimi i palë-shteteve çon tek reduktimet masive në njëanshmërinë e vlerësimeve. Qasja e tjera mbi kontrollimin e faktorëve të rezistencës tregtare kërkojnë edhe më shumë ndryshore cilësore shtesë. Baldwin dhe Taglioni (2007, f. 811) konsiderojnë 'ndryshoret shtetërore të ndryshme në kohë me ndryshoret për palë shtetesh'; ndërsa për ta adresuar plotësisht rezistencën tregtare shumëpalëshe OBT (2012) argumenton se efektet të ndara për importues dhe eksportues të ndryshme në kohë duhen inkuadruar në model (shih poashtu De Benedictis dhe Taglioni, 2011, f. 68 dhe 74). Sipas të njëjtit argument, në analizimin e të dhënave sektoriale në panel, duhet aplikuar dhe edhe efektet specifike për industri dhe shtet të ndryshueshme në kohë. Megjithatë, Baldwin dhe Taglioni (2007, f. 811) shpjegojnë pse 'ndryshorja cilësore shtesë e ndryshme në kohë' do të jetë në përdorim shumë rrallë dhe Shepherd (2013, f. 38) vëren se 'modelet të cilat inkuadrojnë numër të madh të sektorëve shumë shpejt bëhen të pamanevrueshëm për shkak të numrit të madh të parametrave të inkuadruar... dhe mund të tregohen si të pamundur për tu vlerësuar me

disa metoda numerike si ai Poisson (për këto vështirësi llogaritëse shih po ashtu De Benedictis dhe Taglioni, 2011, f.74; Head dhe Mayer, 2013, f. 21, 23, 26, 48 dhe 50). Në këtë studim, ky kufizim praktik nuk është aplikuar vetëm tek modelet sektoriale po edhe të ato totale; modelet dinamike me set të plotë të ndryshoreve shtesë për importues dhe eksportues të ndryshueshëm në kohë nuk kanë mundur të llogariten fare, përderisa modelet statike kanë nxjerrë dështime diagnostike dhe rezultate të pavlefshme (në të vërtetë bizare).

Sipas kësaj, në këtë studim kompromisi ynë ishte të llogarisim modelin dinamik i cili kontrollon efektet për palë-shtetesh – duke i përfshirë në termet e gabimit të përbërë – dhe adreson njëkohësisht problemet e ndërlidhura të jo-ekzogjenitetit të ndryshores së varur të kaluar. Kësaj çështjeje i kthehemi prapë më poshtë. Për më tepër, në modelin që raportojmë më poshtë, kemi llogaritur efektet tregtare bazuar në ndryshoret cilësore shtesë për vit/periudhë (duke lënë jashtë vetëm të parën, kështu që të gjitha efektet periodike janë të vlerësuara në raport me bazën periodike të lënë jashtë). Këto kontrollojnë efektet kohore të rezistencës tregtare shumëpalëshe deri në masë që këto pastaj janë të ngjashme për gjitha palët e shteteve. Specifikimet me ndryshoret cilësore shtesë për 7 vite i shërbejnë po ashtu edhe funksionit statistikor të minimizimit të potencialit për korrelacion të gabimeve ndër grupe të cilat dalin nga tronditjet e zakonshme në periudha të veçanta (një tronditje e tillë do të ishte ndërprerja e Masave Autonome Tregtare nga BE-ja me 2011). Modelet tona sektoriale përfshijnë ndryshoret cilësore shtesë për shtetin, sektorin dhe periudhën (Shepherd 2013, f. 37 argumenton se pasi që kostot tregtare dallojnë mes sektorëve, edhe kushtet e rezistencës tregtare shumëpalëshe dallojnë në të njëjtën mënyrë).

Çështja e dytë ka të bëjë me endogjenitetin e mundshëm të ndryshoreve në regresione. Ekziston dyshimi se zakonisht ndryshoret politike të inkuadruara në model janë potencialisht endogjene. Në modelin tonë, ndryshorja e vetme politike e inkuadruar është valuta e përbashkët. Në përgjithësi, mund të argumentohet se miratimi i valutës së përbashkët kushtëzohet nga mostrat e forcuara të tregtisë dhe rrjedhimisht mund të jetë endogjen. Megjithatë, në rastin e Kosovës ky supozim nuk qëndron. Miratimi i Euros është rezultat i procesit të paqes pas luftës së vitit 1999. Që nga atëherë, Kosova nuk ka pasur infrastrukturë institucionale për të drejtuar politika monetare, dhe për të menaxhuar valutën e vet. Prandaj, është vendosur të punohet me euro si tender ligjor. Prandaj, miratimi i euro reflekton urgjencën e cila nuk ka të bëjë në asnjë mënyrë me mostrat e forcuara të tregtisë mes Kosovës dhe BE-së. Ngjashëm me këtë, nuk ka argument të forte as për trajtimin e ndryshores për remitancat si endogjene në fluksin tregtar. Për të zënë efektin e remitancave, në kemi inkuadruar ndryshoret cilësore shtesë

për 11 shtete të BE-së me proporcion të madh të diasporës kosovare. Në anën tjetër, diaspora e kohës së fundit është krijuar për shkak të konfliktit, prandaj nuk mund të supozohet se vend-ndodhja e komunitetit të diasporës brenda BE-së është e shtyrë nga tregtia. Natyrisht, mund të ndodh që endogjeniteti të rezultojë për shkak se mostrat e tregtimin dhe komunitetit të diasporës janë të dyja pjesërisht të ndikuara nga ndikime të pashënuara. Megjithatë, në rastin kur supozohet se ndryshore të tilla të lëna anas jashtë janë në relacion me ndikime të pashënuara për palë shtetesh të cilat nuk ndryshojnë përgjatë kohës – ose së paku ndryshojnë shumë pak – atëherë ndikimet e tilla kontrollohen duke specifikuar modele panel me efekte specifike (fikse) për grupe. Potencialisht, të kontrolluarit e efekteve fikse specifike për shtetet është problematik në kontekst të specifikave dinamike në të cilat efekti fiks është pjesë e termit të përbërë të gabimit dhe kështu –për nga struktura – në korrelacion me ndryshoren cilësore shtesë të varur në kohë. Prandaj, ky problem është adresuar në të dy vlerësuesit dinamik të përdorur në këtë studim: në modelin dinamik linear, vlerësimi sipas sistemit GMM përdor nivelet e së kaluarës dhe ndryshimet e së kaluarës për të siguruar instrumente ‘të brendshme’ për ndryshoren e varur kohore (Roodman 2009); ndërsa në modelin dinamik Poisson, problemin e adresojmë duke bërë llogaritjen të kushtëzuar nga vlera fillestare e tregtisë dhe të bazuar në historinë e vrojtuar të ndryshoreve shpjeguese ekzogjene (Wooldridge, 2005).

Sipas De Benedictis dhe Taglioni (2011, f.85) ‘dinamika është ajo copëza që mungon nga modeli i gravitetit.’ Prapëseprapë inkuadrimi i dinamikës – historisë së marrëdhënieve tregtare –vjen me një kompromis. Në njërën anë, për të konsideruar plotësisht të gjitha variacionet e mundshme teorike në faktorët që shkaktojnë rezistencë tregtare kërkon specifikim të një modeli me numër shumë të madh të ndryshoreve shtesë e që mund të llogaritet vetëm me kornizë statike, e cila kështu injoron dinamikën. Në anën tjetër modelet dinamike – të cilat marrin parasysh historinë – nuk mund të përmbajnë të gjitha ndryshoret cilësore shtesë të kërkuara nga modelet të përputhshme me teorinë (në të vërtetë, çdo tentim për të specifikuar modelin dinamik në këtë mënyrë rezulton me dështim për konvergjim në një zgjidhje. Prandaj, në i japim përparësi vlerësimit dinamik sepse vlerësuesit dinamik kanë mundësinë të adresojnë specifikacionet e gabuara dhe së paku të ‘adresojnë pjesërisht’ specifikacionet e gabuara të cilat dalin nga lënia jashtë e variacioneve në faktorët rezistues ndaj tregtisë por të cilët janë të sigurtë të humbin nga specifikimi dinamik i gabuar. Zgjedhja jonë për vlerësimin dinamik ka është dy arsye tjera. Së pari në besojmë se ndikimet historike janë veçanërisht të rëndësishëm për mostrat e tregtisë së Kosovës (shih më poshtë). Së dyti, një model gravitetit i ngopur me efekte fikse absorbon çdo ndryshore me interes. Mirëpo, edhe pse njëanshmëria e mundshme obligon kujdes në interpretimin e rezultateve tona (njëjtë si me specifikacionet tjera të

gravitetit), krahasimi mes vlerësimeve tona të efektit të BPV dhe remitançave mund të sugjerojë fakte të dobishme për tregtinë e Kosovës.

Pasi që tashmë kemi shpjeguar preferencën tonë për modelin dinamik, mund të konsiderojmë saktësisht cili model dinamik është më i përshtatshmi. Për këtë, i kthehemi çështjes së trajtimit të zeros në të dhënat tregtare. Forma log-lineare e ekuacionit të gravitetit, siç e sugjeron teoria, kërkon transformim të ndryshoreve të vazhdueshme, si ajo e tregtisë BPV, dhe distancës në formë logaritmike. Megjithatë, grumbujt e të dhënat për tregti bilaterale, përfshi tonën, përmbajnë shumë vlera zero, të cilat nuk mund t'i nënshtrohen transformimit logaritmik, sepse log-u i zeros nuk është i përcaktuar. Kjo nënkupton se në qoftë se në aplikojmë transformim log-linear dhe aplikojmë njërën nga këto teknika, në atëherë lëmë jashtë vrojtimit zero nga grumbujt e të dhënave. Kjo nuk do të ishte problem nëse qëndrimi për të mos eksportuar (d.m.th. zero tregti) do të ishte i rastësishëm. Megjithatë, zerot kanë domethënie specifike: në të shumtën e rasteve, ato janë simptome të një procesi vetë-selektues (siç është diskutuar më herët në kontekst të heterogjenitetit të kompanive dhe vendimit për hyrë/dalë nga tregu). Me fjalë tjera, zerot tregojnë se barrierat tregtare janë pengojnë një raport tregtar të veçantë për çfarëdo kërkesë ose oferte. Prandaj, përlogaritja e modelit vetëm në flukse tregtare pozitive me shumë gjasa do të prodhonte rezultate të njëanshme.

Kjo do të ishte një handikap i vërtetë për Kosovën, si rezultat i natyrës sporadike/ad hoc të eksportit në përgjithësi. Për më tepër, nga këndvështrimi empirik, sa më i madh të jetë zbërthimi i të dhënave aq më i madh është numri i vlerave zero në matricë. Prandaj, lënia jashtë e zeros do të kishte ndikim të madh në vlerësimet tona sektoriale. Literatura propozon një numër të madh të teknikave për të zvogëluar problemin e zero jo të rastësishme (shih De Benedictis dhe Taglioni, 2011 për diskutim). Modelin dinamik Poisson në e kemi specifikuar sipas Wooldridge (2005) në të cilin efektet e vrojuara kanë mundur të inkuadrohen në supozimin se kanë shpërndarje Gamma (f. 50 dhe 51) dhe se janë të kushtëzuar nga vlera fillestare e tregtisë dhe ekzogjeniteti i ndryshoreve shpjeguese (f. 40 dhe 43). Dihet tashmë mirë se regresioni Poisson është më i përshtatshmi për llogaritje të modelit të gravitetit në përgjithësi. Përpos aftësisë që të vlerësoj me vrojtme zero në matricën tregtare, ky model merr parasysh dhe prezencën e heteroskedasticitetit nën supozimin e kushtit shumëzues të gabimit (shih Shepherd, 2013, f. 51-52). Për më tepër, ky model është i përshtatshëm për llogaritje të modelit tonë të gravitetit të informuar nga teoria, sepse supozimet e tij kryesore janë: dinamika të specifikuar saktësisht, e cila pajtohet me rastin teorik të prezantuar nga Eichengreen dhe Irwin (1998) (shih po ashtu De Benedictis dhe Taglioni, 2011, f. 85-86); dhe regresorët ekzogjen, të cilët sa i përket tregtisë dypalëshe në regresion me të ardhurat

dhe distancën (ndryshoret tona kryesore kontrolluese) korrespondojnë me supozimin e zakonshëm të modelimit të gravitetit (përderisa të ardhurat kombëtare varen nga tregtia e përgjithshme, masa deri në të cilën kjo varet nga çfarëdo tregtie dypalëshe nuk është konsideruar si shkaktar i rëndësishëm e endogjenitetit të mundshëm).

Për arsye të cekura më lartë, e posaçërisht për shkak të rritjes masive të madhësisë së mostrës (në veçanti për analiza sektoriale), vlerësimi dinamik Poisson do të jetë qasja jonë e preferuar. Inkuadrimi i zerove rezulton në ndryshime drastike në madhësisë së mostrës sonë: për të dhënat totale për eksporte dhe importe rritja e të dhënave bëhet për 23 dhe 3.7 për qind respektivisht; ndërsa ndryshimet në madhësi të mostrës për data bazat për eksportet dhe importet sektoriale janë shokuese – respektivisht për faktorë 15.6 dhe 2.3. megjithatë, si vlerësimet dinamike GMM ashtu edhe ato OLS do të prezantohen me qëllim të verifikimit të fuqisë së rezultateve tona

Aneksi 2: interpretimi dhe specifikacionet ekonometrike të modelit tonë të gravitetit

A.2.1 Interpretimi i rezultateve

Modeli dinamik Poisson ka dy aspekte të cilat duhen marrë parasysh para se të interpretohen rezultatet. Së pari, Santos Silva dhe Tenreyro (2006, f. 654) sqarojnë se ndryshorja e varur në modelin Poisson specifikohet në nivel të llogaritmeve, dhe rrjedhimisht, siç sqaron Shepherd (2013, f. 52), koeficientët e ndryshoreve të varura në llogaritme interpretohen si elasticitete të thjeshta apo konstante, përderisa 'koeficientët e ndryshoreve të pavarura në këto nivele interpretohen si gjysmë-elastike, ose nën OLS'. Në vazhdim, Santos Silva dhe Tenreyro (2006, f. 654) sqarojnë se ndryshorja e varur në modelin Poisson duhet interpretuar në mënyrë të njëjtë si në modelin e llogaritur sipas OLS. Poashtu, në bëjmë rishkallëzimin e ndryshoreve të vazhdueshme në model sipas Santos Silva dhe Tenreyro (2006, f. 210) duke bërë ndarjen me 10 milion, pasi që vlerësuese dinamik Poisson në STATA (>xtpoisson<) është i njehur për çështje të konvergjitit kur baza e të dhënave përmban vlera shumë të mëdha. Sa i përket specifikacionet log-log në modelin dinamik linear, ku si ndryshorja e varur ashtu edhe ajo e pavarur janë të dhëna në logaritme natyrr, koeficientët e ndryshoreve të pavarura masin elasticitetin e vazhdueshëm të ndryshores se varur karshi asaj të pavarur.

Çështja e dytë ka të bëjë me marrëdhënien afatshkurtër dhe afatgjatë mes ndryshoreve. Tabelat prej 8 në 11 prezantojnë vlerësimet afatshkurtër dhe afatgjatë (apo të ashtuquajturin efektin ndikues të ndryshimeve) të ndryshoreve me interes në fluksin e eksporteve dhe importeve. Një përparësi e rëndësishme e modeleve me panele dinamike është mundësia për të dalluar në mes të dhe për të bërë matjen mes marrëdhënieve afatshkurte dhe afatgjate. Kjo veçori është e rëndësishme në analizën aktuale sepse shumica e marrëdhënieve grumbullohen dhe fillojnë të kenë efekt me kohë. Edhe pse nuk është arritur në praktikë ende në plotësi, nga aspekti matematikor efektet afatgjate nxjerrin elasticitetin në pah në mënyrë asimptotike (d.m.th. pas periudhave infinte). Nga aspekti ekonomik, efektet afatgjate mund të jenë më të rëndësishme se ato afatshkurte, varësisht nga madhësia e efektit persistent të llogaritur përmes koeficientit të ndryshores së varur kohore.

Gabimi standard që rrjedh nga llogaritja GMM e sistemit dinamik dhe llogaritjeve tona statike OLS u janë përshtatur grupimeve përgjatë vijës palë-shtetesh dhe palë-shtetesh-sektorësh. Megjithatë, në rastin e modelit tone dinamik Poisson, ne kemi specifikuar heterogjenitetin Gamma dhe kemi raportuar për gabimet standarde (OIM) të ndërlidhura sipas Wooldridge (2005, f.51). nuk është e mundur të kalkulohe gabime

standard të fuqishme për grupime për këtë model as në specifikimin statik, përderisa specifikimi dinamik – d.m.th. me ndryshore të varura kohore brenda regresionit – parandalon zbatimin e grupimit ashtu siç e propozojnë Cameron and Trivedi (2010, pp.435 and 637).¹⁹ Fatmirësisht, rezultatet tona nxjerrin disa fakte se gabimet standarde të fuqishme për grupime nuk do të kishin ndikim të rëndësishëm në konkluzionet nga modelet tona dinamike Poisson. Në seksionin 4.4.2 në kemi raportuar se Modeli Dinamik Poisson i llogaritur sipas të dhënave për eksportin total nuk nxjerr efekte të rëndësishme për specifikimet grupore – d.m.th. për palë shtetesh –dhe se koeficientët dhe gabimet standarde të nxjerra nga vlerësimet e modelit Poisson nuk kanë efekte për palë shtetesh. Ky rezultat është i vlefshëm në kontekstin e tashëm sepse ky model mund të llogaritet si me gabime standarde si për OIM ashtu edhe për grupime të fuqishme. Në kemi gjetur se gabimet standarde OIM janë pak më të mëdha se gabimet standarde për grupimet e fuqishme, edhe pse jo mjaftueshëm për të ndryshuar gjykimin për rëndësinë statistikore apo të cilitdo efekt të diskutuar më herët. Prandaj, se paku sa i përket vlerësimeve që dalin prej të dhënave për eksportin total ne kemi fakte se me përdorimi i gabimit standard për konkluzione nënkupton qasje konservative; me fjalë tjera, me përdorimin e më shumë gabimeve standarde kemi më pak gjasa të konkludojmë se ndryshoret tona të interesit kanë efekt me rëndësi statistikore në tregti.

Për t'i dhënë kontekst rezultateve që dallon nga vlerësimet dinamike në vazhdojmë me diskutim të historisë së tregtisë së Kosovës, e veçanërisht të strukturës së tregtisë dhe shteteve partnere në hemisferën perëndimore. Më tutje, i diskutojmë rezultatet e koeficienteve të BPV-së, të pasuar me diskutim mbi efektin e kostos tregtare, valutës së përbashkët, dhe diasporës në eksportet nga Kosova në BE.

A 2.2.Specifikat ekonometrike të modelit

Diagnostikimi i modeleve me panele dinamike tregon se këto modele janë të specifikuara mirë, ndërsa ato të ndërtuara në efekte fikse statike nuk janë. Kjo e fundit specifikohet kryesisht me ndryshore binare, dhe për këtë janë të pritshme problemet me specifikim pasi që me këtë shkelet supozimi i normalitetit. Në këtë kontekst, një përparësi shtesë e modelit me panele dinamike është se këto nuk kërkojnë shpërndarje normale të termit të gabimit (për më tepër shih Greene, 2008, f. 201, 525, dhe 533). Megjithatë, qasja sipas sistemit GMM ndaj vlerësimeve në panel me ndryshore të varura të së kaluarës, nuk nënkupton korrelacion serik të rendit të dytë në termin e gabimit brenda ekuacionit

¹⁹ Në dosjen “Ndihmë” të **xtabond2**, Roodman (2009a) e sqaron këtë problem me sa vijon: Komanda bootstrap në Stata ‘ndërton set të përkohshme të të dhënave duke i nxjerrë mostrën reale *me zëvendësim*. Dhe vrojtimet e shumta për çfarëdo njësi dhe periudhë vrojtimi shkel strukturën e panelit.’ Në bazë të kësaj, përdorimi i Stata 13.1 për të zbatuar qasjen e grupimit bootstrap drejt sigurimit të gabimeve standarde të fuqishme të grupime për një model dinamik rezulton me këtë porosi gabimi: ‘vrojtime të pamjaftueshme për të kalkuluar gabimin standard bootstrap: asnjë rezultat nuk do të ruhet.’


diferenca e parë, sepse kjo do të bënte dallimet nga e kaluara të ndryshores se varur endogjene dhe si të tilla instrumente jovalide). Në këto modele, ne duhet të testojmë validitetin e instrumenteve që nënkupton: së pari aplikimin e testit Arellano dhe Bond për korrelacionin serik të rendit të parë dhe të dytë brenda mbetjeve (edhe pse duhet pritur të parën, e jo këtë të fundit); dhe së dyti, duke përdorur testin Sargan, ose testin e preferuar Hansen J-Statistic të fuqishëm për heteroskedasticitet, të testohet validiteti i kufizimeve identifikuese (instrumentet) (për detaje shih Roodman, 2009). Sa i përket vlerësimeve sipas panelve dinamike të realizuara përmes sistemit gmm, në formë uniforme del se modelet janë të specifikuara mirë (këto llogaritje së bashku me teste diagnostike mund të sigurohen nga autorët me kërkesë).

Testet për modelin dinamik Poisson pas vlerësimeve janë të rralla. Megjithatë, Wooldridge (2005) dhe Silva dhe Tenreiro (2011) ofrojnë ca aluzione të vlefshme për specifikacionet korrekte të modelit. Ashtu siç e kemi cekur më herët, Wooldridge (f. 50) e bën të qartë se shpërndarja e efekteve të rastësishme në modelin dinamik Poisson është gama, dhe se modeli dinamik Poisson duhet vlerësuar 'në paketa softuerike të cilat vlerësojnë efektet e rastit të modeleve Poisson karshi heterogjenitetit Gamma'.²⁰ Për më tepër, dinamika Poisson është e përshtatshme për të llogaritur modele në prani të heteroskedasticitetit, nën supozimin e termit të gabimit shumëfishues. Poashtu, dinamika Poisson është në përputhje me vlerësuesin e mundësisë pseudo-maksimum, pa marrë parasysh se si janë shpërndarë të dhënat. Në përputhje me këtë, Silva dhe Tenreiro (2011) tregojnë se modeli Poisson performon fuqishëm edhe në grupe të dhënave me proporcione të mëdha të vlerës zero.

²⁰ Pasi që modeli ynë dinamik Poisson supozon – sipas Wooldridge (2005) shpërndarjen gama të efekteve të rastësishme (d.m.th. komponentin e efektve fikse në kushtin e gabimit të përbërë), ai nuk është llogaritur përmes kuadraturës. Për këtë qasje, do të duhet të supozonim – në kundërshtim me specifikacionet e modelit tonë – se efektet e rastësishme i nënshtrohen shpërndarjes normale. Prandaj, verifikimi i dhënë për shumë modele të efekteve të rastësishme me diagnostikues **quadchk** të Stata programi nuk është relevant për këtë studim.


Aneks 3: Statistikat përshkruese

Figura A1: Eksportet e Kosovës sipas shteteve të BE-së (në vite)



Graphs by Pair as a numerical variable for xtset etc_ encode pair, generate(pair_num)

Figura A2: Mesatarja e eksporteve të Kosovës sipas shteteve të BE-së




Graphs by Pair as a numerical variable for xtset etc_ encode pair, generate(pair_num)

Figure A4: Importet mesatare të Kosovës sipas shteteve të BE-së



Graphs by encode pair, generate(pair_num)

Figura A3: Importet e Kosovës sipas vendeve të BE-së (në vite)



Graphs by encode pair, generate(pair_num)

Ky studim i tregtisë së Kosovës me 28 vendet e BE-së gjatë periudhës 2005-2012 zbulon se liberalizimi i tregtisë në vete nuk do të promovojë bilancin tregtar dhe zhvillimin ekonomik në Kosovë. Tregtia e pabarabartë – në të cilën importet tejkalojnë dukshëm eksportet – së bashku me modelet e qëndrueshme historike të eksportit dhe me mungesën e ndryshimit të eksporteve karshi ndryshimeve në të ardhura – qoftë në tregjet e BE-së apo në atë vendor – tregojnë mungesë të ekuilibrit në zhvillimin ekonomik të Kosovës.

